



Konferenca II-të Ndërkombëtare mbi

ARTET DHE EDUKIMIN

“Krijimtaria, Trashëgimia dhe Edukimi Artistik
në Epokën e Teknologjisë”

11 - 12 Qershor | 2026

Universiteti i Arteve
Tiranë, Shqipëri



LIBRI I ABSTRAKTEVE



PËRGATITUR NGA:

Konferenca II-të Ndërkombëtare mbi Artin
dhe Edukimin (ICAE 2026)

BOTUESI:

Universiteti i Arteve

ISBN Digital:

9789928486080

VENDI I BOTIMIT:

Tiranë, Shqipëri

E DREJTA E AUTORIT:

©Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të
riprodhohet në asnjë formë pa lejen e
Redaksisë

Bordi Kreativ:

MA. Kein Katroshi

Supervizori i dizajnit grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Jori Zguro

Mikea Dusha

Edmea Kerni

Frankin Pelari

Orges Karaj

Aila Baçi

Dizajner grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Publikuesi Online:

Erjon Sulaj

Kryetar Nderi:

Prof. Dr. Erald Bakalli
Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Shkencor Ndërkombëtar:

Akademik Vasil S. Tole
Akademia e Shkencave, Tiranë, Shqipëri

Prof. Dr. István Erős
Rector of the University of Fine Arts, Budapest, Hungary

Prof. Arian Paço
Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dorian Çene
Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Sadik Spahija
Dekan i Fakultetit të Arteve të Bukura, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Miltiadh Kutali
Dekan i Fakultetit Skenik, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Arben Llozi
Dekan i Fakultetit të Muzikës, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Dr. Francesco Perri
Kompozitor, Dirigjent, Konservatori i Muzikës “S. di Giacomantonio”, Kozenca, Itali

Prof. Innocenzo Cosimo De Gaudio
Etnomuzikolog, Konservatori i Muzikës “S. di Giacomantonio”, Kozenca, Itali

Prof. Patrizia Staffiero
Profesore e Historisë së Artit, Zëvendësdyrektore, Akademia e Arteve të Bukura, Leçe, Itali

Prof. Virgilio Piccari
Drejtor, Akademia e Arteve të Bukura, Katanzaro, Itali

PhD Donato Martucci
Antropologji Kulturore, Akademia e Arteve të Bukura, Leçe, Itali

Dr. Petra Van Brabandt
Drejtuuese e Kërkimit Artistik, Saint Lucas Antwerpen, Belgjikë

Dr. Ardian Ahmedaja
Universiteti i Muzikës dhe Arteve Skenike në Vjenë

Dr. Bledar Kondi
Universiteti Martin Luther Halle-Vitenberg, Gjermani

Dr. Dashmir Vaqarri
Universiteti “Derby”, Mbretëria e Bashkuar

Prof. Senad Gačević
Akademia Muzikore, Cetinje, Universiteti i Malit të Zi

Prof. Eero Tarasti
Profesor Emeritus, Universiteti i Helsinkit, Finlandë

Dr. Gregory Jones
Zëvendësdekan për Bashkëpunim, Kolegji i Muzikës, Universiteti Shtetëror i Floridës

Komiteti Organizues:

Prof. Arian Paço

Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

MA. Kein Katroshi

Supervizor i dizajnit grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Msc. Adela Kusuri

Spektori Ligjor, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Bordi Editorial:

Prof. Asoc. Dr. Holta Sina

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Edmir Ballgjati

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Fabio M. Rocchi

Fakulteti i Muzikës & Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Zef Paci

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Rozela Dhimgjini

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Ervin Meniko

Fakulteti Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Rovena Kuka

Fakulteti Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Rozina Kostani

Fakulteti Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Dorina Papa

Universiteti i New York Tirana, Shqipëri

Dr. Brunilda Basha

Universiteti i New York Tirana, Shqipëri





MESAZH MIRËSEARDHJEJE!

Të nderuar pedagogë, studiues, artistë, studentë dhe miq të Universitetit të Arteve,

Është një privilegj i veçantë të hapim sot punimet e Konferencës së Dytë mbi Artin dhe Edukimin, të Universitetit të Arteve, një hapësirë ku mendimi artistik, kërkimi shkencor dhe edukimi bashkohen për të ndërtuar vizionin e së ardhmes sonë kulturore dhe akademike.

Arti ka qenë gjithmonë një nga format më të larta të vetëdijes njerëzore. Ai nuk është vetëm shprehje estetike, por edhe mënyrë për të kuptuar kohën, shoqërinë dhe vetveten. Në një epokë transformimesh të shpejta teknologjike e sociale, arti mbetet një nga zërat më të fuqishëm që mbron identitetin, kujtesën dhe humanizmin.

Universiteti ynë ka detyrimin jo vetëm të formojë artistë të talentuar, por edhe mendje kritike, kërkues të përkushtuar dhe qytetarë me ndjeshmëri kulturore. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e kërkimit shkencor në art, në aftësinë për ta kthyer përvojën krijuese në dije, analizë dhe dialog akademik. Kërkimi nuk e kufizon artin, përkundrazi, ai i jep dimension më të thellë, duke krijuar ura mes traditës dhe inovacionit, mes praktikës artistike dhe reflektimit teorik.

Edukimi artistik, nga ana tjetër, është themeli mbi të cilin ndërtohet çdo shoqëri që synon zhvillim të qëndrueshëm kulturor. Të edukosh përmes artit do të thotë të kultivosh imagjinatën, empatinë dhe lirinë e mendimit. Në auditorët tanë formohen jo vetëm profesionistë të së nesërme, por edhe mbrojtësit e kulturës dhe të vlerave shpirtërore të kombit.

Kjo konferencë është dëshmi e ambicies sonë për të qenë një universitet i hapur ndaj ideve bashkëkohore, bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe dialogut ndërdisiplinor. Punimet, diskutimet dhe projektet që do të prezantohen gjatë dy ditëve të saj përfaqësojnë energjinë krijuese dhe seriozitetin akademik që karakterizon komunitetin tonë universitar.

Le të jetë kjo konferencë jo vetëm një shkëmbim dijesh, por edhe një moment reflektimi mbi rolin që arti dhe arsimi kanë në ndërtimin e një shoqërie më të ndjeshme, më të kulturuar dhe më humane.

Ju falënderoj për praninë dhe kontributin tuaj dhe i uroj konferencës sonë suksese të plota.

Mirë se vini në ICAE 2026!

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor

Universiteti Arteve, Tiranë, Shqipëri.

Konferenca II-të Ndërkombëtare mbi

ARTET DHE EDUKIMIN

“Krijimtaria, Trashëgimia dhe Edukimi Artistik
në Epokën e Teknologjisë”

TABELA E PËRMBAJTJES

SESIONI I - Fakulteti i Arteve të Bukura - Postmodern - Multidisiplinary

1. Armela Lamaj

Tekstili si aktor ekologjik në art. Analizë e veprës së Anni Albers, Christo and Jeanne Claude dhe Neri Oxman.....18

2. Alessandro Masoni

Dizajni si mbyllja e vendimit: Eksternalizimi në kushte pasigurie19

3. Nora Halimi

Roli i rrëfimit në edukimin e dizajnit grafik: Fuqia e narrativës.....20

4. Paolo Nardon

Muzeumet dhe monumentet. Kriza e mekanizmave memorialë.....21

5. Arta Sakja

Roli i medias sociale në promovimin e turizmit kulturor në Shqipëri: rasti i përdorimit të tiktok #visitalbania.....22

6. Andia Guga, Klenisa Galica, Franc Shllaku

Nga trashëgimia racionaliste te trashëgimia e matur: Sistemi SHM si strategji mbrojtjeje afatgjatë për sallën e madhe të koncerteve në Universitetin e Arteve Tiranë.....23

7. Harri Aleksi

Kur arti bëhet aksion - praktikat kolektive në artin aktivist bashkëkohor.....24

8. Dorina Papa

Arkitektura shqiptare në dizajnin e suvenireve.....25

9. Brunilda Basha

Të mësuarit përmes krijimit: procesi kreativ si metodë e të mësuarit në edukimin arkitekturor.....26

SESIONI II - Fakulteti i Arteve të Bukura - Etnografi - Ikonografi

1. Merita Toçila

Interpretimi i kodeve të zisë në art.....27

2. Rozela Dhimgjini

Piktura murale ndërmjet artit, kuptimit dhe trashëgimisë. Vëzhgime ikonografike dhe historike mbi një monument postbizantin.....28

3. Denada Zebi Anila Mullahi

Përshkrimi i veshjes popullore shqiptare në shekullin XIX: Krahasim ndërmjet autorëve shqiptarë dhe të huaj.....29

4. Eneida Shypheja

Turizmi kulturor – një urë mes të shkuarës dhe të tashmes: Onufri i Neokastros.....30

5. Fjoralba Prifti, Mikel Temo

Interpretimi bashkëkohor i trashëgimisë kulturore në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar (MKAM) – përvoja e vizitorit, nëpërmjet artefakteve muzeore.....31

6. Mikel Temo

Midis Lindjes dhe Perëndimit Michele Greco da Valona dhe formësimi i Rilindjes adriatike.....32

7. Eduard Sinaj

Mozaiku i Bankës së Shqipërisë, trashëgimi, identitet dhe turizëm kulturor.....33

SESIONI III - Fakulteti i Arteve të Bukura - Art pamor & Arkitekturë shek XX

1. Kujtim Halili

Skulptura monumentale në Shqipërinë e viteve '70: Diskursi estetik dhe funksioni edukativ në ndërtimin e ndërgjegjes kolektive.....34

2. Agron Mesi

Fillesat e prezencës së nudos në artin publik shqiptar (1927–1943). Trupi i zhveshur midis moralit shoqëror dhe estetikës fashiste.....35

3. Ervin Meniko

Kultura materiale shqiptare midis fshatit dhe qytetit në epokën e globalizimit.....36

4. Ermir Hoxha

Deformimi dhe e Vërteta (Mbi karikaturën në Shqipëri në gjysmën e dytë të shek. XX).....37

5. Joan Ikonomi, Iris Nela

Përkthimi i koncepteve në gjuhë vizuale: Një metodologji mësimdhënie për të komunikuar përmes artit për studentët e arkitekturës dhe dizajnit.....38

6. Eris Tare, Blegina Hasko Bezo	
<i>Identiteti lokal në artin figurativ në epokën e globalizimit vizual.....</i>	<i>39</i>

SESIONI I - Fakulteti i Artit Skenik - Aspekte teorike dhe praktike në teatrin bashkëkohor

1. Armela Demaj	
<i>Gjuha e trupit, trauma dhe performanca teatrale.....</i>	<i>40</i>

2. Kristjan Koroveshi	
<i>Artikulimi në ligjërimin publik: Dimensione gjuhësore, komunikative dhe skenike.....</i>	<i>41</i>

3. Mirela Oktrova	
<i>Studimet teatrore dhe dekolonizimi epistemik drejt një teorie Shqiptare të performancës.....</i>	<i>42</i>

4. Qëndrim Rijani	
<i>Gjuha e trupit përballë arkitekturës së pushtetit: monumentalizimi i figurës në një adaptim bashkëkohor të Jul Cezarit.....</i>	<i>43</i>

5. Valdrin Asani	
<i>Pedagogjia e Aktrimit si praktikë artistike: Rasti i Profesor Niko Kaxherit.....</i>	<i>44</i>

6. Inis Gjoni	
<i>Vetëdija artistike e regjisorit në përzgjedhjen e veprës teatrore, analizë reflektive mbi teatrin absurd.....</i>	<i>46</i>

7. Suela Agolli, Anila Mullahi	
<i>Elementi dramatik në dramaturgjinë e Fishtës.....</i>	<i>47</i>

SESIONI II - Fakulteti i Artit Skenik - Sfidat e regjizorit dhe producentit në epokën e teknologjisë

1. Anila Varfi	
<i>Simetria Kubrick: Aksi vizual dhe subjektiviteti modern në kinemanë e tij.....</i>	<i>48</i>

2. Arian Krasniqi	
<i>“Vala e re” e regjisoreve të filmit në Kosovë: transformimi estetik dhe rikonfigurimi rrëfimor.....</i>	<i>49</i>

3. Elvis Lule	
<i>Nga tabloja në kohëzgjatje: Ndikimi i temporalitetit piktoresk në ritmin filmik.....</i>	<i>50</i>

4. Eno Milkani

Efektete vizuale në kinematografinë Shqiptare dhe sfidat e saj përballë inteligjencës artificiale.....51

5. Zamir Kokonozi

Mizanskena si Arkitekturë e Narracionit Filmik në Filmin e Kristaq Dhamos52

6. Iris Canaj

Roli i Producentit dhe Drejtuesit Artistik në Projekte Artistike në Hapësirat Publike: Ndërmjetësimi mes vizionit artistik, angazhimit të komunitetit dhe edukimit informal.....53

7. Suela Bako

Fëmijët si roje të ideologjisë: loja dhe vigjilenca në kinemanë Shqiptare për fëmijë, të Realizmit Socialist..... 54

8. Valmir Tertini, Taulanda Jupi

Kinemaja hibride: Një analizë e efekteve psikologjike dhe perceptive tek shikuesi.....55

9. Mirco Michelin

Ne jetojmë brenda një ëndrrë Vënia në skenë e veprës L'Enfant et les sortilèges të Ravel-it përmes optikës së David Lynch-it.....56

SESSIONI III - Fakulteti i Artit Skenik - Koreografia dhe Skenografia në Botën e Teknologjisë: Sfida dhe Mundësi”

1. Beqo Nanaj

Ndikimi i zhvillimit teknologjik në skenografinë teatrore në Shqipëri.....57

2. Drini Shehu

Përdorimi dhe mungesa e rrotativit skenik: Analizë krahasuese e zgjidhjeve skenografike në teatrin ‘Petro Marko’ të Vlorës dhe në teatro të tjera Shqiptare58

3. Ened Kuka

Pse humbi rrotativa?59

4. Gazmend Koçollari

Nga mekanika antike te skena inteligjente: transformimi teknologjik i skenografisë teatrale.....60

5. Elona Beqiraj	
<i>Gjama: Ritual i kënduar dhe i kërcyer.....</i>	<i>61</i>
6. Elona Nallbani	
<i>Krijimtaria popullore shqiptare në ritualet e jetës si bartëse e kujteses kolektive.....</i>	<i>62</i>
7. Ersilja Çeli	
<i>Etika e autorësisë në edukimin koreografik në epokën e Inteligjencës Artificiale.....</i>	<i>63</i>
8. Uesli Alushi, Gëzim Sërtollaj	
<i>Vallëzimi bashkëkohor i inspiruar nga folklori shqiptar.....</i>	<i>64</i>
 SESIONI I - Edukimi / Metodologjia – Arkivimi, transformimi digjital, kërkimi shkencor dhe sfidat institucionale në arte	
1. Besa Luzha	
<i>Ndërtimi i identitetit kombëtar përmes edukimit muzikor: Analizë krahasuese e kurrikulave shkollore në Kosovë dhe Shqipëri.....</i>	<i>65</i>
2. Majlinda Hala, Inis Gjoni	
<i>Merita artistike dhe merita shkencore në fitimin e titujve profesor: analizë krahasuese arsimit të lartë në Europë dhe Shqipëri.....</i>	<i>66</i>
3. Andi Kongo	
<i>Nga arkivi drejt një infrastrukture kërkimore: Integrimi i arkivit audiovizual të RTSH-së në Universitetin e Arteve (Tiranë).....</i>	<i>67</i>
4. Erjon Sulaj	
<i>Nga arkiva fizike te kujtesa digjitale: një qasje e qëndrueshme për arkivimin e trashëgimisë artistike në universitetet publike.....</i>	<i>68</i>
5. Eliona Liçi	
<i>Mësimdhënia përmes performancës artistike: Gratë dhe formimi i shkollës të interpretimit në arsimin muzikor Shqiptar.....</i>	<i>69</i>
6. Enida Bogdani Belioza Coku	
<i>Përtej Ekranit: Shfaqjet e filmi në komunitet si infrastrukturë psikosociale për shëndetin mendor të të rinjve.....</i>	<i>70</i>

7. Niki Mjeda, Arben Basha

Krijimtaria, trashëgimia & edukimi artistik në kohën e teknologjisë: “Interpretimi muzikor si proces kërkimor në epokën e teknologjisë.”71

7. Neviana Stringa

Integrimi i teknologjisë në mësimin e muzikës.....72

SESIONI II - Edukimi - Artet dhe pedagogjia në zhvillim kognitiv, social dhe ndërdisiplinor në kontekste të ndryshme mësimore.

1. Manjola Tërshana

Terminologjia artistike në shqip ndërmjet huazimit dhe shqipërimit: Krahasime ndërgjuhësore.....73

2. Tidita Abdurrahmani

Integrimi i arteve dhe mëimit të gjuhës angleze: një ekzaminim empirik i ndikimit metodologjik.....74

3. Gentjan Bezatlliu

Regjia televizive shqiptare në epokën digjitale: Nga praktika institucionale te transformimi estetik.....75

4. Redjan Mulla

Teatri si laborator i qytetarisë: Roli i lëndës “TEATËR” në zhvillimin kognitiv, qytetar dhe demokratik në kurrikulën e arsimit parauniversitar (Shqipëri) krahasuar me rajonin dhe Greqinë.....76

5. Sabrina Kuçi Lavdije Pateriku

Qyteti si personazh: Narrativa urbane dhe edukimi estetik në letërsinë bashkëkohore për fëmijë (analiza bazohet në librin “Në Zemër të Qytetit të Vjetër”).....77

6. Rovena Vata

Lahuta e Malcisë së Gjergj Fishtës-vepër epokale në panteonin e letërsisë shqipe, si pjesë e thesarit kulturor dhe historik kombëtar.....78

7. Maria Argyriou, Eliona Lici

Shprehja e përkatësisë përmes këngës: Praktikant muzikore shumëgjuhësore në klasat e fëmijërisë së hershme dhe multikulturore.....79

8. Magbule Xhemali

Roli i artit pamor në zhvillimin e koncepteve matematikore tek fëmijët parashkollorë: një qasje ndërdisiplinore në edukimin e hershëm.....80

9. Flavio Lito

Kitara si mjet edukimi dhe transmetimi i trashëgimisë muzikore në epokën e teknologjisë.....81

SESIONI I - Muzika - Qasje teoriko-analitike në muzikën shqiptare**1. Ajet Çekiçi***Muzika e dhomës e kompozitorit Thoma Simaku nga vitet (1991 e këtej).....82***2. Jetmir Zaganjori***Zeqirja Ballata muzikolog; specifikat e muzikologjisë së tij.....83***3. Klejda Tare***Koncertet për piano dhe orkestër të Kozma Larës (1974-1990): Një vështrim historik dhe analitiki.....84***4. Rreze Kryeziu***Muzika artistike në Kosovë gjatë viteve '90: Krijimtaria dhe ruajtja e identitetit në periudha të tensionuara politike.....85***5. Elvis Peçi***Hartimi i rrjedhës kulturore në muzikë: Teoria e fluksit dhe një leksion analitik në zhvillim.....86***6. Laura Lila***Interpretimi në piano dhe rapsodia për piano orkestër e Ferdinand Dedës.....87***7. Fatma Spahiu***Veprat e para metodike për piano: Miniaturat pianistike.....88***8. Arjan Brahimi***Mes rapsodisë dhe koncertit: një këndvështrim analitik i dubël- koncertit për violinë, violonçel e orkestër të kompozitorit Thoma Gaqi.....89***9. Entela Demi***Recitali i parë i dokumentuar në Shqipëri (1926): Lindja e praktikës së recitalit në kontekstin e formimit të kulturës koncertale shqiptare.....90***10. Lorenc Treska***Afrimi i këngëve dhe valleve popullore të folklorit, me muzikën e kultivuar e profesioniste tek baleti "Delina" i Çesk Zadejës.....91***7. Rozana Kuka***Krijimtaria shqiptare për flaut në këndvështrimin e kompozitorëve të formuar në kohërat moderne.....92*

SESIONI II - Muzika - Muzika, identiteti, sfida e mundësi të epokës digjitale

1. Mimoza Kurshumlija, Zdrakova Djeparoska

Muzika si arkitekturë emocionale: atmosfera dramatike dhe roli i tingullit në artet performative.....93

2. Valmir Xoxa

Gjinia operistike në epokën postmoderne – rindërtimi i traditës, fragmentarizimi i subjektit dhe skena si laborator shoqëror.....94

3. Armend Xhoni

Muzika si praktikë rezistence dhe ndërtimi i identitetit kombëtar në Kosovë (1980-2000).....95

4. Eriona Rushiti

Gjinia e këngës. Çështje të terminologjisë muzikore.....96

5. Enis Mulla

Muzika e lehtë shqiptare dhe aplikimi i teknologjisë.....97

6. Voltan Prodani

Transformimi i procesit krijues të kantautorit përmes teknologjisë moderne muzikore.....98

7. Santana Xheladini

Digjitalizimi i arkivit muzikor të radio-Tiranës.....99

8. Elvina Gurra

Kënga popullore si shprehje e identitetit kulturor shqiptar: Jeta dhe krijimtaria e kompozitorit Muharrem Gurra.....100

9. Holta Sina

Paralele historike dhe funksionale të isos në polifoninë shqiptare dhe isos (ison-it) në muzikën bizantine (Një lexim përmes studiuesve vendas dhe të huaj).....101

10. Dashamir Mehmeti

Gjuha muzikore në veprat origjinale për instrumentin e kitarës nga Rafet Rudi dhe Aleksandër Peçi.....102

12. Sokol Saraçi

Banda muzikore e shoqërisë “Afërdita” të Elbasanit dhe “Albanischer Lieder” – marshi i Anton Cimfl.....103

SESIONI III - Muzika - Kultura dhe Trashëgimia. Veglat muzikore tradicionale dhe këndimi Arbëresh

1. Dario Doronzo

Paradigma pedagogjike e Herbert L. Clarke: formimi në veglat e harqeve, metodologjia e kornetës dhe soloizmi në bandë në edukimin modern të tunxhit.....104

2. Ilenia Ruggiero

Tingujt e Kalabrisë: Inovacion dhe ruajtje nëpërmjet inteligjencës artificiale.....105

3. Marco Greco

Trashëgimia, kërkimi dhe inovacioni: Biblioteka e parë e mostrave të instrumenteve muzikore tradicionale Kalabrez.....106

4. Salvatore Gorgone

Formula gojore, kujtesë spektrale dhe ruajtje digjitale. Qasje kompjuterike dhe psikoakustike ndaj traditës së këndimit Bizantin të Arbëreshëve të Siqilisë.....107

5. Chiara Rinciari

Heterogjeniteti rajonal dhe identiteti instrumental: “Chitarra Battente” e Kalabrisë Jugore përmes veçorive spektrale.....108

6. Inocenzio De Gaudio Luca Bimbi

Nga analiza formulare te sonologjia kompjuterike: Opusmodus dhe THIN për studimin e sistemeve muzikore jo-temperuar Arbëreshe.....109

7. Francesco Perri

Jehona Hibride: Peizazhet zanore të proksimitetit dhe identitetit në Kalabri mes VST-së dhe inteligjencës artificiale.....110

8. Hysen Nimani

Muzika korale në Kosovë: Konteksti historik, kulturor dhe institucional.....111

9. Amedeo Fera

Modaliteti si praktikë në traditat mesdhetare të Lirës: rasti kalabrez në perspektivë krahasuese.....112

10. Pirro Gjickondi

Perspektiva narratologjike dhe muzikore në “Ajkuna kjan Omerin” – romancë për soprano dhe piano e Edmond Buharasë.....113

11. Fabio Rocchi

Arkitektura e shenjës te Attila: analizë semiotike e strukturave paradigmatiske dhe sintagmatike te Verdi i ri..... 114

Tekstili si aktor ekologjik në art, analizë e veprës së Anni Albers, Christo and Jeanne Claude dhe Neri Oxman

Armela Lamaj

armela_lamaj@universitetipolis.edu.al

Universiteti Polis, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Nëpërmjet këtij punimi do të analizohet tekstili si një medium përcaktues në transformimin e praktikave artistike në ndikimin ekologjik. Duke propozuar një lexim të artit me materialin në qendër të vëmëndjes. Pikënisja konceptuale është praktika në punën e Anni Albers, e formuar në shkollën e Bauhaus-it, ku në procesin e sajë kërkimor e krijues afirmon thurjen si strukturë autonome dhe gjuhë abstrakte. Albers nuk e sheh tekstilin si dekor, por si një sistem organizimi formash dhe konceptesh. Është materiali i cili prodhon mendim përmes ritmit, tensionit dhe nderthurjes së fijeve. Kjo autonomi materiale zgjerohet në shkallë dhe kuptim në veprën e Christo and Jeanne-Claude ku tekstili perdoret për nderhyrje të perkoheshme monumentale në peisazh. Në projektet e tyre, materiali vepron si membranë që transformon perceptimin e hapësirës dhe thekson perkohshmerinë e aktit artistik. Tekstili bëhet mjet për të problematizuar marëdhënien midis natyrës dhe nderhyrjes njerzore, duke e bërë të dukshme vetë strukturën e nderhyrjes. Në procesin e punës së Neri Oxman, ndjehet në mënyrë të drejtëpërdrejtë lidhja mes teknologjisë dhe biologjisë dhe mendimit artistik. Në punën e sajë fibra dhe structura zhvillohen në bashkëpunim me procese biologjike dhe teknologjike. Ku materiali nuk përfaqëson natyrën por beshkë prodhon me të. Duke u mbështetur në mendimin e Bruno Latour, kjo tezë argumenton se tekstili mund të shihet si një artor-material Brenda një rrjeti marëdhëniesh njerzore dhe jonjerzore. Në këtë tezë, arti në ndikimin ekologjik nuk prezantohet vetem i lidhur me mjedisin por nëpërmjet vetë materialit i cili artikulon ndërvaresinë, procesin dhe bashkëjetesën.

Fjalë kyçe

Tekstil, ekologji, material, art

Dizajni si mbyllja e vendimit: Eksternalizimi në kushte pasigurie

Alessandro Masoni

alessandromasoni@unyt.edu.al

University of New York Tirana, Shqipëri

Abstrakt

Dizajni funksionon nën pasiguri të pareduktueshme, megjithatë kriteret ekzistuese të vlerësimit si funksionaliteti, estetika, qëndrueshmëria, vlerësojnë rezultatet brenda fushave të izoluara dhe për këtë arsye luftojnë për të shpjeguar pse dizajnet që po performojnë mirë në një dimension, gjenerojnë pasoja të paqëllimshme në të tjerët. Ky punim trajton këtë boshllëk duke prezantuar një kornizë për të kuptuar dizajnin si mbyllje vendimi nën pasiguri në tre fusha të pareduktueshme: përvojë, njohuri dhe realitet. Duke u mbështetur në racionalitetin e kufizuar, problemet e liga dhe dizajnin si krijim botëror, punimi propozon një metodë interpretuese të strukturuar që harton sythet fenomenologjike, epistemologjike dhe ontologjike para dhe pas ndërhyrjes së dizajnit. Korniza funksionalizohet përmes dy rasteve studimore shqiptare: Piramida e Tiranës (monument komunist i shndërruar në qendër teknologjike) dhe një studio projektimi në burgun e Spaçit (vend i kontestuar i trashëgimisë traumatike). Eksternalizimet, mekanizmat përmes të cilave dimensionet bëhen të parëndësishme për të mundësuar veprimin, klasifikohen si të nevojshme, të menaxhuara ose sistematike. Rasti i Piramidës demonstroi riaktivizimin e suksesshëm urban të arritur përmes eksternalizimit sistematik të kuptimit historik dhe pasojave socio-ekonomike. Studio e Dizajnit për rivitalizimin e burgut të Spaçit zbulon përgjegjësinë pedagogjike që vepron përmes përkthimit sistematik të përvojës traumatike në metaforë hapësinore, duke eksternalizuar realitetin material si kufizim të domosdoshëm të fushëveprimit. Në të dyja rastet, fragmentimi vazhdon, Ajo që ndryshon është mënyra se si shpërndahet. Punimi prezanton Angazhimin Jo-Reduktues si një paradigmë vlerësuese, duke zhvendosur vëmendjen kritike nga metrikat e izoluara dhe gjykimet binare në një pyetje diagnostikuese: çfarë është bërë e parëndësishme dhe kush i mban pasojat? Kjo riformulon përgjegjësinë e projektimit si strukturore dhe jo opsionale.

Fjalë kyçe

Teoria e projektimit, vendimmarrja nën pasiguri, probleme të këqija, teoria arkitekturore, përgjegjësia e projektimit

Roli i rrëfimit në edukimin e dizajnit grafik: fuqia e narrativës

Nora Halimi

nora.halimi@unite.edu.mk

Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut

Abstrakt

Nga pikturat e hershme në shpella deri te zgjidhjet bashkëkohore të dizajnit grafik, pamjet vizuale kanë qenë në qendër të rrëfimit njerëzor. Në epokën e sotme digjitale, dizajni grafik luan një rol vendimtar në mënyrën se si tregohen dhe kuptohen rrëfimet apo historitë. Qëllimi i integritetit të rrëfimit në edukim është krijimi i një gjuhe vizuale që i bën rrëfimet të paharrueshme, të kuptueshme dhe me ndikim. Dizajni grafik ka potencialin të transferojë informacion në mendjen e të tjerëve. Edhe rrëfimi bën të njëjtën gjë. Rrëfimet udhëtojnë nga një person tek një tjetër dhe nga një vend në tjetrin. Një produkt apo komunikim i realizuar mirë transferon ide dhe emocione nga mendja e krijuesit te mendja e përdoruesit. Shkëmbimi i energjisë – jo vetëm transferimi i të dhënave dhe fakteve – ndodh sa herë që përdoret një produkt, shihet një imazh ose luhet një lojë. Kjo energji buron nga marrëdhënia dinamike mes krijuesit dhe audiencës, mes prodhuesit dhe përdoruesit. Ndërsa teknologjia përparon dhe rrëfimi vizual vazhdon të evoluojë, thelbi i tij mbetet i përjetshëm: të bashkojë njerëzit përmes zgjidhjeve të dizajnit që i shndërrojnë idetë në narrativa të qëndrueshme. Ky punim analizon lidhjet midis rrëfimit, dizajnit dhe edukimit në dizajnin grafik dhe mediat vizuale, duke e konsideruar narrativën si metodë pedagogjike dhe si mjet për komunikim vizual efektiv. Derisa rrëfimet përshkruajnë një veprim dhe nxisin kureshtjen, dizajni mishëron vlera dhe ilustron ide. Punimi synon të kuptojë se si rrëfimi mund të ndihmojë procesin pedagogjik në edukimin e dizajnit dhe praktikën bashkëkohore. Studimi aktual tregon se integrimi i rrëfimit në kurrikulat e dizajnit grafik dhe mediave vizuale rrit përfshirjen e studentëve, koherencën konceptuale dhe identitetin profesional të artistëve dhe dizajnerëve në zhvillim e sipër. Punimi përfundon me sugjerime për përfshirjen sistematike të strategjive të rrëfimit në kornizën e mësimdhënies së dizajnit.

Fjalë kyçe

Arti narrativ, komunikimi vizual, pedagogjia kreative, arsimimi vizual

Muzeumet dhe monumentet, kriza e mekanizmave memorialë

Paolo Nardon

paolo.nardon@abaperugia.org

Akademia e Arteve të Bukura “Pietro Vannucci”, Peruxhia, Itali

Abstrakt

Muzeumet dhe monumentet tradicionalisht janë konceptuar si mekanizma memorialë, të projektuar për të ruajtur dhe transmetuar një kulturë të përbashkët përmes veprave, imazheve dhe dokumenteve që evokojnë një të shkuar, e cila deri më sot i ka shërbyer rrëfimeve të përcaktuara nga pushteti dominues. Kjo kujtesë nuk është neutrale, por është rezultat i synimeve të sakta komunikuese që përcaktojnë simbolikisht të kaluarën, duke modeluar identitetin kolektiv. Epoka bashkëkohore, e karakterizuar nga mutacione sociale shumë të shpejta, po kërkon të prodhojë një rishikim kritik të historisë nga ana e komuniteteve. Duke pranuar indiferencën progresive që publiku ka treguar si ndaj monumenteve, ashtu edhe ndaj veprave të artit brenda muzeumeve, kemi identifikuar në peizazhin ndërkombëtar disa raste studimore që na lejojnë të rrokim propozimet alternative të paraqitura nga artistë të caktuar dhe institucione publike për të sanuar këtë krizë të muzeumeve dhe monumenteve, të cilat ne i kemi përkufizuar më gjerësisht si mekanizma memorialë. Kuadri teorik bazohet në koncepte kyçe të debatit estetik dhe filozofik modern e bashkëkohor: duke nisur nga “humbja e aurës” së veprës së artit të Walter Benjamin-it, duke kaluar përmes “humbjes së qendrës” së Hans Sedlmayr-it, deri te “zhdukja e ritualeve” e teorizuar nga Byung-Chul Han. Në botën bashkëkohore, muzeumet e reja nuk janë më thjesht kontejnerë veprash, por organizma aktivë dhe proaktivë në të cilët e kaluara i nënshtrohet riinterpretimeve të vazhdueshme. Përmes analizës së disa propozimeve alternative, ka qenë e mundur të vërehet se si veprat brenda muzeumeve dhe ato jashtë në sheshet publike nuk janë më objekte të soditjes statike, por u ofrojnë shikuesve një pjesëmarrje kritike dhe dinamike.

Fjalë kyçe

Krizë, muzeume, monumente, kujtesë, harresë

Roli i medias sociale në promovimin e turizmit kulturor në Shqipëri: rasti i përdorimit të tiktok #visitalbania

Arta Sakja

artasakja@hotmail.com

Presidenca e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon rolin e medias sociale në promovimin e turizmit kulturor të Shqipërisë, duke u fokusuar në platformën TikTok në përdorimin e hashtag-ut #VisitAlbania si instrument digjital për promovimin e identitetit kulturor dhe rritjen e interesit turistik ndaj Shqipërisë. Në kontekstin e zhvillimit të mediave të reja dhe transformimit të komunikimit turistik, TikTok është shndërruar në një hapësirë të rëndësishme të ndërtimit të imazhit kulturor përmes videove të shkurtra, narrativave vizuale dhe ndërveprimit global të audiencës. Punimi mbështetet në analizën cilësore të përmbajtjeve të publikuara me hashtag-un #VisitAlbania duke analizuar mënyrën se si promovohen elementët e trashëgimisë kulturore shqiptare, si sitet arkeologjike dhe historike, qytetet muzeale, veshjet tradicionale, vallet folklorike, muzika tradicionale dhe ritualet kulturore. Këto elemente paraqiten në TikTok jo vetëm si produkte turistike, por edhe si simbole të identitetit kombëtar dhe autenticitetit kulturor shqiptar. Analiza tregon se përdorimi i përmbajtjeve vizuale dinamike, muzikës tradicionale dhe narrativave emocionale ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të Shqipërisë si destinacion kulturor. Gjithashtu, studimi evidenton se hashtag-u #VisitAlbania ka krijuar një hapësirë virtuale ku përdoruesit kontribuojnë aktivisht në promovimin e kulturës shqiptare përmes videove të udhëtimeve, eksperiencave turistike dhe performancave tradicionale. Rezultatet sugjerojnë se media sociale, veçanërisht TikTok, luan rol të rëndësishëm në rritjen e numrit të turistëve në Shqipëri duke ndikuar në perceptimet globale mbi destinacionin, në promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe në krijimin e një identiteti digjital turistik për vendin. Punimi përfundon se një njohje më e thelluar e manualit të përdorimit të Tiktok si edhe integrimi i mediave sociale në strategjitë e marketingut kulturor përfaqëson një mundësi të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor shqiptar.

Fjalë kyçe

Turizëm kulturor, Tiktok, #visitalbania, media sociale, identitet kulturor, trashëgimi kulturore, marketing digjital, Shqipëri

**Nga trashëgimia racionaliste te trashëgimia e matur:
sistemi SHM si strategji mbrojtjeje afatgjatë për sallën e madhe të
koncerteve në universitetin e arteve Tiranë**

Andia Guga, Klenisa Galica, Franc Shllaku

a.guga@unizkm.al, k.galica@unizkm.al, f.shllaku@unizkm.al

Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Salla e Madhe e Koncerteve e Universitetit të Arteve në Tiranë, e projektuar gjatë periudhës së Racionalizmit Italian nga Gherardo Bosio fillimisht si Teatri i Dopolavoro-s Shqiptare, përfaqëson një nga shembujt më të rëndësishëm të trashëgimisë arkitekturore të shekullit XX në Shqipëri. Përpos vlerave të njohura arkitekturore, për trashëgiminë racionaliste moderne shpesh nuk ka strategji afatgjata mbrojtjeje, veçanërisht në kontekste sizmike. Ky artikull propozon një kalim nga projektet e restaurimit drejt një modeli konservimi parandalues, mbështetur në Sistemin e Monitorimit të Shëndetit Strukturor (SHM) të ndërtesave. Duke u bazuar në kërkime historike e arkitekturore, në studimin e fizibilitetit të vitit 2020 për restaurimin e Sallës së Madhe të Koncerteve, rehabilitimin e saj dhe në strategjinë e monitorimit të vitit 2025, studimi prezanton konceptin e “trashëgimisë së matshme”. Në këtë artikull monitorimi nuk interpretohet thjesht si një instrument teknik, por evidentohet si një strategji kulturore që transformon Sallën e Koncerteve në një sistem të vazhdueshëm trashëgimie. Salla e Madhe e Koncerteve në Universitetin e Arteve bëhet një model pilot ku qartësia racionaliste, logjika strukturore dhe supervizioni bashkëkohor dixhital ndërthuren për të ripërcaktuar paradigmat e konservimit për arkitekturën moderne në mjedise urbane tranzitore.

Fjalë kyçe

Konservim parandalues, arkitekturë racionaliste, kontekst sizmik, menaxhim kulturor

Kur arti bëhet aksion - praktikat kolektive në artin aktivist bashkëkohor

Harri Aleksi

harrialeksi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim shqyrton transformimin e artit aktivist si një praktikë estetike e përqendruar te objekti artistik tek arti në formë aksioni kolektiv, social dhe mediatik. Duke hulumtuar mbi artin dhe aktivizmin nga artistët e fund-shekullit të njëzetë deri në ditët e sotme, ky punim evidenton se si arti aktivist bashkëkohor ndërton forma të reja ndërveprimi me publikun përmes shikueshmërisë, përballjes institucionale, dokumentimit, përcjelljes mediatike dhe strategjive të ndryshme të komunikimit. Përmes një shqyrtimi analitik mbi lëvizjen aktiviste, i cili ndërthuret me kritikën institucionale, ndërhyrjet artistike dhe sensibilizuese, të tilla si lëvizjet feministe, anti-raciste, të të drejtave të njeriut etj., punimi ngre pyetje të tilla si: “Pse praktikat bashkëkohore aktiviste i ngjajnë gjithnjë e më shumë fushatave politike dhe atyre mediatike?”, “Pse organizimi kolektiv shpesh zëvendëson autorësinë individuale artistike?”, “Si muzetë dhe institucionet kulturore janë bërë vende përballjeje në vend të hapësirave të ekspozitës neutrale?” apo “Si është bërë vetë dokumentimi i pandashëm nga vepra aktiviste?” Gjetjet tregojnë se arti aktivist bashkëkohor vepron duke funksionuar kryesisht përmes paraqitjeve publike dhe komunikimit, si dhe duke i bërë kufijtë mes veprës artistike, performancës, aksionit politik dhe ngjarjes mediatike gjithnjë e më fluidë. Në këtë kontekst, zhvillimi i mediave digjitale dhe rrjeteve sociale ka zgjeruar ndjeshëm potencialin e artit aktivist për të krijuar mobilizim, shpërndarje dhe ndikim transnacional. Ndaj, estetika shpesh kalon në plan të dytë përballë efektivitetit të veprimit, ndërsa vepra artistike zhvillohet si pjesë e proceseve komplekse të organizimit, dokumentimit dhe komunikimit publik. Punimi arrin në përfundimin se arti aktivist bashkëkohor nuk mund të kuptohet përmes kornizave tradicionale estetike, por duhet të studiohet si një praktikë kulturore taktike dhe aksioni, një formë rezistence si dhe një mjet për prodhimin e ndërhyrjes sociale dhe politike.

Fjalë kyçe

Art pamor, aktivizëm, autorësi kolektive, kritikë institucionale, media, hapësirë publike

Arkitektura shqiptare në dizajnin e suvenireve

Dorina Papa

dorinapapa@unyt.edu.al

Universiteti i New York Tirana, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim eksploron paraqitjen e trashëgimisë arkitekturore shqiptare në produktet suvenire dhe reflekton mbi mënyrën se si stili vizual ndikon në vlerësimin e arkitekturës lokale në produktet turistike. Aktualisht, tregu shqiptar i suvenireve është i mbingarkuar me produkte që përdorin riprodhime fotografike të monumenteve arkitekturore. Në këtë lloj suveniresh është e lehtë të dallohet një vend turistik i caktuar, por ato nuk tregojnë shumë për kulturën dhe atmosferën e një vendi. Studimi bazohet në teorinë e paraqitjes dhe kulturën vizuale, të cilat mbështesin idenë se ilustrimi i arkitekturës mund t'i bëjë suveniret më interesante për turistët, duke ofruar një kulturë vizuale interpretuese dhe bashkëkohore. Ilustrimi nuk shihet si kopje e ndërtesës, por si një mënyrë për të paraqitur realitetin përmes gjuhës abstrakte, përzgjedhjes së pjesëve apo elementeve më interesante, si dhe rikonfigurimit simbolik. Kërkimi adopton një qasje cilësore me orientim dizajni, duke kombinuar teorinë, vëzhgimin në terren në qytetet kryesore të trashëgimisë shqiptare (si Tirana, Kruja, Durrësi dhe Berati), si dhe analizën e platformave ndërkombëtare (Etsy, Redbubble), dhe klasifikimin e llojeve ekzistuese të përfaqësimit në suvenire. Në këtë mënyrë, suveniret kategorizohen sipas stilit përfaqësues të imazheve. Studimi tregon se në Shqipëri dominon përdorimi i imazheve fotografike, me një prani shumë të kufizuar të ilustrimeve, ndërsa në platformat ndërkombëtare vërehet e kundërta. Bazuar në këtë boshllëk, studimi zhvillon dhe teston një seri prototipash ilustrimi arkitektonik për produkte suvenire, duke eksploruar stile të ndryshme vizuale që variojnë nga vizatimi minimalist me linja deri te interpretimet abstrakte dhe atmosferike. Gjetjet sugjerojnë se ilustrimi arkitektonik ka potencial të fortë komunikues dhe kulturor në suvenire, duke mundësuar përfaqësime më shprehëse, narrative dhe të bazuara në identitetin e trashëgimisë. Punimi përfundon se kalimi nga dokumentimi fotografik drejt ilustrimit interpretues mund të kontribuojë në një praktikë më bashkëkohore dhe më domethënëse të dizajnit të suvenireve në Shqipëri.

Fjalë kyçe

Dizajn suveniresh, ilustrim arkitektonik, kulturë vizuale, trashëgimi shqiptare

Të mësuarit përmes krijimit: Procesi kreativ si metodë e të mësuarit në edukimin arkitekturor

Brunilda Basha

brunildabasha@unyt.edu.al

Universiteti i New York Tirana, Shqipëri

Abstrakt

Edukimi bashkëkohor në arkitekturë kërkon gjithnjë e më shumë qasje pedagogjike që tejkalojnë transmetimin pasiv të njohurive dhe orientohen drejt të nxënit eksperimental dhe të përqendruar te studenti. Në këtë kontekst, procesi kreativ mund të kuptohet jo vetëm si një formë e shprehjes artistike, por edhe si një metodë e të mësuarit, përmes së cilës studentët ndërtojnë njohuri, interpretojnë përvojat hapësinore dhe zhvillojnë mendimin kritik. Ky punim shqyrton rolin e praktikave krijuese si mjete pedagogjike në edukimin e arkitekturës dhe dizajnit, përmes një serie eksperimentesh mësimore të bazuara në praktikë, të zhvilluara në lëndë studioje dhe teorike. Duke u mbështetur në praktikën e mësimdhënies, punimi paraqet një sërë ushtrimesh projektimi dhe përfaqësimi që inkurajojnë studentët të përkthejnë njohuritë teorike, analizën hapësinore dhe marrëdhënien me klientin në produkte krijuese. Këto përfshijnë modelimin tridimensional si akt interpretues, eksplorime fotografike të frymëzuara nga estetika e Polaroid-it për të kapur hapësirën si “momente të ngrira”, si edhe një projekt vile me klient real, ku studentët realizuan piktura abstrakte për të shprehur personalitetin dhe botëkuptimin e klientit. Përveç kësaj, u realizua edhe një pyetësor me studentët që morën pjesë në këto ushtrime, me qëllim kuptimin e perceptimit të tyre mbi përvojën mësimore dhe vlerësimin e ndikimit që këto metoda kreative kishin në përfshirjen dhe përvetësimin të tyre me lëndën dhe procesin e të nxënit. Gjetjet tregojnë se metodologji të tilla kreative forcojnë angazhimin e studentëve, ndërgjegjësimin hapësinor, empatinë dhe aftësitë interpretuese, duke krijuar një lidhje më të thellë ndërmjet njohurive teorike dhe aplikimit praktik. Përgjigjet e studentëve treguan gjithashtu se këto ushtrime perceptoheshin si më interaktive, më të kujtueshme dhe më kuptimplota në krahasim me format tradicionale të mësimdhënies. Punimi argumenton se kreativiteti duhet të pozicionohet si një strategji pedagogjike e strukturuar dhe si një formë legjitime e prodhimit të dijes në edukimin arkitekturor. Duke theksuar të nxënit përmes krijimit, vëzhgimit, interpretimit dhe reflektimit, studimi kontribuon në diskutimet bashkëkohore mbi inovacionin në pedagogjinë e artit dhe dizajnit dhe promovon qasje më të orientuara drejt procesit në mësimdhënien e arkitekturës.

Fjalë kyçe

Procesi kreativ, pedagogjia arkitekturore, të nxënit eksperimental, përfaqësimi dhe interpretimi, të nxënit përmes artit

Interpretimi i kodeve të zisë në art

Merita Toçila

galeri.info@yahoo.com

Universiteti Politeknik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Në ndërthurjen e artit bashkëkohor me traditën spikasin artistë që nuk reshtin së kërkuari në trashëgimi. Veprat e tyre vijnë si një jehonë e së kaluarës, e cila synon të vendosë lidhje me të tashmen përmes një gjuhe të pasur figurative. Ideja artistike dhe narracioni figurativ zhvillohen herë në një regjistër të gjerë, duke u ndalur te ritet, doket dhe zakonet, e herë përmes detajesh, imtësish e gjestesh. Një element i dukshëm i kësaj paraqitjeje mbetet veshja. Jo rrallë ndeshim edhe vepra që dëshmojnë, ndër të tjera, fragmente të ritit mortor. Riti mortor, i trajtuar në pikturë, skulpturë, fotografi, video dhe medime të tjera, shpalos ndikimin që jeta dhe shtresëzimet kulturore ushtrojnë mbi memorien individuale, e cila përcillet te publiku përmes një interpretimi të ri. Nga vajtimet e burrave dhe grave, te varrimet në vende të zakonshme apo thuajse të shenjta, te procesi i përgatitjes së trupit, rregullimi dhe veshja e tij, si një element dominues i ritit mortor, gjithçka të çon drejt kërkimit të zakoneve të të parëve, madje edhe të kultit të tyre, të mishëruar në kujtesën e heroit. Kjo qasje sensibilizuese provokon kujtesën e shikuesit, duke e lidhur atë me histori dhe data, të afërta apo të largëta, për të kujtuar ngjarje dhe ata që nuk janë më. Artisti bashkëkohor e arrin këtë duke ndërhyrë në kufijtë e kohës për heroin, atë njerëzorin, pa bukuri ideale dhe pa fuqi të hiperbolizuara, i cili vdes si çdo njeri i zakonshëm, por sfidon fatin përmes aktit të tij, duke pasur si dëshmitar të fundmë edhe veshjen.

Fjalë kyçe

Art pamor, trashëgimi, kostumografi

Piktura murale ndërmjet artit, kuptimit dhe trashëgimisë. vëzhgime ikonografike dhe historike mbi një monument postbizantin

Rozela Dhimgjini

rozela_dhimgjini@yahoo.de

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim trajton kompleksitetin artistik, ikonografik dhe historik të pikturës murale në një monument postbizantin të shek. XVII–XVIII në Shqipërinë Juglindore: Kishën e Kryeëngjëjve (Shën Mëhillit) në Vithkuq. Nëpërmjet analizës së programit ikonografik, strukturës figurative dhe kontekstit historik të realizimit të afreskeve (1728), synohet të dokumentohet dhe interpretohet një trashëgimi vizuale që plotëson mungesën e burimeve të shkruara për këtë periudhë. Studimi mbështetet në metodologjinë ikonografike dhe krahasimore, duke analizuar shpërndarjen tematike të skenave, përzgjedhjen e shenjtorëve dhe elementet stilistike, si dhe duke i krahasuar ato me monumente bashkëkohore të rajonit të Epirit dhe dioqezës së Ohrit. Rezultatet tregojnë se kisha ndjek skemën tipike të programit ikonografik postbizantin, por dhe përmban një sërë veçantish domethënëse, si theksimi i prejardhjes njerëzore të Marisë përmes paraqitjes së Lajmërimit të Joakimit dhe Anës në absidë, figurimi i hershëm i Shën Joan Vladimirit si martir “kefaloforos”, si dhe cikli apokaliptik në narteks me burime perëndimore. Këto elemente dëshmojnë ndërthurjen e traditës bizantine me influenca kulturore, politike dhe artistike të kohës, duke e bërë këtë monument një dëshmi të rëndësishme të identitetit kulturor ortodoks në shek. XVIII.

Fjalë kyçe

Ikonografi, ikonologji, pikturë murale, trashëgimi kulturore

Përshkrimi i veshjes popullore shqiptare në shekullin XIX: krahasim ndërmjet autorëve Shqiptarë dhe të huaj

Denada Zebi, Anila Mullahi

denadazebi@gmail.com, anila.mullahi@fhf.edu.al

Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Veshja popullore shqiptare është një nga elementet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Ajo shpreh identitetin historik dhe statusin social të komuniteteve me anë të një forme komunikimi simbolik. Shekulli XIX është një moment kyç për dokumentimin e kësaj kulture. Kjo është për shkak të interesit të shtuar të udhëtarëve evropianë që vizituan Ballkanin dhe punës pasuese të studiuesve shqiptarë. Qëllimi i këtij punimi është të bëjë një analizë krahasuese të përshkrimeve të veshjes tradicionale të shekullit XIX. Fokusi është veçanërisht tek veshja femërore, për të evidentuar dallimet në qasje dhe interpretim ndërmjet autorëve shqiptarë dhe atyre të huaj. Metodologjia e ndjekur mbështetet në një qasje cilësore dhe krahasuese. Kjo përfshin analizimin e literaturës ekzistuese etnografike dhe shkrimeve historike. Hulumtimi është strukturuar në tri faza: përzgjedhja e burimeve parësore, analiza e elementeve strukturorë dhe dekorativë të veshjes së grave, dhe ballafaqimi i diskutimeve narrative për të identifikuar pikat e takimit dhe dallimit ndërmjet vëzhguesve. Rezultatet tregojnë se larmia e formave dhe materialeve si leshi, liri e pambuku lidhet ngushtë me diversitetin krahinor dhe kushtet gjeografike. Gjetjet kryesore tregojnë se autorët e huaj zakonisht përqendrohen në aspektin estetik dhe elegancën vizuale të veshjes tradicionale, ndërsa studiuesit shqiptarë ofrojnë një analizë më sistematike. Ata fokusohen në zhvillimin historik dhe simbolikën e motiveve dekorative, si në rastin e xhubletës. Në përfundim, studimi tregon se perspektivat e autorve të huaj dhe ato të studiuesve dhe shkrimtarve vëndas janë plotësuese për një kuptim më të plotë të trashëgimisë.

Fjalë kyçe

Etnografi, xhubleta, identitet kulturor, antropologji, simbolikë

Turizmi kulturor – një urë mes të shkuarës dhe të tashmes: Onufri i Neokastros

Eneda Shypheja

eneda_sh87@hotmail.com

Universiteti “Aleksandër Xhuvani“, Elbasan, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim shqyrton turizmin kulturor si një mekanizëm ndërmjetësues midis trashëgimisë historike dhe zhvillimit bashkëkohor, duke u fokusuar në figurën dhe trashëgiminë artistike të ikonografit të shekullit XVI, Onufrit të Neokastros. Studimi synon të theksojë rëndësinë e trashëgimisë ikonografike si një komponent themelor në formësimin e identitetit kulturor kombëtar dhe në forcimin e ofertës së turizmit kulturor në Shqipëri, veçanërisht në një kontekst ku turizmi është shndërruar në një sektor strategjik të rritjes ekonomike. Hulumtimi mbështetet në një metodologji cilësore dhe ndërdisiplinore, e bazuar në analizë dokumentare, shqyrtim kritik të literaturës mbi artin postbizantin dhe turizmin kulturor, si dhe në analizë ikonografike dhe semiotike të veprave të përzgjedhura të atribuara Onufrit. Gjetjet tregojnë se trashëgimia ikonografike paraqet një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis kujtesës historike, identitetit komunitar dhe gjallërimit ekonomik lokal. Veprat e Onufrit, të karakterizuara nga veçori të dallueshme stilistike, individualizim shprehës i figurave dhe përdorimi i njohur i toneve intensive të së kuqes, përbëjnë një element unik të trashëgimisë artistike shqiptare dhe një aset strategjik për turizmin tematik, edukativ dhe fetar. Përtej vlerës së tyre estetike, këto ikona funksionojnë si narrativa vizuale që pasqyrojnë simbolikë teologjike, realitete shoqërore dhe shkëmbime kulturore të periudhës postbizantine. Ruajtja dhe interpretimi i tyre u ofrojnë vizitorëve përvoja domethënëse kulturore, duke lidhur shprehjen artistike me kujtesën historike. Studimi përfundon se integrimi sistematik i trashëgimisë ikonografike në strategjitë kombëtare dhe rajonale të turizmit është thelbësor, së bashku me zhvillimin e itinerareve kulturore të strukturuar dhe forcimin e bashkëpunimit institucional për ruajtjen, promovimin dhe valorizimin e kësaj trashëgimie kulturore në funksion të zhvillimit afatgjatë të qëndrueshëm, rritjes së kulturës qytetare dhe angazhimit më të gjerë publik në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Fjalë kyçe

Trashëgimi ikonografike, art postbizantin, zhvillim i qëndrueshëm, identitet komunitar, valorizim kulturor

Interesimi i piktorëve të Rilindjes Kombëtare për etnografinë

Fjoralba Prifti, Mikel Temo

prifti.fjoralba@gmail.com, mikeltemo@hotmail.com

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë, Shqipëri, Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Analiza e transformimit të objektit muzeor, nga një artefakt me funksion liturgjik, historik dhe artistik, në një element qendror të përvojës bashkëkohore muzeale, duke marrë si studim rasti Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar (MKAM) në Korçë. Në kontekstin e teorive moderne të interpretimit të trashëgimisë kulturore, muzeu konsiderohet jo vetëm si hapësirë ruajtjeje dhe konservimi, por si një platformë dialogu ndërmjet së kaluarës dhe publikut të sotëm.

Studimi mbështetet në analizën e ekspozitës së përhershme dhe atyre të përkohshme, dokumentacionit institucional, si dhe praktikave interpretative të zbatuara në MKAM. Ai shqyrton mënyrën se si ikonat, objektet liturgjike dhe veprat e artit bizantin dhe post-bizantin kontekstualizohen përmes narrativës muzeale, organizimit hapësinor, gjuhës interpretative dhe mjeteve informuese tradicionale e digjitale. Elementët kyç të analizës përfshijnë ndërthurjen e dimensioneve artistike dhe historike me sfidën e përfshirjes së dimensionit shpirtëror të traditës fetare brenda një hapësire muzeale laike, (në rastin e MKAM). Përdorimi i teknologjive digjitale, programeve edukative dhe strategjive të reja komunikimi ka ndikuar në ndërtimin e një përvoje më të integruar, ndërvepruese dhe të aksesueshme për vizitorin. Eksperienca e deri-tashme ka treguar se interpretimi bashkëkohor në MKAM, jo vetëm ka rritur cilësinë e përvojës muzeale, por ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e interesit publik dhe në shtimin e numrit të vizitorëve, duke zgjeruar profilin e audiencës drejt grupeve të reja, veçanërisht të rinjve dhe turistëve ndërkombëtarë. Në këtë mënyrë, muzeu vazhdon të kontribuojë në riformësimin e marrëdhënies midis trashëgimisë mesjetare dhe publikut bashkëkohor, duke forcuar ndërgjegjësimin kulturor, përfshirjen qytetare dhe rolin e tij në zhvillimin kulturor e turistik të rajonit. Punimi synon të kontribuojë në diskutimin mbi rolin e MKAM në interpretimin e trashëgimisë kulturore në kontekstin shqiptar dhe ndërkombëtar, duke e propozuar atë si një model analitik të aplikueshëm edhe në institucione të tjera muzeale me profil të ngjashëm.

Fjalë kyçe

MKAM, interpretimi i trashëgimisë kulturore, art bizantin dhe post-bizantin, programe edukative, teknologji digjitale në muze

Midis Lindjes dhe Perëndimit Michele Greco da Valona dhe formësimi i Rilindjes adriatike

Mikel Temo

mikeltemo@hotmail.com

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull rishqyrton prodhimin artistik të Michele Greco da Valona, një piktor nga adriatiku, aktiv në Italinë e Jugut në fillim të shekullit XVI, vepra e të cilit është marginalizuar prej kohësh në historiografinë e artit të Rilindjes si një mbijetesë konservatore e traditës bizantine. Nëpërmjet analizës stilistike, kontekstualizimit historik dhe angazhimit me studimet e fundit mbi shkëmbimet kulturore adriatike, studimi argumenton se Greco duhet të kuptohet si një ndërmjetës midis sistemeve vizuale bizantine dhe atyre të Rilindjes italiane. Veprat e tij të nënshkruara, të realizuara brenda komuniteteve ortodokse dhe të rritit grek në rajone si Molise dhe Abruzzo, zbulojnë një sintezë të qëllimshme ku autoriteti ikonografik bizantin bashkëjeton me organizimin hapësinor të Rilindjes, fjalorin ornamental dhe modelimin figurativ. Duke e vendosur Grecon në kuadrin e Rilindjes Adriatike, artikulli sfidon modelet rigide qendër–periferi dhe thekson lëvizshmërinë artistike, patronazhin hibrid dhe rrjetet ndërrajonale nëpër pellgun e Adriatikut. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në një rivlerësim më të gjerë të kulturës së Rilindjes si një fenomen i shumfishtë dhe i negociuar, i formësuar nga ndërveprimi i vazhdueshëm midis traditave vizuale të krishtera lindore dhe perëndimore.

Fjalë kyçe

Michele Greco da Valona, Rilindja Adriatike, piktura pasbizantine, diaspora arbëreshe, lëvizshmëria artistike, ikonografia ortodokse, Italia e jugut, ndërmjetësim kulturor

Mozaiku i Bankës së Shqipërisë, trashëgimi, identitet dhe turizëm kulturor

Eduard Sinaj

info@mozaikartistik.com

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim kërkon të marrë në shqyrtim mozaikun monumental të Muzeut të Bankës së Shqipërisë si një objekt mjaft i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore dhe historike, duke evidentuar atë si pjesë të identitetit kombëtar përmes mozaikut dhe mediumit të përdorur, si dhe rëndësisë së zhvillimit të turizmit kulturor. I vendosur në hapësirën “Rondo” të muzeut, mozaiku përfaqëson jo vetëm një vepër me vlera të spikatura artistike, por edhe një medium të rëndësishëm për komunikimin e vlerave artistike, historike dhe ekonomike në një kontekst bashkëkohor muzeal. Ky punim në mënyrë analitik shqyrton karakteristikat e kësaj vepre, duke dashur të theksojë rëndësinë e përdorimit të mediumit, materialet e përdorur për realizimin e tij si dhe rëndësinë veçantisë së këtij objekti, si shprehje e identitetit kulturor përmes artit monumental. Metodologjia e përdorur mbështetet në një qasje cilësore, duke kombinuar analizën përshkruese dhe interpretuese të elementeve mbi të cilën është krijuar ky mozaik në raport me ikonografinë dhe simbolikën që përçon mozaiku si objekt muzeal. Analiza fokusohet në analizën e elementeve të tillë si: kompozimi artistik, përdorimi i ngjyrës, materialet e përdorura, shprehja tematike e saj e cila pasqyron aspekte të jetës ekonomike, si: bujqësia, blegtoria dhe peshkimi, duke ndërtuar një narrativë vizuale mbi zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të periudhës kur është krijuar. Bazuar në kete analizë përshkruese të këtyre elementeve disa nga gjetjet e punimit evidentojnë se mozaiku funksionon si një faktor i rëndësishëm kulturor, duke rritur vlerën artistike, estetike dhe kulturore të hapësirës muzeale të kësaj ndërtese. Gjithashtu, kjo analizë shërben për të kontribuar promovimin e trashëgimisë kulturore, duke ndihmuar në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe turistik. Në përfundim, punimi thekson rëndësinë e veçorive artistike të përdorura në mozaikun e Bankës së Shqipërisë, i cili karakterizohet nga një larmi e pasur ngjyrash, ku mbizotëron okra, e shoqëruar me nuanca smeraldi, violet dhe të gjelbër, dhe krijuar një harmoni vizuale dhe simbolike në raport me ndërtesën e Bankës së Shqipërisë, veçori që krijojnë edhe një kontribut në promovimin e trashëgimisë kulturore, duke ndihmuar në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe turistik.

Fjalë kyçe

mozaiku i Bankës së Shqipërisë, trashëgimia kulturore, identiteti kombëtar, turizmi kulturor, turizmi muzeal, muzeologjia

Skulptura monumentale në Shqipërinë e viteve '70: diskursi estetik dhe funksioni edukativ në ndërtimin e ndërgjegjes kolektive

Kujtim Halili

kujtim_halili@universitetipolis.edu.al

Universiteti POLIS, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Skulptura monumentale shqiptare e viteve '70 përfaqëson një nga fazat më të konsoliduara të realizmit socialist në hapësirën publike. Në këtë periudhë, arti monumental u institucionalizua si instrument estetik dhe ideologjik, duke materializuar narrativën historike të shtetit socialist përmes figurave heroike, kompozimeve kolektive dhe simbolikës së sakrificës. Vepra të tilla si monumentet publike, apo ansamblet perkujtimore si Monumenti i 1920 në Vlorë dhe kompleksi monumental i Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë, artikulojnë një gjuhë plastike të bazuar në monumentalitet, linearitet të qartë strukturor dhe pathos narrativ. Nga pikëpamja formale, skulptura e kësaj dekade karakterizohet nga trajtimi volumor kompakt, ritmizimi i planeve dhe theksimi i gjestit si bartës i mesazhit ideologjik. Figura njerëzore paraqitet e idealizuar, me proporcione të zmadhuara dhe me një tension të brendshëm që synon të transmetojë heroizëm kolektiv. Materialet e përdorura – kryesisht bronzi dhe guri – kontribuonin në përjetësimin simbolik të figurës dhe në integrimin e saj me arkitekturën përreth. Rëndësia edukative e kësaj skulpture në shoqërinë shqiptare të viteve '70 ishte thelbësore. Monumentet funksiononin si hapësira pedagogjike në natyrë, ku qytetarët – veçanërisht brezat e rinj – adoptonin modele të sakrificës, punës dhe solidaritetit socialist. Përmes ritualeve perkujtimore, ceremonive shtetërore dhe programeve shkollore, arti monumental u shndërrua në një mjet të formimit ideologjik dhe të konsolidimit të kujtesës kolektive. Në këtë kuptim, skulptura monumentale e viteve '70 nuk ishte thjesht një praktikë artistike, por një mekanizëm kulturor i projektuar për të ndërtuar identitetin, për të orientuar ndërgjegjen historike dhe për të strukturuar edukimin qytetar në funksion të projektit politik të kohës.

Fjalë kyçe

Skulpturë, monumentalitet, ideologji, realizëm, heroizëm

Fillesat e prezencës së nudos në artin publik shqiptar (1927–1943). Trupi i zhveshur midis moralit shoqëror dhe estetikës fashiste.

Agron Mesi

mesiagron@gmail.com

Akademia e Shkencave Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky shkrim analizon kontekstin historik, kulturor dhe ideologjik të paraqitjes së trupit të zhveshur në artin publik shqiptar gjatë periudhës së gjysmës së parë të shekullit të XX, dhe për më konkretisht mes viteve 1927–1941. Ndërsa nudoja përbënte një zhanër të konsoliduar në traditën akademike evropiane, në Shqipëri ajo u shfaq vonë dhe në kushte të veçanta shoqërore. Deri në dekadat e para pas pavarësisë, normat morale konservatore të shoqërisë shqiptare të kohës e kufizuan lëvrimin dhe ekspozimin e nudos si zhanër arti brenda vendit. Megjithatë, bashkëngjitur me procesin e modernizimit urban të Shqipërisë nën protektoriatin e Italisë fashiste, nudoja, apo më mirë të themi figura e zhveshur njerëzore, u integrua si pjesë e artit publik në disa projekte arkitekturore shtetërore të asaj kohe. Duke analizuar raste si skulptura e Bankës Kombëtare Tregtare në Durrës, relievet e Bankës së Shtetit në Tiranë, relievin e Maternitetit Mbretëresha Geraldinë dhe ansamblin e Pallatit Mbretëror po në Tiranë, mund të themi se prania e trupit të zhveshur në artin e hapësirave publike të kohës nuk erdhi dhe aq si rezultat organik i një emancipimi të brendshëm estetik, por më së shumti si pjesë e transferimit të estetikës monumentale dhe biopolitikës fashiste italiane në Shqipëri. Duke u mbështetur në qasjet teorike të artikuluara nga Clark, Foucault, Mosse, Benjamin, Berger dhe Butler, studimi e interpreton trupin e zhveshur në artin publik shqiptar të kësaj periudhe kohore si kod normativ dhe instrument ideologjik në shërbim të projektit shtetëror. Në të njëjtën kohë, fakti i prezencës së një nudoje në një hapësirë private në qytetin e Shkodrës na dëshmon për një rast specifik dhe të veçuar të kohës, i cili na vjen si përpjekje e borgjezisë së re për një negociim kulturor midis traditës vendase dhe modernitetit të importuar. Studimi kontribuon në shikimin kritik të historisë së artit shqiptar duke e vendosur atë në dialog me debatet mbi trupin, modernitetin dhe politikën.

Fjalë kyçe

Nudo, trup i zhveshur, art publik, fashizëm, biopolitikë, traditë, modernizim

Kultura materiale shqiptare midis fshatit dhe qytetit në epokën e globalizimit

Ervin Meniko

emeniko@yahoo.com,

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull synon të trajtojë ndryshimet në kulturën materiale në Shqipëri, duke u mbështetur në marrëdhënien në zhvillim midis fshatit dhe qytetit pas periudhës së socializmit, si edhe në proceset e integritit ekonomik dhe kulturor global. Në vend që modernizimi të shihet si një proces i degradimit kulturor, artikulli synon të shqyrtojë mënyrat në të cilat objektet zhvillojnë forma të reja kuptimore gjatë transferimit të tyre nga botët rurale drejt qytetit ose hapësirave turistike. Kërkimi bazohet në studime rasti nga Shqipëria veriore dhe jugore, duke përfshirë veshjet dhe tekstilet, pajat, arkitekturën prej guri në qendrat historike të Gjirokastrës dhe Beratit, si edhe përdorimin e formave etnografike në qytet për qëllime komerciale. Perspektiva teorike mbështetet në teorinë e kulturës materiale dhe në teorinë kritike të trashëgimisë, duke u mbështetur në punimet e disa studiuesve, fusha kryesore e kërkimit të të cilëve është Shqipëria. Sa i përket metodologjisë së kërkimit, artikulli përdor metodën krahasuese për të analizuar rolin e diferencuar që objektet luajnë në kontekste të ndryshme hapësinore. Në kontekstin e fshatit, objektet janë kryesisht të rutinizuara dhe të ritualizuara, ndërsa në kontekstin urban ato estetizohen kryesisht si trashëgimi, si shënues simbolikë ose si marka kombëtare. Migrimi nga zonat rurale drejt qytetit, veçanërisht nga rajonet malore drejt Tiranës, përbën një faktor që luan një rol ndërmjetësues në këtë proces. Gjatë migrimit, objektet marrin rolin e bartësve të një forme kujtese që mund të quhet kujtesë materiale; ato shndërrohen në një formë të prekshme përkatësie në një proces ndryshimesh shoqërore të përshpejtuara. Artikulli sugjeron se kultura materiale në Shqipëri nuk është një formë mbetjeje e së kaluarës, por një proces negociimi adaptues, i cili ruan vazhdimësinë ndërkohë që gjeneron kuptime simbolike që tejkalojnë kufijtë hapësinorë.

Fjalë kyçe

Objektet, kultura materiale, trashëgimia, hapësinor

Deformimi dhe e Vërteta (Mbi karikaturën në Shqipërinë gjysmën e dytë të shek. XX)

Ermir Hoxha

ermirhoxha@yahoo.com

Universiteti POLIS, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim trajton zhvillimin historik, funksional dhe estetik të karikaturës në Shqipëri, duke e analizuar atë si një formë shprehjeje artistike dhe njëkohësisht si instrument kritik shoqëror e politik. Duke u mbështetur në origjinën evropiane të zhanrit dhe në evolucionin e tij nga një praktikë grafike humoristike në një mjet të fuqishëm komunikimi publik, punimi shqyrton mënyrën se si karikatura u përshtat dhe u transformua në kontekstin shqiptar, sidomos në raport me zhvillimet historike, ideologjike dhe kulturore të shekullit XX. Punimi ndalet veçanërisht në rolin e karikaturës në periudha të ndryshme historike, nga fillimet e saj në shtypin e hershëm shqiptar dhe përfaqësimet e Shqipërisë në shtypin evropian, deri te institucionalizimi i saj gjatë periudhës së realizmit socialist dhe transformimet pas viteve '90. Përmes analizës së autorëve, veprave dhe diskursit vizual, studimi evidenton karikaturën si një hapësirë ku ndërthuren deformimi artistik, simbolika politike dhe reflektimi shoqëror. Në plan teorik, punimi trajton deformimin si gjuhë estetike dhe si mekanizëm kritik, duke e vendosur karikaturën në raport me zhvillimet e artit modern dhe me funksionin e saj në formësimin e opinionit publik. Në përfundim, studimi argumenton se karikatura shqiptare përfaqëson një dëshmi të rëndësishme të ndërveprimit mes artit, ideologjisë dhe shoqërisë, duke ruajtur një rol aktiv në memorien kulturore dhe në diskursin bashkëkohor vizual.

Fjalë kyçe

Historia e artit Shqiptar, karikatura, deformimi, e vërteta

Përkthimi i koncepteve në gjuhë vizuale: Një metodologji mësimdhënie për të komunikuar përmes artit për studentët e arkitekturës dhe dizajnit

Joan Ikonomi, Iris Nela

joanikonomi@umb.edu.al, irisnela@umb.edu.al,

Departamenti i Industrive Kreative, Universiteti Marin Barleti

Abstrakt

Në fushat e edukimit që lidhen me arkitekturën dhe dizajnin, përkthimi i koncepteve në gjuhë vizuale dhe hapësinore, si dhe shndërrimi i tyre në një vepër të prekshme, mbetet një proces fleksibël dhe i hapur, duke përbërë një sfidë të rëndësishme pedagogjike. Megjithëse gjuha vizuale përdoret gjerësisht në disipinat artistike, metodologjitë e mësimdhënies ende nuk janë të strukturuar në mënyrë të qartë përmes një rrjedhe pune (workflow) që udhëheq hap pas hapi mendimin konceptual drejt produktit final vizual. Ky punim synon të trajtojë këtë boshllëk duke propozuar një metodologji pedagogjike të përshtatur për studentët e arkitekturës dhe dizajnit, e cila i orienton ata në zhvillimin e një produkti artistik përmes procesit “të menduarit përmes bërjes”, duke nisur nga koncepti fillestar. Metoda e propozuar strukturohet në gjashtë faza: përcaktimi i problemit dhe konceptit, identifikimi i disa fjalëve kyçe domethënëse, analiza e veprave referuese, zhvillimi i skicave, eksperimentimi me media dhe materiale të ndryshme, si dhe realizimi i produktit përfundimtar. Edhe pse e strukturuar në mënyrë të qartë, kjo metodologji mbetet e hapur në çdo fazë ndaj një procesi ndërveprues të mendimit dhe krijimit. Në çdo hap, ideja evoluon përmes analizës së thelluar dhe eksperimentimit. Ky studim bazohet në analizën e projekteve të studentëve të zhvilluara në kursin Gjuha vizuale. Gjetjet tregojnë se rastet më të suksesshme janë ato ku ekziston një ndërveprim i vazhdueshëm midis skicimit, testimit të materialeve dhe zhvillimit të konceptit, i mbështetur nga eksperimentimi i thelluar në çdo fazë. Në këtë mënyrë, studimi evidenton vlerën pedagogjike të një metodologjie të strukturuar, por fleksibël, në forcimin e kritikes vizuale dhe mendimit hapësinor në edukimin e dizajnit, duke çuar drejt produkteve artistike më të artikuluar dhe konceptualisht më të qëndrueshme.

Fjalë kyçe

gjuhë vizuale, edukim artistik, vizualizim i konceptit, dizajn, arkitekturë

Identiteti lokal në artin figurativ në epokën e globalizimit vizual

Eris Tare, Blegina Hasko Bezo

eris.tare@outlook.com, bleginahasko@gmail.com

Galeria e Artit Tiranë; Fakulteti i Shkencave Humane,
Edukimit dhe Arteve Liberale, Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt

Globalizimi vizual, i përshpejtuar nga teknologjitë digjitale dhe qarkullimi transnacional i imazheve, ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si arti figurativ prodhohet dhe perceptohet. Ky punim synon të analizojë marrëdhënien midis identitetit lokal dhe globalizimit vizual në artin bashkëkohor, duke e trajtuar veprën artistike si një hapësirë dialogu mes traditës dhe ndikimeve globale. Studimi mbështetet në një qasje ndërdisiplinore, duke kombinuar teorinë e globalizimit kulturor, studimet vizuale dhe analizën estetike të praktikave figurative, me fokus të veçantë në kontekstin shqiptar dhe rajonal. Përmes analizës së motiveve ikonografike, përdorimit të materialeve dhe strategjive vizuale, argumentohet se identiteti lokal nuk zhduket, por transformohet në forma dinamike dhe hibride shprehjeje. Gjetjet kryesore tregojnë se artistët bashkëkohorë ndërthurin me sukses simbolet tradicionale me gjuhën moderne digjitale, duke krijuar narrativa që sfidojnë homogjenizimin estetik. Rezultatet sugjerojnë se procesi i hibridizimit nuk duhet parë si humbje e autenticitetit, por si zgjerim i potencialit krijues. Ky studim arrin në përfundimin se arti figurativ ruan identitetin duke e adaptuar atë ndaj sfidave të epokës digjitale, duke shërbyer si mjet kritik për dialogun ndërkulturor. Si rekomandim kryesor, punimi thekson nevojën për integrimin e vetëdijes kritike mbi identitetin në kurrikulat e edukimit artistik, për të forcuar pozicionin e artistëve lokalë në tregun global. Përfundimisht, inkurajohet krijimi i platformave që mbështesin kërkimin artistik mbi kujtesën materiale dhe rikonceptualizimin e trashëgimisë si një element kyç i qëndrueshmërisë kulturore në një botë të ndërlidhur, ku arti mbetet ura kryesore e komunikimit universal.

Fjalë kyçe

Hibridizim kulturor, teknologji digjitale, kujtesë kolektive, kreativitet, estetikë bashkëkohore

Gjuha e trupit, trauma dhe performanca teatrale

Armela Demaj

armela.demaj@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull e trajton performancën skenike si proces psikofizik dhe organizues, ku trupi dhe mendja funksionojnë si sistem i integruar neurofiziologjik dhe estetik. Studimi në brendësinë e tij përpiqet ta analizojë trupin e aktorit jo si instrument ilustrues emocional, por si arkitekturë tensioni, energjie dhe kujtese fizike mbi përvojat e mëparshme. Këtu përfshihen edhe përvojat traumatike, të cilat arkivohen në trup si modele të kësaj kujtese dhe që manifestohen më pas në tonusin muskolor, frymëmarrjen, posturën dhe reagimet instiktive. Duke u mbështetur në antropologjinë teatrale të trupit pre-ekspresiv, ky studim vendos në dialog praktikën performative me teoritë bashkëkohore të traumës, rregullimit autonom dhe organizimit neurofiziologjik, duke propozuar një qasje ndërdisiplinore mbi marrëdhënien midis strukturës fizike dhe formës estetike. Gjate trajtimit të hipotezës qendrore argumentohet se Metodologjia e Riorganizimit Somatik në Performancë (MRSP) mundëson transformimin e impulseve dhe tensioneve trupore në struktura të organizuara performative përmes katër parimeve operative:

- a) diferencimit midis trupit real dhe trupit performativ,
- b) strukturimit të tensionit si material kompozicional,
- c) përdorimit të ritmit dhe përsëritjes si mekanizma rregullatorë të sistemit nervor,
- d) transformimit të simptomës në gjest të disiplinuar, të artikuluar dhe të riprodhueshëm.

Kjo qasje ka për qëllim orientimin praktik-teorik dhe analizën konceptuale, duke e trajtuar laboratorin skenik si një hapësirë kërkimi mbi organizimin somatik, pa qëllime terapeutike apo ndërhyrje klinike. Analiza studimore e aplikuar në këtë artikull na tregon se tensioni i strukturuar, organizimi biomekanik dhe ciklet ritmike krijojnë kushte për stabilizim autonom, zhvillim të vetëdijes së dyfishtë dhe rritjen e kontrollit ndaj trupit të aktorit. Është pikërisht kjo perspektivë e cila e pozicionon trupin si sistem aktiv transformimi, duke garantuar integritet psikofizik, qëndrueshmëri metodologjike dhe koherencë estetike në veprim performativ bashkëkohor. Në tërësinë e tij artikulli ofron një kuadër teorik për të kuptuar dhe menaxhuar tensionet dhe kujtesën trupore në performancën teatrale.

Fjalë kyçe

Trup psikofizik, antropologji teatrale, vetëdije e dyfishtë, riorganizim somatik, tension i strukturuar

Artikuli në ligjërimin publik: dimensione gjuhësore, komunikative dhe skenike

Kristjan Koroveshi

kkoroveshi@live.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim studion artikulin jo thjesht si një proces mekanik të diksionit, por si një “ngjarje performative” ku ndërthuren logos-i, pathos-i dhe ethos-i. Në mjedisin shqiptar të pas-viteve ‘90, ky element është trajtuar shpesh si një “aksesor” dekorativ, duke neglizhuar funksionin e tij si urë materializimi e mendimit dhe mjet i “pushtetit simbolik” të folësit. Rëndësia e hulumtimit qëndron në propozimin e një qasjeje të re ndërdisiplinore që integron kulturën e gjuhës me sociologjinë e pushtetit dhe artin skenik, për të adresuar difektet e kulturës së të folurit në mediumin publik. Bazohet në një analizë kritike dhe krahasimore të ligjërimin publik shqiptar, duke përdorur si pikënisje pyetjen kërkimore: Deri në ç’masë elementet skenike (zëri, pauza, ritmi) dominojnë mbi saktësinë gjuhësore dhe si ndikojnë ato në ndërtimin e autoritetit të folësit? Studimi analizon raportin midis saktësisë gjuhësore dhe teknikës së të folurit, duke i vëzhguar ato si praktika të vullnetshme që disiplinojnë më së miri diskursin. Nga analiza rezulton se në hapësirën publike shqiptare ekziston një dominim i “zhurmës” mbi qartësinë e argumenteve. Gjetjet tregojnë se përdorimi i zërit të lartë si mjet bindjeje, në mungesë të njohjes së teknikës së të folurit, krijon një hendek në gjuhën e komunikimit. Studimi dëshmon se artikuli i qartë dikton ritmin e dëgjimit dhe imponon përqendrimin e audiencës, duke u shndërruar në një mjet që legjitimon pozitën e folësit dhe i jep ngjyrim përjetues mesazhit. Arrim në përfundimin se artikuli i kultivuar skenik, jo thjesht teknik, nuk është një luks estetik, por një mjet i domosdoshëm që garanton dinjitetin e komunikimit njerëzor. Rekomandohet që trajnimi përmes teknikave të zërit dhe elementeve skenike të shihet si kusht parësor për “autoritet” në ligjërimin publik dhe eliminimin e “agresivitetit” në të folur që karakterizon mjedisin aktual.

Fjalë kyçe

Pushtet simbolik, teknika skenike, retorikë

Studimet teatrale dhe dekolonizimi epistemik drejt një teorie shqiptare të performancës

Mirela Oktrova

Mirela.Oktrova@ama.gov.al, mirelaoktrova@gmail.com

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

Abstrakt

Dekolonizimi epistemik në studimet teatrale paraqet një qasje studimore transformuese që sfidon paradigmen eurocentrike të historiografisë dhe teorisë së shekujve të fundit. Tradicionalisht, teatri perëndimor - nga Greqia e Lashtë deri te modernizmi evropian - është trajtuar si model universal, duke prodhuar një hierarki epistemike që marginalizon praktikën joperëndimore. Nisur nga ky sfond, dekolonizimi nënkupton jo thjesht zgjerimin e kanonit, por edhe rikonceptimin e teatrit dhe të mekanizmave që përligjin dijen mbi të. Bazuar në teorinë e performancës, kritikën postkoloniale dhe qasjet dekoloniale, dekolonizimi e zhvendos vëmendjen nga paradigma e përqendruar tek teksti drejt një paradigme të fokusuar tek performanca – trupi, rituali dhe komuniteti - si një mënyrë e vetëmjaftueshme e prodhimit të informacionit dhe ndërmjetësimit shoqëror. Në aspektin metodologjik, dekolonizimi i referohet etnografisë, traditave gojore, arkivave të gjalla dhe analizave ndërkulturore për të sfiduar hierarkitë akademike, duke njohur praktikën lokale dhe komunitare si epistemologji të barazvlefshme me to. Në nivel rajonal, dekolonizimi nuk e përcakton relevancën e teatrit shqiptar dhe të Evropës Juglindore duke u nisur nga ngjashmëritë apo dallimet me modelet e traditës evropiane. Praktika si polifonia, cikli epik i kreshnikëve, ritet e kalimit dhe karnavalet urbane interpretohen si struktura performative autonome, duke artikuluar një teori të performancës të rrënjësuar në praktika lokale dhe me relevancë globale. Për rrjedhojë, dekolonizimi epistemik e ripërkufizon fushën si një hapësirë pluraliste dhe shumëqendrore.

Fjalë kyçe

Eurocentrizëm, Historiografi, Ndërkulturalitet, Epistemologji

Gjuha e trupit përballë arkitekturës së pushtetit: monumentalizimi i figurës në një adaptim bashkëkohor të Jul Cezarit

Qëndrim Rijani

qendrimrijani@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon gjuhën e trupit në një adaptim bashkëkohor të Jul Cezarit, të vendosur në portën monumentale hyrëse të Pallatit të Dioklecianit në Split, Kroaci, duke shqyrtuar marrëdhënien midis trupit performativ aktorial dhe arkitekturës historike të pushtetit. Duke u mbështetur në korniza teorike mbi trupin në teatrin modern dhe postmodern, studimi argumenton se hapësira monumentale në këtë rast nuk funksionon si sfond neutral, por si strukturë aktive që formëson dhe monumentalizon figurën aktoriale gjatë performancës. Arkitektura perandorake romake, si materializim i pushtetit të ngrirë në gur, imponon vertikalitet, ceremonialitet dhe hierarki fizike, duke e zhvendosur gjuhën e trupit nga shprehje intime psikologjike në konfigurim kolektiv dhe figurë simbolike. Qasja metodologjike ndërthur analizën performative me praktikën si kërkim (practice-as-research), duke e trajtuar produksionin si studim rasti dhe duke përdorur dokumentimin vizual si material analitik. Përmes analizës së konfigurimeve trupore, organizimit kolektiv dhe raportit midis trupit individual dhe masës arkitektonike, punimi demonstroi se pushteti artikulohej jo vetëm përmes retorikës dramatike, por përmes organizimit fizik të trupave në hapësirë, duke prodhuar një proces të monumentalizimit trupor. Inskeni i shfaqjes në një strukturë të ndërtuar nga një perandor romak krijon një dialog midis trupit të përkohshëm të aktorit dhe arkitekturës së përhershme, duke e transformuar tragjedinë nga narrativë politike në përvojë të materializuar të pushtetit. Studimi sugjeron se analizimi i performancave në hapësira monumentale mund të kontribuojë në zhvillimin e një kornize teorike mbi marrëdhënien midis trupit, pushtetit dhe arkitekturës në teatrin bashkëkohor dhe rekomandon zgjerimin e këtij kërkimi përmes analizave krahasuese dhe integritit të metodave empirike në studimet e ardhshme.

Fjalë kyçe

Hapësirë specifike, monumentalizim trupor, praktikë si kërkim, teatër monumental-politik, arkitekturë monumentale

Pedagogjia e aktrimit si praktikë artistike Rasti i Profesor Niko Kaxherit në Universitetin e Arteve

Valdrin Asani

valdrin.asani@yahoo.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i kësaj kumtese është të analizojë pedagogjinë e aktrimit, si praktikë artistike, në arsimin e lartë, përmes një studimi rasti, mbi veprimtarinë pedagogjike të Profesor Niko Kaxherit, në Universitetin e Arteve, duke shqyrtuar mënyrën, se si përvoja e drejtpërdrejtë skenike e pedagogut ndërthuret me mësimdhënien akademike dhe shndërrohet në një model formimi profesional, për studentët e aktrimit, duke e konceptuar procesin pedagogjik si një vazhdimësi të praktikës artistike dhe jo thjesht si transmetim teknikash interpretative. Pyetja kryesore që shtrohet është: në çfarë mënyre, përvoja artistike e pedagogut ndikon në ndërtimin e metodës mësimore dhe si reflektohet kjo ndërthurje në zhvillimin profesional dhe krijues të studentit aktor? Kjo pyetje synon të eksplorojë jo vetëm ndikimin e përvojës personale në përzgjedhjen e metodave dhe ushtrimeve, por edhe mënyrën se si ajo përkthehet në formim të identitetit artistik, në kultivimin e vetëdijes profesionale dhe në ndërtimin e një etike pune, brenda procesit akademik. Kërkimi mbështetet në një qasje cilësore dhe përfshin analizë teorike, mbi pedagogjinë e aktrimit, intervistë të gjysmë-strukturuar me pedagogun, si dhe dëshmi reflektuese nga studentët, të formuar ndër vite nën drejtimin e tij. Metodologjia synon të ndërthurë perspektivën e pedagogut me përvojën e studentëve, duke krijuar një panoramë të plotë të praktikës mësimore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënies së dyfishtë të pedagogut me dramën “Babai”, të August Strindberg, e cila analizohet si rast konkret i transformimit të përvojës interpretative në instrument pedagogjik. Kjo vepër shërben si pikë referimi për të kuptuar mënyrën se si përvoja skenike, analiza e konfliktit dramatik dhe ndërtimi i karakterit, shndërrohen në materiale mësimore dhe ushtrime konkrete për studentët. Analiza tematike e të dhënave evidenton disa elemente thelbësore të kësaj qasjeje pedagogjike: disiplinën dhe kërkesën e lartë profesionale, si bazë e procesit formues, ndarjen e qartë midis rolit të aktorit dhe atij të pedagogut, për të shmangur imitimim mekanik dhe për të nxitur autonominë krijuese, theksin mbi përjetimin dhe kujtesën emocionale, si mjete për ndërtimin e vërtetësisë skenike, si dhe ndërtimin e një raporti rigoroz pedagog - student, të mbështetur në respekt, përgjegjësi dhe dialog kritik. Këta elementë përbëjnë një model të strukturuar, por njëkohësisht fleksibël, që përshtatet me individualitetin e secilit student. Rezultatet tregojnë, se pedagogjia e bazuar në përvojën e jetuar artistike, krijon një model mësimor dinamik, i cili nxit individualitetin krijues, vetëdijen profesionale dhe përgjegjësinë artistike të studentit. Studentët theksojnë, se kjo qasje ka ndikuar në mënyrë të qëndrueshme në ndërtimin e identitetit të tyre si aktorë, duke i orientuar drejt një raporti më të thellë me tekstin dramatik, me procesin e punës dhe me rolin e tyre në hapësirën publike artistike. Perspektiva e tyre konfirmon ndikimin afatgjatë të kësaj metode, në formimin profesional dhe në zhvillimin e një qëndrimi kritik ndaj vetvetes dhe artit. Përfundimi nxjerr në pah, se pedagogjia e aktrimit, kur konceptohet si praktikë e vazhdueshme artistike dhe jo vetëm si proces didaktik, përbën një element thelbësor në arsimin e lartë artistik. Rasti i analizuar dëshmon, se ndërthurja e përvojës skenike me reflektimin pedagogjik, krijon një

model formimi të qëndrueshëm dhe transformues. Studimi thekson rëndësinë e dokumentimit akademik të praktikave pedagogjike të bazuara në përvojë dhe rolin e pedagogut – aktor, në transmetimin e dijes artistike ndër breza, duke kontribuar në konsolidimin e një tradite të artikuluar të mësimdhënies së aktrimit, në institucionet e arsimit të lartë.

Fjalë kyçe

Pedagogji artistike, instrument pedagogjik, roli pedagogut, metodë mësimore

Vetëdija artistike e regjisorit në përzgjedhjen e veprës teatrale, analizë reflektive mbi teatrin absurd

Inis Gjoni

gjoni.inis@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull shqyrton rolin dhe rëndësinë e vetëdijes artistike të regjisorit në përzgjedhjen e veprës teatrale, duke e parë këtë proces si akt themelor krijues dhe ideor në ndërtimin e shfaqjes. Në teatrin bashkëkohor, regjisori nuk është vetëm ndërmjetës i tekstit dramatik, por autor i gjuhës skenike dhe i kuptimit që vepra merr në raport me publikun dhe realitetin shoqëror. Përzgjedhja e veprës teatrale reflekton botëkuptimin estetik, etik dhe filozofik të regjisorit, si dhe vetëdijen e tij për funksionin e teatrit në shoqëri. Duke u mbështetur në teori të rëndësishme të regjisurës dhe përmes analizës së veprave konkrete teatrale, ky studim synon të dëshmojë se vetëdija artistike e regjisorit është faktor përcaktues në origjinalitetin, aktualitetin dhe vlerën komunikative të shfaqjes teatrale. Artikulli trajton vetëdijen artistike të regjisorit si faktor vendimtar në përzgjedhjen e veprës teatrale dhe në ndërtimin e procesit regjisorial. Duke u mbështetur si në qasje teorike ashtu edhe në reflektim praktik, studimi argumenton se mungesa e njohjes së thellë dhe e bindjeve të qëndrueshme artistike e bën regjisorin të ndikuar nga konformizmi dhe paragjykimet, duke cenuar individualitetin krijues. Në qendër të analizës vendoset procesi i zgjedhjes së veprës, i shoqëruar nga dyshimi, mospranimi fillestar dhe reflektimi kritik, si parakushte për krijimin e një regjisure autentike. Në pjesën analitike, artikulli ndalet në përvojën regjisoriale me dramën Keqkuptimi të Albert Camus dhe Karriget të Eugène Ionesco-s, duke shqyrtuar raportin midis tekstit absurd dhe mishërimit skenik, si dhe të drejtën e regjisorit për ndërhyrje të kufizuara në tekst për arsye skenike.

Fjalë kyçe

Regjisori, vetëdija artistike, teatër absurd, përzgjedhja e veprës, regjisure

Elementi dramatik në dramaturgjinë e Fishtës

Suela Agolli, Anila Mullahi

sagolli.sa@gmail.com, anilamullahi@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve & Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Abstrakt

Studimi trajton elementin epik dhe mitologjik në dramaturgjinë e Fishtës, duke analizuar mënyrën se si autori ndërthur burime të ndryshme kulturore dhe letrare, si intertekst në ndërtimin e veprave dramatike. Në krijimet e tij dramatike shpesh subjektet dhe personazhet e kanë burimin nga mitologjia antike, si dhe nga tradita folklorike e mitologjike shqiptare. Në melodramat e Fishtës vërehet krijimi i skenave ku bashkohen personazhet njerëzor, qofshin figura historike ose të krijuara me personazhe mitologjik. Tek drama “Të kthymit e Uliksit në Itakë” Fishta e merr subjektin nga antikiteti por kontekstualizimi është në një prerje diakronike shqiptare. Personazhet dramatike shpesh paraqiten me tipare të theksuara heroike dhe me vendosmëri të madhe morale, duke kujtuar figurat epike të traditës shqiptare. Në disa tekste dramatike vërehet një shkrimje e veçantë midis galerisë së personazheve të mitologjisë shqiptare dhe atyre të mitologjisë antike, duke i pranëvënë e duke i rifunksionalizuar në ndërlidhje me njëri tjetrin si për të treguar se kanë të njëjtat vlera për të rrëfyer. Një bashkë prani e tille shfaqet në melodramën “Jerina”, ku elementet e eposit homerik ndërfiten në elementë të eposit shqiptar. Prania e elementëve të eposit herë shfaqet nëpërmjet personazheve, herë nëpërmjet strukturave tipike si ajo e korit që të rikujton specifikat e teatrit antik, dimensionin kolektiv që komenton ngjarjet dhe krijon një lidhje midis veprimit dramatik dhe traditës. Rimarrja e eposeve, është një model dramaturgjik që lidhet me përpjekjen e qartët të autorit për ta mbështetur teatrin shqiptar në modelet e teatrit evropian, i frymëzuar nga Shekspiri dhe Metastasio. Fishta nuk e kopjon drejtpërdrejt eposin, por transformon frymën epike në një formë dramatike, duke krijuar një dramaturgji ku bashkohen tradita epike shqiptare, mitologjia dhe modeli i teatrit klasik. Në përputhje me këtë koncept estetik, Fishta i ndërton melodramat duke përdorur një gjuhë poetike të fuqishme dhe të ngarkuar me emocionalitet. Në këtë mënyrë, dramaturgjia e tij shfaqet si një ndërthurje e elementit epik, mitologjik dhe dramatik, duke kontribuar në formësimin e një modeli të veçantë të teatrit kombëtar shqiptar.

Fjalë kyçe

Dramë, epos, traditë, intertekstualitet, rrëfim

Simetria Kubrick: Aksi vizual dhe subjektiviteti modern në kinemanë e tij.

Anila Varfi

nilavarfi@yahoo.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Analiza mbi konceptin e simetrisë vizuale në filmbërjen e Stanley Kubrick vijon të mbetet interesante në çdo aspekt studimor. Në rrafshin metodologjik ky artikull, kontekstualizon funksionin konceptual të formave dhe të kompozimit aksial në kinemanë Kubrick, duke e shqyrtuar simetrinë jo vetëm si zgjedhje stilistike të regjisorit, por dhe si një strukturë kuptimore me ndërfutje epistemologjike dhe ontologjike. A funksionon simetria vizuale si instrument i cili gjeneron subjektivitet dhe relativizëm narrativ? Për të mbërritur në definicionin e duhur argumentues mbi këtë pyetje që shtron artikulli janë ndërthur teoria e neoformalizmit të David Bordwell me filozofinë e imazhit të Gilles Deleuze (imazh-lëvizje / imazh-kohë), si dhe me konceptin e hapësirës disiplinore të Michel Foucault dhe teorinë e aparatit të Jean-Louis Baudry e Christian Metz. Për ta strukturuar këtë përvijimin analizues merren në shqyrtim filmat: 2001: A Space Odyssey, The Shining dhe Eyes Wide Shut. Artikulli argumenton se simetria nuk përdoret thjesht si një formalizëm estetik i stilit autorial, por strukturohet dhe sillet si një teknikë moderne që e vendos subjektin e qendëruar brenda një arkitekture racionaliteti dhe kontrolli, dhe ku evidentohet qartazi se rendi vizual në filmat e Kubrick-ut materializon tensionin midis iluminizmit dhe krizës së tij ekzistenciale dhe realitetit.

Fjalë kyçe

arkitekturë, relativizëm narrativ, mekanizëm estetik

“Vala e re” e regjisoreve të filmit në Kosovë: transformimi estetik dhe rikonfigurimi rrëfimor

Arian Krasniqi

arian.krasniqi@uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Ky punim shqyrton shfaqjen e asaj që quhet “vala e re” e regjisoreve në Kosovë si një transformim strukturor brenda kinematografisë bashkëkohore kombëtare. Problemi kërkimor lidhet me mungesën e kornizave sistematike akademike për të kuptuar mënyrën se si ky brez riformëson gjuhën filmike, autorësinë dhe përfaqësimin kulturor. Qëllimi i studimit është konceptualizimi i kësaj lëvizjeje si një paradigmë e re kinematografike që ripërcakton njëkohësisht formën estetike dhe kuptimin shoqëror. Objektivat janë: identifikimi i modeleve tematike dominuese, analiza e strategjive rrëfimore dhe vizuale, si dhe shqyrtimi i ripozicionimit të kinemasë kosovare në sferën kulturore globale. Studimi udhëhiqet nga këto pyetje kërkimore: Si e transformojnë këto regjisore modelet rrëfimore dhe përfaqësuese? Si shndërrohen përvojat individuale në metafora shoqërore kolektive? Si riformulohet kinemaja kosovare në diskursin global filmik? Hipoteza qendrore argumenton se kjo lëvizje përbën një formacion estetik dhe ideor koherent, që e zhvendos gruan nga objekt përfaqësimi në subjekt rrëfimor vizual, duke vendosur një epistemologji të re filmike. Metodologjia është cilësore, duke kombinuar analizën filmike, teorinë feministe të filmit dhe studimet kulturore. Popullata përfshin filmat bashkëkohorë kosovarë të realizuar nga regjisore, ndërsa përzgjedhja përbëhet nga vepra të njohura ndërkombëtarisht të prodhuara në periudhën 2020–2022. Instrumentet kërkimore përfshijnë analizën tekstuale, hartëzimin tematik, analizën rrëfimore-strukturore dhe analizën diskursive të pritjes festivalore dhe kritikës. Rezultatet dhe diskutimi tregojnë një lëvizje të qëndrueshme drejt formave filmike të natyrës intime, minimaliste dhe refleksive, të konceptuara dhe zhvilluar mbi tema universale siç janë: identiteti, trauma, rezistenca, liria dhe bota femërore. Ndërsa, përfundimi konstaton se kjo “valë e re” përfaqëson një kthesë paradigmatisht që ripërcakton identitetin kulturor dhe pozicionimin global të kinematografisë kosovare.

Fjalë kyçe

Kinemaja e pasluftës, memoria kulturore, subjektiviteti filmik, autorësia gjinore, minimalizmi narrativ

Nga tabloja në kohëzgjatje: Ndikimi i temporalitetit piktoresk në ritmin filmik

Elvis Lule

elvislule34@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë në mënyrë teorike dhe analitike transformimin e konceptit të kohës nga piktura në kinema, duke argumentuar se plan-sekuenca përfaqëson ekuivalentin funksional të tablosë në mediumin filmik. Ndryshe nga qasjet që fokusohen në citime ikonografike apo ngjashmëri formale ndërmjet imazhit statik dhe atij filmik, ky studim shqyrton ndikimin strukturor të temporalitetit piktoresk në ndërtimin e ritmit filmik nga perspektiva e regjisë. Rëndësia e hulumtimit qëndron në riformulimin e marrëdhënies pikturë–film si transformim i konceptit të kohës, dhe jo si dialog i thjeshtë vizual. Metodologjia ndjek një qasje kualitative, të mbështetur në analizë tekstuale dhe vizuale të planeve të gjata në vepra të përzgjedhura të kinemasë autoriale evropiane dhe aziatike, duke u referuar në teori të estetikës së perceptimit, ontologjisë së imazhit filmik dhe konceptit të “imazhit-kohë”. Analiza përqendrohet në kohëzgjatjen e planit, integritetin hapësinor dhe pezullimin e montazhit si elemente që prodhojnë përvojë kontemplative. Gjetjet tregojnë se plan-sekuenca, kur strukturohet si njësi autonome kuptimore, zhvendos ritmin nga dinamika e fragmentimit drejt intensitetit të kohëzgjatjes, duke krijuar një përvojë perceptivë të ngjashme me soditjen e tablosë. Në këtë kuptim, regjisori vepron si organizues i kohës, duke e trajtuar atë si material estetik. Përfundimisht, studimi konkludon se ndikimi i pikturës në kinema manifestohet jo vetëm në kompozim, por në vetë arkitekturën kohore të rrëfimit. Rekomandohet zgjerimi i analizës në studime empirike mbi perceptimin e audiencës dhe në krahasime ndërmjet kinemasë autoriale dhe asaj komerciale.

Fjalë kyçe

Plan-sekuencë, ontologjia e imazhit, përjetim kontemplativ, estetikë perceptivë, imazh-kohë

Efektete vizuale në kinematografinë shqiptare dhe sfidat e saj përballë inteligjencës artificiale

Eno Milkani

enomilkani@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Efektet vizuale të përdorura në Kinemanë Shqiptare, duke filluar nga Efektet Vizuale të periudhës mekanike, e deri tek Efektet Digjitale të përdorura në Filmin Shqiptar, si dhe sfidat përballë Inteligjencës Artificiale. Në filmin e parë të shkurtër shqiptar, “Fëmijët e saj” (1957), me regji të Hysen Hakanit, përdoret montazhi si efekt vizual. Me kalimin e kinemasë nga periudha mekanike në periudhën elektronike e më pas në atë digjitale, efektet vizuale u bënë një nevojë për përcjelljen më të thellë të emocionit, përshtatjen e dramaturgjisë dhe realizimin e dëshirave artistike të regjisorëve për të sjellë brenda imazhit një figurë të re, një imazh bashkëkohor dhe unik. Sot, ndërhyrja dhe manipulimi i inkuadraturës filmike, falë programeve kompjuterike, mund të bëhen edhe në kushtet e shtëpisë. Megjithatë, sfida më e re me të cilën përballlet kjo kinema është risia dhe rreziku që vjen nga aplikimi i inteligjencës artificiale, si në manipulimin e figurës, ashtu edhe në prodhimin e një dramaturgjie pa bazë reale emocionale, e cila mund të jetë edhe shkak i largimit të audiencës nga salla e kinemasë.

Fjalë kyçe

Efekte vizuale në kinema, efektet mekanike në kinema, rreziku nga Inteligjenca Artificiale, AI vs Humans

Mizanskena si Arkitekturë e Narracionit Filmik në Filmin e Kristaq Dhamos

Zamir Kokonozi

zkokonozi@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Narracioni filmik është konsideruar tradicionalisht si produkt i mizanskenës dhe montazhit. Kinemaja e Kristaq Dhamo-s dëshmon se struktura e tregimit mund të ndërtohet në mënyrë mjaft shprehëse përmes zotërimit të këtyre përbërësve në tregimin e historisë brenda kuadrit. Ky punim shqyrton mizanskenën si arkitekturë narrative në filmat “Vitet e para” (1965) dhe “Botë e padukshme” (1987) të regjisorit Kristaq Dhamo, duke argumentuar se elementët kryesorë të mizanskenës, si vendosja dhe lëvizja e personazheve, kompozimi në thellësi dhe ekonomia e prerjeve, përbëjnë mekanizmat themelore të prodhimit të kuptimit. Duke u mbështetur në teorinë e narracionit klasik dhe në traditën e realizmit filmik, studimi analizon mënyrën se si konceptet e vendosjes në hapësirën para kamerës dhe orientimi i personazheve, raporti plani i parë-sfond dhe vendosja e kamerës krijojnë një gjeometri dramatike që orienton perceptimin e spektatorit dhe garanton koherencën e rrëfimit. Në këtë kontekst, mizanskena i përgjigjet kërkesave dramatike të narracionit dhe funksionon si një sistem sintaksor që organizon marrëdhëniet midis personazheve dhe tregon historinë. Përmes një qasjeje analitiko-formaliste, punimi demonstroi se në filmat e Kristaq Dhamos, duke u bazuar në dy skena nga filmat e lartpërmëndur, narracioni zhvillohet brenda kuadrit përmes transformimeve të brendshme hapësinore, duke minimizuar fragmentimin nëpërmjet montazhit dhe duke ruajtur unitetin dramatik. Kam qëllimin të argumentoj se mizanskena funksionon si strukturë themelore e tregimit filmik dhe filmat e regjisorit Dhamo përfaqësojnë një nga kontributet më të rëndësishme të këtij modeli, në kinemanë shqiptare.

Fjalë kyçe

Mizanskenë, unitet, strukturë, filmik, narracion

Roli i Producentit dhe Drejtuesit Artistik në Projekte Artistike në Hapësirat Publike: Ndërmjetësimi mes vizionit artistik, angazhimit të komunitetit dhe edukimit informal

Iris Canaj

c.iris925@gmail.com

Universiteti i Arteve/ Universiteti “Polis”, Shqipëri

Abstrakt

Kuptimi i hapësirave publike dhe roli i producentit kreativ dhe drejtuesit artistik. Ku takohen dhe ndahen detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e producentit dhe drejtuesit artistik? A merren me vizionin dhe kreativitetin apo duhet të jenë edhe udhëheqës të ekipit artistik, teknik, reklamues e dokumentues të aktivitetit? Si ndërtohen urat e bashkëpunimit mes disa aktorëve që kontribuojnë për të prodhuar një aktivitet në hapësirë urbane, që i ndikon publikut të gjerë? Krijojmë për të fituar apo krijojmë për t’u plotësuar shpirtërisht dhe për të ndikuar në komunitet? Shpesh biem pre e të krijuarit për hir të argëtimit dhe e masim ndikimin artistik me indikatorë statistikorë në frekuentueshmëri, por a e cënon kjo gjë indikatorin cilësor, afatmesëm e afatgjatë? Produksionet kreative në hapësira publike, jo vetëm që argëtojnë publikun, por edhe e edukojnë, emancipojnë apo tentojnë të ndryshojnë mentalitetin duke e provokuar, përmirësojnë jetesën edhe nga ana estetike duke gjallëruar qytetin, por edhe nga ana funksionale, ndikojnë në kujtesën kolektive, japin mesazhe, e të tjerë. Në produksione të tilla, spektatori përfshihet aktivisht dhe meson socializohet duke u bërë pjesë integrale e aktivitetit dhe jo thjesht si “duartrokitës pasiv”. Angazhimi i komunitetit, gjithëpërfshirja si shpërndarje gjeografike, si përfshirje komunitetesh apo grupmoshash të ndryshme, është një përgjegjësi sociale e ekipit krijues. “Arti i rrugës”, njihet ndryshe edhe si “zëri i qytetit”, por a mbeten artistët rebelë mjaftueshëm kur arti drejtohet artistikisht apo udhëhiqet nga producentët, të cilët kujdesen për financime/sponsorizime apo fonde nga institucione, subjekte apo sipërmarrje të ndryshme, që e bëjnë aktivitetin artistik të mundur?!

Fjalë kyçe

Producent, hapësirë publike, gjithëpërfshirje, edukim informal

Fëmijët si roje të ideologjisë: loja dhe vigjilenca në Kinemanë Shqiptare për Fëmijë, të Realizmit Socialist.

Suela Bako

suelabako@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Trashëgimia filmike e ish-Kinostudios “Shqipëria e Re” reflekton ndërthurjen e estetikës, ideologjisë dhe kujtesës kolektive në Shqipërinë post-socialiste, veçanërisht përmes filmit për fëmijë. Gjatë realizmit socialist, filmi nuk ishte thjesht një praktikë artistike, por një instrument i prodhimit të subjektivizmit, duke modeluar moralin dhe sjelljen e brezit të ri në përputhje me ideologjinë e Partisë. Analizat teorike të Michel Foucault mbi disiplinën dhe vigjilencën, si dhe reflektimet e Giorgio Agamben mbi fëmijërinë dhe lojën, lejojnë kuptimin e filmit për fëmijë si një hapësirë ku estetika, pushteti dhe edukimi ideologjik ndërthuren në mënyrë strukturore. Përmes shembujve filmikë si “Pas gjurmëve” (Xhanfise Keko, 1978, “Lugina e pushkatarëve” (Todi Bozo, Vitori Cela, 1970), “Një gjeneral kapet rob” (Spartak Pecani 1978), evidentohen mekanizmat e vigjilencës revolucionare të përcjella tek fëmijët, ku loja dhe xhesti, transformohen në mjete përvetësimi të normave ideologjike. Këto filma ilustrjnë se, edhe në një kornizë artistike të pasur, ideologjia mbetet prezente dhe shërben si forcë edukative dhe politike. Në kontekstin e trashëgimisë filmike, studimi tregon nevojën për kontekstualizim kritik të këtyre veprave, duke kombinuar ruajtjen e vlerës estetike me ndërgjegjësimin mbi dimensionin propagandistik. Në përfundim, studimi i kësaj trashëgimie duhet të shoqërohet me zhvillimin e një mendësie kritike ndaj kinemasë për fëmijë të realizmit socialist, duke reflektuar mbi lidhjen midis estetikës dhe ideologjisë. Rekomandohet që studimet akademike të thellohen në kurrikulat e Regjisë së Filmit, Multimedias, Publicistikës dhe Letërsisë, duke mundësuar analizën e kontekstit historik, dhe kritik të Realizmit Socialist, në trajtimin e marrëdhënieve midis pushtetit, edukimit dhe estetikës në filmin për fëmijë.

Fjalë kyçe

Trashëgimia artistike, njeriu i ri, edukim, gjuhë filmike, subjektivizimi

Kinemaja hibride: Një analizë e efekteve psikologjike dhe perceptive tek shikuesi

Valmir Tertini, Taulanda Jupi

valmirtertini@gmail.com, taulandajupi@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon efektet psikologjike dhe perceptive të rrëfimeve hibride që ndërthurin dokumentarin, fiksionin dhe format eksperimentale në kinemanë bashkëkohore. Analiza mbështetet në dy raste studimore përfaqësuese, F for Fake dhe The Act of Killing, të cilët konsiderohen paradigma të kinemasë hibride për shkak të ndërthurjes së dokumentimit faktik me elemente performative dhe ndërhyrje eseistike që problematizojnë kufirin midis realitetit dhe konstruktionit filmik. Përhapja në rritje e këtyre formave pasqyron një zhvendosje drejt strukturave jo-lineare dhe subjektive, duke ngritur pyetje mbi mënyrën se si publiku percepton të vërtetën dhe emocionin. Qëllimi i studimit është të analizojë se si shkrirja e kufijve midis reales dhe fantazisë ndikon në perceptimin e shikuesit. Duke u mbështetur në konceptin e Timothy Corrigan për “formën eseistike”, hulumtimi analizon se si filmi hibrid e shndërron pikëpamjen personale në një përvojë publike, ku kuptimi bashkë-ndërtohet me audiencën. Gjithashtu, përmes kornizës së “ëndrrës sociale” të Robert Rieber dhe Robert Kelly, studimi vlerëson se si këto imazhe prekin të pavetëdijshmen dhe ankthet kolektive. Metodologjia cilësore kombinon analizën teorike me shqyrtimin e strategjive narrative si paqartësia dhe fragmentimi. Gjetjet sugjerojnë se kinemaja hibride e rrit zhytjen psikologjike duke destabilizuar realizmin konvencional dhe duke nxitur një proces “punimi pa e ditur” rezultatin, gjë që rrit ndërgjegjësimin emocional dhe kritik. Punimi nxjerr në konkluzion se këto forma shërbejnë si mjet i fuqishëm edukativ për t’u drejtuar në kompleksitetin e realitetit mediatik, duke kërkuar një spektatorialitet reflektiv.

Fjalë kyçe

Kinemaja hibride, forma eseistike, perceptimi visual, angazhimi emocional, njohuria dialogjike

Ne jetojmë brenda një ëndrre: Vënia në skenë e veprës *L'Enfant et les sortilèges* të Ravel-it përmes optikës së David Lynch-it

Mirco Michelin

m.michelon@abaperugia.org

Akademia e Arteve të Bukura “P. Vannucci”, Peruxhia, Itali

Abstrakt

Ky punim prezanton një projekt kërkimor të bazuar në praktikë, të zhvilluar në kuadër të iniciativës PNR “Performing Ravel” në Konservatorin “G. Briccialdi” të Ternit, i përqendruar në vënie në skenë të fantazisë lirike të Maurice Ravel-it, *L'enfant et les sortilèges* (Fëmija dhe magjistritë, 1925). Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë se si mësimdhënia e simulante e regjisë skenike, dizajnit të ndriçimit dhe historisë së teatrit muzikor — e pasuruar nga një perspektivë kinematografike — mundëson një model pedagogjik të integruar, në të cilin kufijtë disiplinorë shkrihen në një proces unik krijues dhe analitik. Gjuha kinematografike dhe onirike e David Lynch-it shërben si kornizë estetike lidhëse që mban bashkë këto disiplina. Metodologjia ndërthur kërkimin e bazuar në praktikë me pedagogjinë ndërdisiplinore: studentët u angazhuan si protagonistë aktivë të produksionit, duke përjetuar drejtpërdrejt se si zgjedhjet regjisoriale, dramaturgjia e dritave dhe ndërjegjësimi historik nuk janë hapa sekuencialë, por forca reciprokisht gjeneruese. Konceptet lynch-iane — logjika e ëndrrës, Shiriti i Möbius-it si model i kohës jolineare, e mbinatyrshmja (the uncanny) dhe pyetja ontologjike “kush është ëndërrimtari?” — u prezantuan si mjete analitike që mprehin njëkohësisht aftësitë interpretuese dhe teknike në të gjitha disiplinat. Gjetjet sugjerojnë se kjo qasje konvergjente thëllon ndjeshëm angazhimin e studentëve me partiturën dhe me zanatin e njëri-tjetrit, duke nxitur një ndjeshmëri ndërdisiplinore që arrihet rrallë kur lëndët mësohen në izolim. Dizajni i ndriçimit doli si një gjuhë plotësisht dramaturgjike, duke artikuluar ambiguitetin kohor dhe thellësinë psikologjike që ndajnë si opera e Ravel-it, ashtu edhe universi i Lynch-it. Punimi konkludon se një kornizë bashkëkohore kinematografike, kur përzgjidhet për pasurinë e saj strukturore dhe jo thjesht për tërheqjen stilistike, funksionon si një instrument i mirëfilltë pedagogjik.

Fjalë kyçe

L'Enfant et les sortilèges, estetika Lynch-iane, pedagogji e integruar e arteve, regji e teatrit muzikor, dramaturgjia e ndriçimit

Ndikimi i zhvillimit teknologjik në skenografinë teatrore në Shqipëri

Beqo Nanaj

alexnanaj@hotmail.com

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë ndikimin e zhvillimit teknologjik në skenografinë teatrore në Shqipëri. Një qasje e cila ka evoluar në kalimin drejt praktikave digjitale dhe elementëve modern. Studimi ndjek një qasje hulumtuese, interpretative dhe historike duke bërë një krahasim me periudhat e mëparshme dhe duke përdorur rishikim literature, analizë dokumentesh publike dhe studime rasti. Materiale e përdorura në skenografi, ndriçimi i kontrolluar digjital, sistemet audio-vizuale, projektioni video/projection-mapping dhe automatizimi i mekanizmave skenikë kanë zgjeruar rolin e skenografisë nga “dekor” statik në “mjedis performativ” dinamik e ndërdisiplinor. Të gjitha elementët dhe ndryshimet teknologjike e bëjnë skenografinë një element thelbësor të pjesës teatrale dhe duke revolucionizuar mënyrën sesi është shfrytëzuar hapësira deri tani. Në këtë punim argumentojmë se skenografia bashkëkohore ka fuqinë të krijojë një udhëtim unik narrativ në hapësirë dhe kohë me ndihmën e teknologjisë, ku imazhet lëvizëse, hapësirat digjitale dhe mjediset me media të përziara mund të përdoren për të krijuar iluzione dhe përjetime të reja në publik. Në ditët e sotme skenografia po kalon një revolucion digjital, ku integrimi i teknologjisë së përparuar u lejon skenografëve të krijojnë hapësira reaguese që përziejnë elementë fizikë, digjitalë dhe virtual duke zgjeruar mundësitë narrative. Të gjithë elementët tregojnë se infrastruktura e re rrit mundësitë estetike në realizimin e veprës por nxjerr në pah edhe kufizime strukturore si: mungesë specialistësh, buxhet i limituar, mirëmbajtje të kushtueshme dhe hendek mes edukimit artistik dhe kompetencave teknike. Përmes këtij studimi synohet të analizohet ndikimi i teknologjisë në estetikën, funksionalitetin dhe procesin krijues të skenografisë shqiptare.

Fjalë kyçe

Teatër, hapësirat digjitale, ndriçim, projektion, revolucion digjital

Përdorimi dhe mungesa e rrotativit skenik: analizë krahasuese e zgjidhjeve skenografike në teatrin ‘Petro Marko’ të Vlorës dhe në teatro të tjera Shqiptare

Drini Shehu

drini_shehu@hotmail.com,

Teatri “Petro Marko”, Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Rrotativi skenik, që prej krijimit të tij, përfaqëson një nga mekanizmat më të rëndësishëm teknikë në krijimtarinë dhe zhvillimin e skenografisë moderne, duke mundësuar transformime të shpejta të hapësirës skenike dhe të dekorit, si dhe duke ndikuar në konceptin regjisorial dhe ritmin dramaturgjik të shfaqjes. Në kontekstin shqiptar, vitet e fundit, përdorimi i tij ka qenë shpesh jashtë vëmendjes dhe i kushtëzuar nga faktorë infrastrukturorë, ekonomikë dhe teknikë. Ky artikull trajton përdorimin dhe mungesën e rrotativit, duke u mbështetur në analiza krahasuese të skenografive të shfaqjeve të ndryshme, në shqyrtimin e materialeve arkivore dhe në vëzhgimin e praktikave skenografike të realizuara në mungesë të tij. Në mënyrë të veçantë, artikulli fokusohet te zgjidhjet alternative për ndërrimin dhe transformimin e hapësirës skenike, si përdorimi i dekorit të lëvizshëm, elementeve modulare dhe zgjidhjeve manuale, përmes krahasimit të disa skenografive të realizuara në Teatrin “Petro Marko” Vlorë dhe në teatrot kryesore të vendit. Qëllimi i këtij hulumtimi nuk është vetëm nxjerrja e përfundimeve mbi epërsinë e një zgjidhjeje ndaj një tjetre, por edhe evidentimi i ndikimit që ka mungesa ose prania e rrotativit në konceptimin skenografik, në dinamikën e shfaqjes dhe në marrëdhënien midis hapësirës, aktorit dhe publikut. Artikulli synon të kontribuojë në diskutimin shkencor mbi zhvillimin teknik dhe estetik të skenografisë shqiptare, duke ofruar një bazë për studime të mëtejshme dhe reflektim mbi nevojën për rikthimin e rrotativit dhe modernizimin e infrastrukturës skenike në teatrot e vendit.

Fjalë kyçe

Infrastrukturë skenike, koncept skenografik, hapësirë skenike, elementë skenikë, skenografi

Pse humbi rrotativa?

Ened Kuka

enkuka@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti i këtij studimi është të analizojë në mënyrë thelbësore origjinën, funksionin dhe zhdukjen graduale të rrotativës si mekanizëm skenik, duke nisur nga paraqitja e saj e parë në teatrin tradicional japonez Kabuki në shekullin XVII, i cili përbënte një nga inovacionet më të hershme të lëvizjes hapësinore në skenë. Studimi shqyrton nevojat teknike dhe dramaturgjike që çuan në krijimin e rrotativës në teatrin europian të shekujve XVIII - XIX, ku kërkesa për tranzicione të shpejta, ritëm narrativ të pandërprerë dhe një skenografi më dinamike e shndërruan atë në element qendror të prodhimeve teatrale. Përdorimi i rrotativës krijoi për herë të parë një logjikë vizuale të ngjashme me montazhin filmik, duke ndikuar në konceptimin e mëvonshëm të hapësirës lëvizëse në skenë dhe në lindjen e mendësisë kinematografike. Metodologjia e studimit përfshin një analizë historike dhe krahasuese të burimeve teatrale. Studimi kombinon perspektiva inxhinierike, estetike dhe kulturore për të shpjeguar mënyrën se si ndryshimet teknologjike, estetika postdramatike dhe strukturat e reja të prodhimit teatral transformuan rolin e rrotativës. Pyetja shkencore që udhëheq kërkimin është: *Cilët faktorë teknikë, estetikë dhe kulturorë çuan në humbjen e funksionit të rrotativës në skenografinë bashkëkohore, pavarësisht rëndësisë së saj historike?* Rezultatet e pritura synojnë të sqarojnë se rrotativa nuk u zhduk për shkak të mungesës së vlerës, por sepse u tejkalua nga teknologjitë digjitale, nga mënyra të ndryshme të ndërtimit të hapësirës dhe nga ndryshimet e thella në strukturën e shfaqjes bashkëkohore. Studimi analizon edhe situatën në Shqipëri, ku rrotativat u instaluan vonë dhe u hoqën për arsye teknike, ekonomike dhe estetike, duke pasqyruar zhvillimet e përgjithshme të skenës teatrale.

Fjalë kyçe

Mekanika skenike, transformim hapësinor, dramaturgji vizuale, teknologji teatrale, skenografi bashkëkohore

Nga mekanika antike te skena inteligjente: transformimi teknologjik i skenografisë teatrale

Gazmend Koçollari

gkocollari@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Skenografia është një element i rëndësishëm i artit skenik, e cila shërben për të ndërtuar atmosferën dramatike dhe ndërmjetësimin në marrëdhënien me spektatorin. Nga vetë botëkuptimi i saj si një domosdoshmëri e veprave skenike ajo krijon atë që quhet psikologji e atmosferës, e cila përveç një lidhje organike me pjesën teatrale krijon tek spektatori një përfytyrim i cili e shpie atë drejt një fokusimi më të fortë drejt pjesës teatrale, falë efekteve dhe formave vizuale që krijojnë gjendje të ndryshme gjithmonë në përshtatje me botëkuptimin e shfaqjes. Mjetet që përdoren dhe format e ndryshme të ekzekutimeve që nga pikturimi i telajove deri te dritat, përdorimi i teknologjive për krijimin e efekteve të cilat janë surprizuese dhe shkaktojnë tërheqje të forta emocionale, e bëjnë këtë art një domosdoshmëri për një mbarëvajtje dhe realizim të fuqishëm të mesazhit të veprës. Evolucionin teknologjik ka qënë faktor i rëndësishëm në transformimin e skenës teatrale, duke kaluar nga struktura mekanike në sisteme dinamike, elektronike e digjitale. Ky studim synon të analizojë transformimin e skenës teatrale në histori, duke gjurmuar zhvillimet teknologjike të kohës, ndikimin e tyre në estetikën skenike nga antikiteti deri në ditët e sotme. Pra roli i skenografisë nga element dekorativ në sistem ndërveprues i rëndësishëm ka ndryshuar dukshëm me evolucionin teknologjik. Për realizimin e këtij studimi është përdorur një qasje cilësore me karakter historiko-analitik, duke analizuar evolucionin teknologjik në kontekstin historik, kulturor dhe artistik përgjatë historisë së zhvillimit të teatrit.

Fjalë kyçe

Evolucion teknologjik, skenografi, teatër

Gjama: ritual i kënduar dhe i kërcyer

Elona Beqiraj

elonabeqiraj15@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ofron një analizë gjithëpërfshirëse etnokoreografike dhe historike të Gjamës, një ritual funeral unik në traditën shqiptare, i kufizuar gjeografikisht në krahinat veriore të Shqipërisë dhe Malësisë së Gjakovës. Ndryshe nga vajtimet femërore, të cilat janë kryesisht vokale dhe improvizative, Gjama përfaqëson një rit kolektiv mashkullor, të kodifikuar rreptësisht, që ndërthur britmën ritmike, lëvizjen trupore të sinkronizuar dhe goditjen e gjoksit në formë kanoni. Ajo i kushtohet ekskluzivisht burrave me virtyte të larta, duke shërbyer jo thjesht si shprehje dhimbjeje, por si ceremoni nderimi dhe investiturë post-mortem. Studimi mbështetet në burime parësore dhe dytësore, përfshirë veprën themeltare të Johan Georg Hahn, *Albaneische Studien* (1854), studimet koreografike të Skënder Selimit (2003) dhe Ramazan Bogdanit (1980), dëshmitë gojore nga trevat veriore, si dhe analizën krahasuese me vallet mortore labe. Nëpërmjet një qasjeje interdisiplinare, analizohen origjina e ritualit (me rrënjë në vajtimin e Skënderbeut më 1468 dhe në besimet pagane ilire), variantet gjeografike, struktura kanonike e lëvizjes, si dhe transformimi semiotik që pësoi Gjama gjatë periudhës komuniste, kur u përpoq të shndërrohej nga britmë dhimbjeje në brohoritje heroike. Punimi argumenton se Gjama përfaqëson një nga format më të larta të artit primitiv evropian, dëshmon rezistencën e jashtëzakonshme të substratit pagan shqiptar dhe ofron një rast studimi unik për antropologjinë e regjimeve totalitare. Sot, Gjama e vërtetë është zhdukur pothuajse plotësisht, duke lënë vendin formave të folklorizuara dhe skenizuara. Studimi thekson domosdoshmërinë e dokumentimit shkencor dhe rikontekstualizimit artistik të kësaj trashëgimie kulturore të rrezikuar.

Fjalë kyçe

Etnokoreografi, trashëgimi kulturore, valle mortore, komunizëm

Krijimtaria popullore Shqiptare në ritualet e jetës si bartëse e kujtesës kolektive

Elona Nallbani

elonanallbani@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim fokusohet në krijimtarinë koreografike popullore shqiptare si një dukuri komplekse, duke e trajtuar atë jo thjesht si spektakël estetik, por si një mekanizëm thelbësor të kujtesës kolektive dhe identitetit kulturor. Duke u mbështetur në një qasje ndërdisiplinore, që ndërthur perspektivat etnologjike, antropologjike dhe etnokoreografike, artikulli synon të argumentojë se vallja shqiptare është pjesë përbërëse e riteve të kalimit nga lindja tek jeta e përditshme, duke shërbyer si një mjet për përjetimin kolektiv dhe transmetimin e vlerave komunitare. Kërkimi folklorik dhe etnografik shqiptar ka kaluar nëpër etapa të ndryshme, nga grumbullimi romantik i materialit në shekullin XIX deri te institucionalizimi dhe ideologjizimi i tij gjatë periudhës së pasluftës. Megjithatë, pavarësisht konteksteve politike, një gjë ka mbetur konstante: vlera e trashëgimisë jomateriale si shenjë e qartë identiteti. Folklori koreografik, në veçanti, përbën një nga shtresat më të lashta dhe më rezistente të kësaj trashëgimie. Ndryshe nga objektet materiale që konsumohen ose shkatërrohen, vallet, lojërat dhe ceremonitë transmetohen trup më trup, brez pas brezi, duke ruajtur kode të lashta të komunikimit njerëzor. Ky argument ilustruhet përmes analizës së shembujve konkretë, si “Vallja e Kabashit” dhe vallet burrërore të Lumës, ku rituali e shndërron lëvizjen e përditshme në akt simbolik, duke forcuar kohezionin social dhe identitar. Përfundimisht, punimi thekson se koreografia popullore shqiptare është një proces i gjallë dhe dinamik, i cili ruan, ripërpunon dhe përcjell kujtesën historike dhe identitetin kulturor brez pas brezi, duke dëshmuar se trupi është një instrument i fuqishëm i kujtesës.

Fjalë kyçe

Krijimtari popullore, rituale jetësore, valle shqiptare, kujtesë kolektive, simbolikë

Etika e autorësisë në edukimin koreografik në epokën e Inteligjencës Artificiale

Ersilja Çeli

ersilja_celi@hotmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Integrimi gjithnjë e më i gjerë i inteligjencës artificiale në praktikat artistike ka nxitur diskutime të ndërlikuara etike dhe pedagogjike në lidhje me autorësinë, origjinalitetin dhe përgjegjësinë. Në arsimin koreografik, këto çështje marrin një peshë të veçantë, pasi krijimi i kërcimit mbështetet në eksplorimin e trupëzuar dhe në ushtrimin e vetëdijshëm të veprimit krijues nga ana e autorit. Ky punim shqyrton mënyrën se si mjetet gjenerative të bazuara në inteligjencë artificiale ndikojnë në konceptin e autorësisë në programet universitare të koreografisë. Në kundërshtim me qasjen që e sheh inteligjencën artificiale si zëvendësim të krijimtarisë njerëzore, argumentohet se ajo, në fakt, e riformulon autorësinë duke krijuar një strukturë të ndërmjetësuar, ku qëllimshmëria njerëzore mbetet përcaktuese, por realizohet përmes proceseve të ndërmjetësuar teknologjike. Duke u mbështetur në kërkime ndërdisiplinore në etikën e inteligjencës artificiale, studimet mbi krijimtarinë, studimet e performancës dhe integritetin akademik, punimi propozon një kornizë normative vlerësimi të organizuar rreth tre parimeve të ndërlidhura: transformimi i trupëzuar, raporti proporcional i ndikimit krijues dhe deklarimi transparent i përdorimit të teknologjisë. Këto parime vendosen në kontekstin e kuadrit rregullator evropian bashkëkohor, përfshirë European Union AI Act, si dhe shqyrtohen shkurtimisht në raport me legjislacionin shqiptar, ku autorësia i atribuohet ekskluzivisht personave fizikë. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se integrimi etik i inteligjencës artificiale në arsimin koreografik duhet të mbështetet mbi qartësi konceptuale dhe kritere të mirëpërcaktuara, jo mbi ndalime kategorike. Në këtë mënyrë, programet e koreografisë mund të përfitojnë nga inovacioni teknologjik duke ruajtur integritetin artistik, përmes një ripërkufizimi të origjinalitetit si angazhim transformues dhe i trupëzuar i autorit, dhe jo si origjinim absolut i shkëputur nga çdo ndërmjetësim.

Fjalë kyçe

Autorësi, etikë akademike, sisteme gjenerative

Vallëzimi bashkëkohor i inspiruar nga folklori Shqiptar

Uesli Alushi, Gëzim Sërtollaj

uesli.alushi@gmail.com, sertollaj.gs@gmail.com

OJQ Pri Dance, Kosovë, SHKA Agimi, Kosovë

Abstrakt

Ky punim shqyrton marrëdhënien estetike dhe strukturore ndërmjet vallëzimit bashkëkohor dhe folklorit shqiptar, duke analizuar mënyrën se si elementët simbolikë, ritualistikë dhe ritmikë të vallëzimit folklorik mund të shërbejnë si burim frymëzimi për krijimtarinë kontemporane. Studimi mbështetet në një qasje teorike dhe krahasimore, duke iu referuar filozofëve të estetikës si Platoni, Aristoteli, Kant, Nietzsche dhe Croce, si dhe zhvillimeve historike të dancit modern dhe bashkëkohor. Përmes analizës së gjuhës lëvizore, ritmeve asimetrike dhe karakterit krahinor të valleve shqiptare, argumentohet se folklori përbën një bazë të fuqishme për ndërtimin e një estetike bashkëkohore me identitet kombëtar. Rezultatet e analizës tregojnë se ndërthurja e impulsit intuitiv folklorik me strukturimin racional skenik mund të prodhojë vepra autentike, për sa kohë ruhet karakteri dhe simbolika e lëvizjes burimore. Në përfundim, punimi rekomandon një qasje kërkimore dhe akademike ndaj folklorit, duke e konsideruar atë jo si material për modernizim të drejtpërdrejtë, por si themel për zhvillimin e një gjuhe bashkëkohore autoktone.

Fjalë kyçe

Proces, krijimtari, estetikë, identitet, ritme asimetrike

Ndërtimi i identitetit kombëtar përmes edukimit muzikor: analizë krahasuese e kurrikulave shkollorë në Kosovë dhe Shqipëri

Besa Luzha

besa.luzha@uni-pr.edu

ORCID: 0000-0003-1635-8376

Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Arteve, Departamenti i Muzikës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Edukimi muzikor luan një rol të rëndësishëm në formësimin e ndërgjegjësimit kulturor dhe transmetimin e vlerave kolektive brenda sistemeve arsimore kombëtare. Përtej funksioneve të saj artistike dhe pedagogjike, kurrikulat e muzikës shkollorë shpesh kontribuojnë në ndërtimin dhe përf forcimin e identitetit kombëtar përmes përzgjedhjes së repertorit, narrativave historike dhe përfaqësimeve të trashëgimisë kulturore. Duke u bazuar në perspektivat teorike nga studimet e nacionalizmit, si dhe teoria kritike e kurrikulës – veçanërisht koncepti i Benedict Anderson për “komunitetet e imagjinuara” dhe kuptimi i Michael Apple për kurrikulën si një proces i përzgjedhjes kulturore dhe ideologjike – ky studim shqyrton se si edukimi muzikor merr pjesë në ndërtimin e narrativave kulturore kombëtare në Kosovë dhe Shqipëri. Përveç kësaj, perspektivat nga bursa e edukimit muzikor, veçanërisht puna e Lucy Green mbi kontekstet sociale dhe kulturore të të mësuarit të muzikës, ofrojnë një kornizë për të kuptuar se si përmbajtja muzikore dhe praktikat pedagogjike ndikojnë në perceptimet dhe identitetet kulturore të studentëve. Hulumtimi miraton një metodologji krahasuese cilësore bazuar në analizën e dokumenteve zyrtare të kurrikulës, teksteve muzikore dhe materialeve të zgjedhura mësimore të përdorura në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë dhe Shqipëri. Analiza fokusohet në përfaqësimin e traditave popullore, përfshirjen e kompozitorëve kombëtarë, praninë e repertorit patriotik dhe mënyrat se si trashëgimia muzikore është kornizuar brenda diskursit arsimor. Theksi i fortë në trashëgiminë muzikore kombëtare në të dy kontekstet pasqyron rëndësinë historike të ruajtjes kulturore dhe formimit të identitetit, veçanërisht në shoqëritë e formuara nga tranzicioni politik dhe proceset e ndërtimit të kombit. Megjithatë, në një epokë të karakterizuar nga globalizimi dhe rritja e ndër lidhjes kulturore, ky studim gjithashtu shqyrton nëse kurrikula të tilla të orientuara në nivel kombëtar angazhohen mjaftueshëm me perspektiva më të gjera ndërkulturore në edukimin muzikor. Prandaj, punimi kontribuon në diskutimet e vazhdueshme se si edukimi muzikor mund të balancojë transmetimin e trashëgimisë kulturore kombëtare me zhvillimin e mirëkuptimit ndërkulturor në kontekstet arsimore bashkëkohore.

Fjalë kyçe

Edukimi muzikor, identiteti kombëtar, studimet kurrikulare, trashëgimia kulturore, Kosovë, Shqipëri

Merita artistike dhe merita shkencore në fitimin e titujve profesor: analizë krahasuese arsimit të lartë në Europë dhe Shqipëri

Majlinda Hala, Inis Gjoni

majlindahala@gmail.com, gjoni.inis@gmail.com

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim shqyrton kriteret dhe procedurat për promovimin e titujve akademikë në arsimin e lartë artistik përmes një analize krahasuese midis Shqipërisë dhe disa sistemeve evropiane. Ndërkohë që kornizat evropiane po njohin gjithnjë e më shumë kërkimin artistik dhe produktet artistike të bazuara në praktikë, sistemi shqiptar mbetet më i varur nga metrika tradicionale dhe sasiore akademike. Promovimi akademik drejt titullit “Profesor” në universitetet e arteve përfaqëson një fushë komplekse ndërmjet krijimtarisë artistike dhe matjes shkencore të standardizuar. Ndaj ky punim merr përsipër të analizojë në mënyrë krahasuese modelet evropiane të promovimit akademik artistik të titujve në Itali, Francë, Gjermani dhe Austri, duke i vendosur ato në raport me sistemin shqiptar të rregulluar nga Ligji nr. 80/2015 dhe VKM-ve përkatëse (VKM Nr.112, dt. 23.02.2018, VKM Nr. 128, dt 6.03.2024). Punimi kërkon të shqyrtojë tri pyetje kërkimore: Si përcaktohen kriteret e promovimit akademik në rastin e UART në Shqipëri? Në çfarë mase përputhen ato me praktikën evropiane për fitimin dhe drejtimin e institucioneve të arsimit të lartë në arte? Cilat janë sfidat në vlerësimin e krijimtarisë artistike? Metodologjia e përdorur në këtë studim është analizë cilësore dhe krahasuese, duke marrë në shqyrtim akte ligjore, VKM dhe literaturë ndërkombëtare. Përmes kësaj analize, punimi shqyrton mënyrën se si konceptohet merita akademike, raporti midis kërkimit shkencor dhe krijimtarisë artistike, si dhe nivelin e autonomisë universitare në vendimmarrjen për promovimin e titujve në fushën e arteve. Për shterimin e këtyre pyetjeve punimi mbështetet në tre qasje teorike: së pari, teoria e potencialit akademik e Pierre Bourdieu, qasje e cila e koncepton karrierën akademike si akumulim të kapitalit shkencor dhe simbolik, së dyti, koncepti i “academic capitalism”, që e sheh universitetin si institucion të orientuar drejt performancës dhe konkurrencës, së treti, koncepti i “artistic research”, i cili e njeh krijimtarinë artistike si formë të prodhimit të dijes. Gjetjet tregojnë se sistemet evropiane ndahen në disa modele: model autonom-cilësor (Austria dhe pjesërisht Gjermania), model i standardizuar shkencor (Italia dhe Franca), model procedural-numerik (Shqipëria). Edhe pse sistemet evropiane zhvillojnë qasjen e tyre për universitetet e arteve drejt integritit “artistic research” si formë e barabartë e dijes, sistemi shqiptar mbetet i orientuar drejt indikatorëve numerikë dhe standardizimit normativ. Punimi del në përfundime se aktet ligjore dhe nënligjore duhen të jenë shteruese dhe mos krijojnë një “vakum funksional epistemologjik” për vlerësimin e krijimtarisë artistike dhe meritës artistike duke zbatuar në mënyrën e duhur aktet ligjore në Universitetin e Arteve.

Fjalë kyçe

Merita artistike, matja shkencore, promovimi i titullit profesor, arsimit të lartë, kërkimi shkencor në art

Nga arkivi drejt një infrastrukture kërkimore: integrimi i arkivit audiovizual të RTSH-së në Universitetin e Arteve (Tiranë)

Andi Kongo

kongoandi@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim trajton aksesin e kufizuar kërkimor në arkivin audiovizual të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), i cili përbën burimin kryesor për dokumentimin e muzikës shqiptare gjatë shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI. Megjithëse ky arkiv përmban një pasuri të konsiderueshme regjistrimesh audio dhe audiovizuale, mungesa e një infrastrukture kërkimore të strukturuar dhe e mekanizmave sistematikë të aksesit kufizon përdorimin e tij në studimet muzikologjike dhe artistike. Kjo mospërputhje midis ekzistencës së arkivit dhe aksesueshmërisë së tij përbën një pengesë thelbësore për zhvillimin e muzikologjisë shqiptare. Duke u mbështetur në literaturën mbi teorinë e arkivit, etnomuzikologjinë dhe ruajtjen e trashëgimisë audiovizuale, punimi thekson rolin e regjistrimit si burim parësor për analizën muzikore, rol që në kontekstin shqiptar mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së aksesit të strukturuar. Në këtë kuadër, propozohet një model bashkëpunimi institucional midis RTSH-së dhe Universitetit të Arteve (UART), me synim integrimin e arkivit në një infrastrukturë kërkimore funksionale. Ky proces do të mundësonte krijimin e një sistemi të kontrolluar aksesimi, digjitalizimin dhe katalogimin sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe përdorimin e materialeve për kërkim shkencor pa cenuar të drejtat e autorit. Në përfundim, arkivi audiovizual trajtohet si një komponent kyç i sovranitetit kulturor dhe theksohet nevoja për politika kombëtare që lidhin ruajtjen e trashëgimisë me prodhimin e dijes shkencore.

Fjalë kyçe

Radio Televizioni Shqiptar, muzika Shqiptare, muzikologji, infrastrukturë kërkimore, ruajtje digjitale

Nga arkiva fizike te kujtesa digjitale: një qasje e qëndrueshme për arkivimin e trashëgimisë artistike në universitetet publike

Erjon Sulaj

erjon.sulaj@uart.edu.al

ORCID 0000-0002-2441-7391

Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Transformimi i arkivave fizike në struktura të organizuara të kujtesës digjitale përbën një sfidë thelbësore për institucionet akademike në epokën e teknologjisë. Universitetet me profil artistik përballen me kompleksitet të shtuar, pasi prodhimi i tyre përfshin forma të larmishme dokumentimi – nga punimet akademike te partiturat, regjistrimet audio dhe dokumentacioni vizual. Ky punim trajton arkivimin digjital si një akt institucional me peshë kulturore dhe etike, që kërkon standardizim, qeverisje të brendshme dhe garantim afatgjatë të qëndrueshmërisë së infrastrukturës së kujtesës. Duke u mbështetur në një rast studimor afatgjatë (2011–2026), punimi analizon modelin e zbatuar në Bibliotekën e Universitetit të Arteve në Tiranë, i ndërtuar mbi arkitekturë open-source (Koha ILS dhe DSpace), institucionalizim të brendshëm dhe bashkëpunim ndërdisiplinor. Metodologjia përfshin analizë dokumentare, vëzhgim institucional dhe reflektim praktik mbi proceset e implementimit, mirëmbajtjes dhe konsolidimit të sistemit. Rezultatet tregojnë se ndërtimi i një depozite institucionale digjitale në një kontekst me burime të kufizuara është i realizueshëm përmes standardizimit të metadata-ve, ndarjes së qartë të përgjegjësisë dhe integritetit të arkivës në proceset akademike të përditshme. Modeli i propozuar evidenton faktorët strukturorë që ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë të infrastrukturave të kujtesës digjitale, duke e pozicionuar arkivimin jo vetëm si zgjidhje teknike, por si komponent strategjik të autonomisë akademike dhe të ruajtjes së trashëgimisë kulturore në kontekstin e universiteteve publike.

Fjalë kyçe

Kujtesë digjitale, depozitë institucionale digjitale, qeverisje e arkivave, qëndrueshmëri infrastrukturale, open-source

Mësimdhënia përmes performancës artistike: Gratë dhe formimi i shkollës të interpretimit në arsimin muzikor Shqiptar

Eliona Liçi

Eliona.lici@univlori.edu.al

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim synon të paraqesë kontributin e rëndësishëm të grave artiste (muzikante) interprete si dhe rolin themelor që ato patën në pedagogjinë muzikore shqiptare për zhvillimin e arsimit muzikor dhe jetës artistike në Shqipëri gjatë periudhës 1940–1995. Periudhë kjo e karakterizuar nga ndërtimi i institucioneve të para profesioniste muzikore dhe nga transformime të thella sociopolitike. Megjithëse gratë muzikante luajtën një rol vendimtar në emancipimin e shoqërisë shqiptare si interprete, këngëtare, pianiste, kompozitore dhe pedagoge të specialiteteve në formimin e artistëve të rinj, kontributi i tyre është cekur herë pas here për rezultatet e shënuara që ka dhënë shkolla shqiptare e interpretimit, por ndikimi i tyre nuk është studiuar thellësisht në historiografinë muzikore shqiptare. Duke u mbështetur në një metodologji cilësore, historiko-analitike, ky hulumtim bazohet në burime arkivore nga Arkivi Qendror i Shtetit, programe arsimore, arkiva personale të artistëve, literaturë të botuar dhe intervista gjysmë të strukturuar me muzikantë dhe pedagogë. Studimi analizon ndërveprimin midis praktikave pedagogjike, zhvillimit institucional dhe kushteve më të gjera politike e kulturore, duke theksuar mënyrën se si gratë artiste kanë ndikuar në hartimin e kurrikulave, në formësimin e traditës së interpretimit dhe në përgatitjen profesionale të brezave të rinj të muzikantëve. Vëmendje e veçantë i kushtohet brezit të parë të grave shqiptare të arsimuara në konservatorët kryesorë evropiane, rolit të tyre në themelimin e shkollave vokale dhe instrumentale dhe në prezantimin e praktikave të interpretimit kolektiv duke ndërthurrur lidhjen e aktivitetit artistik me arsimin formal muzikor. Pavarësisht se vepruan në kontekste ideologjike kufizuese dhe në kushte të gjata izolimi kulturor, gratë pedagoge kontribuan në konsolidimin e pedagogjisë muzikore kombëtare dhe në krijimin e një trashëgimie të qëndrueshme artistike dhe arsimore. Duke e vendosur këtë veprimtari në kuadrin e muzikologjisë feministe dhe pedagogjisë muzikore, ky studim ofron një perspektivë të re mbi historinë e muzikës shqiptare dhe mbi transmetimin kulturor të modeleve interpretuese dhe pedagogjike. Gjetjet synojnë të pasurojnë historiografinë e arsimit muzikor në Shqipëri, të nxisin qasje të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore në kërkimin muzikologjik dhe të mbështesin reflektimin bashkëkohor pedagogjik mbi marrëdhënien midis praktikës artistike, arsimit dhe identitetit kulturor.

Fjalë kyçe

Pedagogjia muzikore, kontributi i grave në pedagogjinë muzikore, edukimit artistik Shqiptar

Ndikimi i pedagogjisë vokale tek këngëtarët sipas zhanreve të ndryshme muzikore

Enida Bogdani, Belioza Coku

enibogdani88@gmail.com

Producer TRIAD/Project Manager & New York University of Tirana, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky kërkim analizon efektivitetin e shfaqjeve të filmave në komunitet, të ndjekura nga diskutime të moderuara (“talkbacks”), si burime psikosociale të aksesueshme për adoleshentët me probleme të shëndetit mendor. Punimi tregon se dëshmitë globale sugjerojnë se përafërsisht një në shtatë adoleshentë vuan nga një çrregullim i shëndetit mendor, e megjithatë shpesh ndeshet me stigmë, bullizëm dhe heshtje shoqërore lidhur me problemet e tyre. Si rrjedhojë, shumë të rinj mbeten të distancuar nga shërbimet klinike formale dhe në vend të tyre varen nga mjediset e përditshme të komunitetit për mbështetje dhe gjetjen e kuptimit. Punimi parashtron se ngjarjet e bazuara në art, të organizuara me përpikmëri, mund të lehtësojnë angazhimin komunitar përmes dialogjeve qytetare të kontrolluara mbi tema të ndjeshme si depresioni, ankthi, turpi dhe bullizmi. Kërkimi përdor një dizajn integruar teorik bazuar në literaturë (desk design), duke sintetizuar studime mbi shëndetin mendor të adoleshentëve dhe faktorët mbrojtës, identitetin narrativ dhe tregimin e historive (storytelling), artet pjesëmarrëse dhe demokracinë kulturore, si dhe lehtësimin dialogjik dhe të informuar mbi traumën në artet komunitare. Punimi përcakton katër mekanizma të ndërlidhur përmes të cilëve diskutimet e bazuara në film mund të përmirësojnë mirëqenien e adoleshentëve në mjedise joklinike:

- Shikimi kolektiv si një përvojë emocionale komunitare,
- Tregimi si një mjet distance e sigurt që lehtëson projeksionin dhe pakëson mbrojtjen,
- Diskutimet e moderuara si “mikro-publike” që rishpërndajnë zërin dhe kultivojnë empatinë,
- Dhe përvojat e përkatësisë dhe vetëshprehjes si rezultate mbrojtëse.

Diskutimi trajton gjithashtu rreziqet etike, si ri-traumatizimi, moderimi i pamjaftueshëm dhe angazhimi simbolik (tokenism). Ai thekson rëndësinë e lehtësimit të informuar mbi traumën, angazhimin vullnetar dhe mekanizmat e qartë të referimit kur një individ përjeton shqetësim. Studimi përfundon duke diskutuar rolet e shkollave, qendrave rinore, institucioneve kulturore dhe politikave kulturore bashkiake, ndërsa identifikon gjithashtu fushat kryesore për kërkime të ardhshme mbi dialogun qytetar të bazuar në art dhe shëndetin mendor të adoleshentëve.

Fjalë kyçe

Shëndeti mendor i të rinjve, artet komunitare, shfaqjet e filmave, talkbacks (diskutimet e moderuara), përkatësia

**``Krijimtaria, trashëgimia & edukimi artistik në kohën e teknologjisë``
interpretimi muzikor si proces kërkimor në epokën e teknologjisë.
Qasje analitike dhe reflektive mbi performancën bashkëkohore**

Niki Mjeda, Arben Basha

nikimjeda@yahoo.com, arbenbasha0@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Interpretimi muzikor në kontekstin bashkëkohor nuk mund të konsiderohet më vetëm si akt ekzekutimi artistik, por si një proces kompleks kërkimor që përfshin analizë, reflektim dhe ndërveprim me mjedisin teknologjik. Ky punim trajton performancën si praktikë studimore, në të cilën interpretuesi ndërton kuptimin artistik përmes analizës së partitures, kontekstit historik dhe estetikës së veprës, duke integruar njëkohsisht mjetet digjitale që ndikojnë në procesin krijues dhe prezantimin skenik. Në epokën e teknologjisë, regjistrimet audio-vizuale, programet e analizës muzikore dhe platformat digjitale kanë transformuar mënyrën se si artisti përgatit, vlerëson dhe komunikon performancën. Studimi mësohet në qasje muzikologjike dhe teorike, duke analizuar marrëdhënien ndërmjet interpretuesit, veprës dhe teknologjisë. Rezultatet theksojnë se interpretimi përfaqëson një hapësirë dinamike kërkimore ku ndërthuren tradita, inovacioni dhe reflektimi kritik. Ky studim kontribuon në rivlersimin e rolit të interpretuesit si kërkues dhe krijues, duke e vendosur performancën në një dimension të ri teorik dhe praktik në diskursin bashkëkohor muzikor.

Fjalë kyçe

Kulturë muzikore, kërkim artistik, estetikë

Integrimi i teknologjisë në mësimin e muzikës

Nevjana Stringa

stringanevjana@gmail.com

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit ‘‘Aleksandër Xhuvani’’, Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Abstrakt

Ky punim analizon rolin e Teknologjisë së Edukimit Muzikor (TEM) në përmirësimin e mësimdhënies së muzikës, duke u fokusuar në përdorimin e platformave dhe aplikacioneve SoundCloud, Solfeg.io dhe Flat for Education, si edhe në përdorimin e stacioneve dixhitale të punës audio në mjediset mësimore. Studimi trajton mënyrën se si këto mjete ndihmojnë në zhvillimin e teorisë muzikore, performancës, kompozimit, dëgjimit aktiv dhe krijimit muzikor, duke mbështetur njëkohësisht mësimin e diferencuar dhe vlerësimin në kohë reale. Integrimi i teknologjisë në edukimin muzikor përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. Përdorimi i platformave dixhitale, aplikacioneve interaktive, stacioneve të punës audio (DAW) dhe mjeteve online ka krijuar mundësi të reja për zhvillimin e aftësive muzikore, rritjen e motivimit dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin krijues dhe performues. Në kushtet e transformimeve të shpejta teknologjike, edukimi muzikor nuk kufizohet më vetëm në metodat tradicionale, por ndërtohet mbi një qasje të kombinuar ku teknologjia shërben si mjet pedagogjik, krijues dhe bashkëpunues. Në punim paraqiten edhe përvoja të zbatimit të këtyre metodave me studentët gjatë procesit mësimor. Përdorimi i SoundCloud-it ka ndihmuar studentët të ndajnë regjistrimet e tyre muzikore dhe të fitojnë më shumë siguri në interpretim. Solfeg.io është përdorur për zhvillimin e aftësive ritmike dhe intonative, duke rritur angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive në orë. Ndërsa Flat for Education dhe DAW-të kanë ndihmuar studentët në kuptimin praktik të teorisë muzikore dhe në zhvillimin e aftësive krijuese përmes realizimit të ushtrimeve kompozicionale dhe projekteve audio. Rezultatet e vëzhguara tregojnë rritje të motivimit, përmirësim të bashkëpunimit dhe një përvetësim më të shpejtë të koncepteve teorike dhe praktike. Në përfundim, studimi argumenton se integrimi i qëndrueshëm i teknologjisë në edukimin muzikor krijon një mjedis mësimor më dinamik, ndërveprues dhe të përshtatur me nevojat e studentëve të shekullit XXI. Gjithashtu, theksohet rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve dhe e përfshirjes sistematike të mjeteve teknologjike në programet e edukimit muzikor.

Fjalë kyçe

edukim muzikor, teknologji, mësimdhënie, aplikacione muzikore, mësim interaktiv

Terminologjia artistike në shqip ndërmjet huazimit dhe shqipërimit krahasime ndërgjuhësore

Manjola Tërshana

manjolatershana@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim analizon strukturën dhe prejardhjen e terminologjisë në fushën e muzikës, arteve pamore dhe arteve skenike në gjuhën shqipe, duke u përqendruar në raportin midis termave të huazuar dhe ekuivalentëve shqip, si edhe në asimetrinë terminologjike në krahasim me gjermanishten, frëngjishten dhe italishten. Studimi trajton mënyrën se si një komunitet i vogël gjuhësor negocion ndërmjet autoritetit terminologjik ndërkombëtar dhe zhvillimit leksikor vendas. Terminologjia artistike përbën një komponent thelbësor të diskursit akademik dhe pedagogjik. Analiza e saj ndihmon në kuptimin e proceseve të standardizimit gjuhësor, ndërkombëtarizimit leksikor dhe politikave të ndërgjegjshme të planifikimit terminologjik. Në kontekstin shqiptar, këto procese lidhen ngushtë me historinë e formimit kulturor dhe me ndikimet e vazhdueshme evropiane. Studimi mbështetet në analizë leksikologjike dhe krahasimore ndërgjuhësore. Është ndërtuar një korpus përfaqësues termash nga tri fushat artistike, i nxjerrë nga tekste universitare, fjalorë normativë dhe literaturë profesionale. Termet janë klasifikuar sipas prejardhjes etimologjike (italisht, frëngjisht, greqisht, latinisht, anglisht) dhe statusit në shqip (huazim i konsoliduar, formë e shqipëruar, ekuivalent përshkrues). Gjermanishtja shërben si model krahasimi për shkak të traditës së saj në përkthimin konceptual. Rezultatet tregojnë se terminologjia artistike shqipe mbështetet kryesisht në huazime, veçanërisht nga italishtja (sidomos në muzikë) dhe frëngjishtja (në artet skenike). Ekuivalentët shqip ekzistojnë, por shpesh mbeten në nivel përshkrues ose didaktik, pa u standardizuar plotësisht. Në kontrast, gjermanishtja shfaq prirje sistematike për krijimin e termave burimor përmes përbërjes dhe përkthimit semantik. Asimetria terminologjike nuk dëshmon varfëri leksikore, por modele të ndryshme zhvillimi gjuhësor. Rekomandohet nxitja dhe mbështetja institucionale e krijimit të ekuivalentëve shqip, kur kjo është e mundur, pa cënuar stabilitetin ndërkombëtar të termave teknikë, si edhe hartimi i glosarëve të standardizuar për përdorim akademik.

Fjalë kyçe

Terminologji artistike, huazime, shqipërim, asimetri ndërgjuhësore, standardizim leksikor

Integrimi i arteve dhe mësimit të gjuhës angleze: një ekzaminim empirik i ndikimit metodologjik

Tidita Abdurrahmani
abdurrahmanitidita@yahoo.com
Universiteti European i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim shqyrton ndikimin e integritit të arteve në mësimdhënien e gjuhës angleze brenda kuadrit të Anglishtes për Artet-English for Arts (EFA), me fokus të veçantë në përmirësimin e kompetencave gjuhësore dhe krijuese të nxënësve në arsimin e mesëm. I bazuar në një perspektivë pedagogjike ndërdisiplinore, kërkimi mbështetet në një sërë qasjesh, përfshirë të nxënësve të bazuar në përmbajtjet e integruara gjuhësore-Content and Language Integrated Learning (CLIL), të nxënësve të bazuar në projekte, mësimdhënien përmes dramës dhe përdorimin e teknologjisë në mësim. Këto qasje kombinohen për të krijuar një mjedis të gjallë dhe ndërveprues, ku zhvillimi i gjuhës lidhet ngushtë me shprehjen artistike dhe të nxënësve përmes përvojës. Studimi përdor një dizajn kërkimor me metoda të përziera, duke integruar të dhëna sasiore—si vlerësimet para dhe pas ndërhyrjes për përvetësimin e fjalorit dhe rrjedhshmërinë në të folur—me të dhëna cilësore të marra nga vëzhgimet në klasë, reflektimet e nxënësve dhe feedback-u i mësuesve. Kjo metodologji e plotë mundëson një vlerësim të thelluar si të rezultateve njohëse, ashtu edhe të dimensioneve afektive të të nxënësve, përfshirë motivimin, angazhimin, vetëbesimin dhe kreativitetin e nxënësve. Gjetjet tregojnë se integrimi i arteve në mësimdhënie çon në përmirësime të matshme në zotërimin e gjuhës, veçanërisht në përdorimin e fjalorit, shqiptimin dhe ndërveprimin në të folur. Nxënësve shfaqin rrjedhshmëri më të lartë dhe aftësi më të mirë për të komunikuar idetë në mënyrë efektive brenda kontekstit. Gjithashtu, përfshirja e elementeve artistike rrit ndjeshëm angazhimin e nxënësve, nxit të nxënësve bashkëpunues dhe inkurajonpërballjen me pengesat në mënyrë krijuese. Nxënësve bëhen pjesëmarrës më aktivë në klasë, duke shfaqur më shumë vetëbesim dhe një lidhje më të thellë me procesin e të nxënësve. Për më tepër, studimi thekson rolin e arteve në mbështetjen e mësimdhënies gjithëpërfshirëse dhe të diferencuar, pasi aktivitetet artistike ofrojnë mundësi të shumta për përfshirjen e nxënësve me stile dhe nivele të ndryshme të të nxënësve. Në tërësi, gjetjet nënvizojnë efektivitetin e EFA si një model pedagogjik që jo vetëm forcon aftësitë gjuhësore, por edhe zhvillon kreativitetin dhe mendimin kritik. Studimi sjellzbatime të rëndësishme në hartimin e kurrikulave, duke rekomanduar integrimin e qasjeve ndërdisiplinore dhe të përqendruara të nxënësve në mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin e mesëm.

Fjalë kyçe

CLIL, arte, mësimdhënia e anglishtes në arsimin e mesëm

Regjia televizive shqiptare në epokën digjitale: Nga praktika institucionale te transformimi estetik

Gentian Bezatlliu

gentbezatlliu@gmail.com

RTSH, Radio Televizioni Shqiptar, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Transformimi digjital ka ndikuar ndjeshëm në mënyrën se si prodhohet, strukturohet dhe perceptohet programi televiziv, duke e vendosur regjisorin përballë sfidave të reja krijuese dhe institucionale. Ky punim analizon evolucionin e regjisë televizive shqiptare në kontekstin e teknologjive digjitale, duke u fokusuar në marrëdhënien ndërmjet praktikës institucionale dhe transformimit estetik të gjuhës televizive. Duke marrë si pikë reference përvojën e prodhimit televiziv në institucionin publik, studimi shqyrton se si digjitalizimi i proceseve teknike, automatizimi i montazhit, ritmi i përshpejtuar i transmetimit dhe përdorimi i platformave multimediale kanë ndikuar në vendimmarrjen regjisoriale. Në këtë kuadër, trajtohet tensioni midis efikasitetit teknologjik dhe ruajtjes së autorësisë artistike, si dhe ndikimi i këtyre zhvillimeve në estetikën vizuale dhe narrativen televizive. Metodologjia e punimit mbështetet në analizën cilësore të praktikës profesionale, krahasimin e modeleve të regjisë para dhe pas digjitalizimit, si dhe rishikimin e literaturës bashkëkohore mbi regjimin post-medial dhe televizionin në epokën digjitale. Punimi argumenton se teknologjia nuk është thjesht një mjet neutral, por një faktor që rikonfiguron rolin e regjisorit, hierarkitë krijuese dhe identitetin estetik të produktit televiziv. Në përfundim, studimi synon të kontribuojë në debatin mbi regjinë televizive si praktikë krijuese dhe kërkimore, duke propozuar nevojën për një qasje kritike dhe të vetëdijshme ndaj teknologjisë, në mënyrë që transformimi digjital të shërbejë si mjet pasurimi artistik dhe jo si kufizim i shprehjes krijuese.

Fjalë kyçe

Regji televizive, digjitalizim, estetikë televizive, praktikë institucionale, autorësi artistike

Teatri si laborator i qytetarisë roli i lëndës “TEATËR” në zhvillimin kognitiv, qytetar dhe demokratik në kurrikulën e arsimit parauniversitar (Shqipëri) krahasuar me rajonin dhe Greqinë

Redjan Mulla

redjanmulla@gmail.com

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull ngre dy teza kryesore: së pari, se teatri ka një ndikim të thellë në formimin individual, dhe së dyti, se qytetaria kolektive vjen drejtpërdrejt nga ekspozimi ndaj praktikave artistike në sistemin arsimor parauniversitar. Studimi shqyrton rolin e lëndës Teatër në arsimin parauniversitar si një mjet transformues për zhvillimin kognitiv, qytetar dhe demokratik të nxënësve, me fokus kryesor Shqipërinë, krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Serbi) dhe Greqinë si vend anëtar i Bashkimit Evropian. Studimi përbëhet nga një analizë e politikave kurrikulare të secilit vend dhe një dataset model që simulon ndikimin e pjesëmarrjes në teatër në tri dimensione kryesore: vetëbesim, empati dhe kompetencë qytetare. Në shumë raste politikat ndaj artit dhe teatrit në veçanti mbeten periferike në vendimmarrjen arsimore. Në Shqipëri, shpesh teatri është konsideruar si aktivitet dekorativ, ose ekstra-kurrikular, ndonëse praktikatat pedagogjike dhe studimet e huaja tregojnë qartë se ai luan një rol vendimtar në zhvillimin e vetëbesimit, empatisë dhe kompetencave qytetare. Metodologjia e përdorur, kombinon analizë dokumentare krahasimore me një model statistikor, bazuar në një shkallë Likert (1–5) për vlerësimin e ndikimit të teatrit në zhvillimin personal dhe shoqëror të nxënësve. Gjithashtu ajo bazohet në vëzhgim pjesëmarrës dhe analizë reflektive, për të evidentuar ndikimin e drejtpërdrejtë të lëndës teatër në zhvillimin e mendimit kritik, empatisë dhe përgjegjësisë kolektive. Rezultatet tregojnë se vendet me integrim më të fortë të teatrit në kurrikulë, korrespondojnë me vlera më të larta mesatare në indikatorë të zhvillimit qytetar, ndërsa Shqipëria paraqet një hendek strukturor me prezencë të kufizuar teatrore. Problematika shqiptare është paradoksale: një kulturë e pasur artistike nuk përkthehet në mbështetje institucionale të artit në shkolla. Kjo ka pasojë të dukshme në zhvillimin e qytetarisë kolektive tek nxënësit. Diskutimi lidh këto gjetje me teoritë e edukimit demokratik dhe pedagogjisë së artit, duke argumentuar se teatri funksionon si laborator i qytetarisë, i cili përgatit nxënësit për përfshirje aktive demokratike. Studimi përfundon me rekomandime konkrete për politikëbërësit arsimorë për të rritur ndikimin e artit dhe teatrit në sistemin parauniversitar.

Fjalë kyçe

Teatri, edukim kulturor, qytetari kolektive, Shqipëri, krahasim rajonal, politikë arsimore

Qyteti si personazh
Narrativa urbane dhe edukimi estetik në letërsinë bashkëkohore për fëmijë
Analiza bazohet në librin “Në Zemër të Qytetit të Vjetër”

Sabrina Kuçi, Lavdije Pateriku

sabrinakuci@yahoo.com, lavdije.dauti@hotmail.com

Drejtorja Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, Shqipëri, Kopshti “Njomëzat”, “Pashko Vasa dhe “Ndoc Mazi”, Shkodër, Shqipëri

Abstrakt

Në kontekstin e transformimeve digjitale dhe sfidave që paraqet edukimi kulturor i brezave të rinj, letërsia në tërësinë e saj, e në mënyrë më specifike letërsia për fëmijë, shpesh mbetet në hije, ndonëse përfaqëson një mjet të fuqishëm për transmetimin e trashëgimisë kulturore. Ky punim analizon librin “Në Zemër të Qytetit të Vjetër”, me target fëmijët e moshës 5–10 vjeç, si një model edukimi që ndërthur narrativën artistike me njohjen e monumenteve historike të qytetit të Shkodrës. Përmes figurës së hartës magjike dhe eksplorimit të objekteve me vlerë si Kalaja e Rozafës, Ura e Mesit dhe banesat historike etj, libri krijon një përvojë mësimore që kombinon emocionin, imagjinatën dhe ndërtimin e identitetit kulturor të fëmijët. Qasja narrative synon ta bëjë trashëgiminë kulturore të prekshme dhe të kuptueshme për moshat e hershme, duke e zhvendosur procesin e të nxënit nga modeli informativ drejt një përvoje interaktive dhe emocionale. Studimi shqyrton rolin e librit në ndërtimin e ndërgjegjes kulturore të fëmijët dhe e propozon atë si një model të riprodhueshëm për edukimin mbi trashëgiminë në kohën e teknologjisë. Metodologjia e përdorur bazohet në pyetësorë dhe takime në terren gjatë promovimit të librit në shkolla të ndryshme të qytetit të Shkodrës, duke analizuar perceptimet dhe reagimet e fëmijëve ndaj përmbajtjes së tij.

Fjalë kyçe

Shkodër, trashëgimi kulturore, libër për fëmijë, identitet kulturor

Lahuta e Malcís së Gjergj Fishtës-vepër epokale në panteonin e letërsisë shqipe, si pjesë e thesarit kulturor dhe historik kombëtar

Rovena Mikeli Vata

rovena_vata@hotmail.com

Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë shpirtërore të një kombi. “Lahuta e Malcís” paraqet një vepër monumentale në historinë e letërsisë shqipe, në të cilën janë gërshetuar mbledhja, kultivimi, analizimi, studimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë shpirtërore shqiptare, të realizuara nga figura poliedrike e Gjergj Fishtës. Objekti i këtij punimi është studimi i veprës së Gjergj Fishtës, për rëndësinë e kujtesës historike që ajo ka, për porositë, që Gjergj Fishta shkroi të kryevepra e tij letrare: “Lahuta e Malcís”. Metodologjia: Ky punim vjen si qasje midis metodës historike dhe analizës së tekstit letrar. Nga rileximi i “Lahuta e Malcís”, vëmë re se autori nuk dinte t’i binte Lahutës si vegël muzikore, as nuk dinte të këndonte si një rapsod i maleve, por ai njihnte në thellësi psikologjinë dhe mendësinë e banorëve të Malësisë së Veriut. Këngët e përshkruara në “Lahuta e Malcís” pasqyrojnë ngjarjet e kohës nën prizmin e traditave, zakoneve dhe mentalitetit të trevave veriore shqiptare, nga një analizë gjithëpërfshirëse, mund të dalin rekomandime të cekura si më poshtë. Vepra “Lahuta e Malcís” padyshim paraqet një vepër monumentale të letërsisë shqipe që ndërlidhet pashmangshëm me kujtesën historike dhe trashëgiminë shpirtërore të popullit shqiptar. Ndonëse kjo vepër është trajtuar nga gjuhëtarë, letrarë, gjurmues të folklorit, juristë, etj., do të ishte e udhës që kjo vepër të promovohet si aset i trashëgimisë shpirtërore muzeale shqiptare, dhe sipas mundësisë ajo të transkribohet në gjuhën moderne shqipe në mënyrë të tillë që, të jetë sa më e arritshme për të gjithë brezat si dhe për ata studiues vendas apo të huaj, që dëshirojnë ta studiojnë trashëgiminë shpirtërore dhe kulturore shqiptare.

Fjalë kyçe

Lahutë, malsi, rapsod, tradita, këngë

Zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë përmes këngës në praktikat muzikore shumëgjuhëshe të klasave multikulturore të fëmijërisë së hershme

Maria Argyriou, Eliona Liçi

m.argyriou@aegean.gr, Eliona.lici@univloro.edu.al

University of The Aegean, Greqi, Universiteti i Vlorës Ismail Qemali, Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim paraqet një studim empirik që synon të analizojë rolin e përvojave muzikore shumëgjuhëshe, multikulturalitetin në zhvillimin e kujtesës kulturore dhe ndjenjën e përkatësisë në grupmoshat e fëmijëve të arsimit parashkollor. Hulumtimi është realizuar në tre institucione parashkollore në Athinë (Greqi) me një kampion fëmijësh të karakterizuar nga diversiteti kulturor (N = 72; mosha 4–6 vjeç). Kërkimi u mbështet në një strukturë metodologjike me metoda të përziera duke integruar vëzhgimin në klasë, intervistat me edukatorët dhe analizën e përgjigjeve të fëmijëve gjatë aktiviteteve muzikore ndërkulturore. Punimi mbështetet teorikisht në konceptet e kujtesës kulturore, të nxënit përmes përvojës fizike lëvizjes, përjetimit të drejtpërdrejtë dhe të pedagogjisë ndërgjuhësore. Në punim hulumtohen funksioni i këngëve nga tradita të ndryshme gjuhësore veçanërisht ninullat greke dhe shqiptare, si dhe këngët festive si bartëse të kujtesës kolektive, të përjetimeve emocionale dhe të ndërtimit të identitetit të përbashkët kulturor. Analiza cilësore e ndërveprimeve dhe e shprehjeve verbale të fëmijëve evidenton se praktikat muzikore shumëgjuhëshe kontribuojnë në zhvillimin e jehonës emocionale, të empatisë dhe të një ndjenje të fortë përkatësie, e cila tejkalon kufijtë gjuhësorë. Edukatorët theksojnë se muzika funksionon si një “urë komunikimi”, që lehtëson pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse duke promovuar mirëkuptimin ndërkulturor. Gjetjet e studimit sugjerojnë se një qasje pedagogjike shumëgjuhëshe e bazuar në muzikë përbën një mekanizëm efektiv për integrimin e kujtesës kulturore në kontekstet e edukimit të hershëm. Nëpërmjet përfshirjes së fëmijëve në aktivitete si këndimi, lëvizja dhe tregimi i historive në gjuhë të ndryshme, mundësohet kultivimi i formave të mishëruara të dijes kulturore dhe i një ndjeshmërie ndaj qytetarisë që në fazat e para të zhvillimit. Në këtë kuadër, studimi thekson domosdoshmërinë e hartimit të kurrikulave të edukimit parashkollor që trajtojnë diversitetin gjuhësor si një burim krijues dhe etik, duke përforcuar idenë se përkatësia është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik që krijohet përmes ndërveprimit ndërkulturor.

Fjalë kyçe

Multilingualismi, memoria kulturore, edukimi i hershëm, pedagogji muzikore, interkulturaliteti

Roli i artit pamor në zhvillimin e koncepteve matematikore tek fëmijët parashkollorë: një qasje ndërdisiplinore në edukimin e hershëm

Magbule Xhemaili

magbule.xhemaili@gmail.com

Gjimnazi “Xhavit Ahmeti”, Gjilan, Kosovë

Abstrakt

Integrimi i artit pamor në arsimin parashkollor përfaqëson një qasje bashkëkohore pedagogjike që synon të pasurojë procesin e të nxënit përmes ndërthurjes së përvojave estetike me zhvillimin e koncepteve njohëse. Në fazën e hershme të zhvillimit, fëmijët mësojnë kryesisht përmes përvojës konkrete, lojës dhe eksplorimit vizual, çka e bën artin pamor një mjet të fuqishëm për ndërtimin e bazave të të menduarit matematikor. Ky studim shqyrton rolin e artit pamor në përvetësimin e koncepteve bazë matematikore tek fëmijët e moshës 3–5 vjeç në institucionet parashkollore të qytetit të Gjilanit. Hulumtimi është realizuar duke përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, e cila përfshin analizën e punimeve artistike të fëmijëve, observime në mjediset e klasës, si dhe intervista dhe anketa me edukatorë dhe prindër. Përmes aktiviteteve si vizatimi, modelimi me plastelinë dhe ndërtimi i formave gjeometrike, fëmijët janë nxitur të eksplorojnë koncepte matematikore si numërimi, krahasimi i madhësive, renditja, simetria dhe identifikimi i formave. Rezultatet tregojnë se integrimi i artit pamor në aktivitetet matematikore rrit motivimin dhe përfshirjen aktive të fëmijëve në procesin e të nxënit. Është vërejtur gjithashtu përmirësim në kuptimin konceptual dhe në aftësinë për të lidhur përvojën konkrete me simbolizimin matematikor. Studimi përfundon se arti pamor përbën një instrument efektiv didaktik dhe rekomandon përfshirjen sistematike të qasjeve ndërdisiplinore në kurrikulat e arsimit parashkollor.

Fjalë kyçe

Art pamor, matematikë, arsimit parashkollor, zhvillim kognitiv, integrim ndërdisiplinor

Kitara si mjet edukimi dhe transmetimi i trashëgimisë muzikore në epokën e teknologjisë

Flavio Lito

flaviolito15@gmail.com

Uakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ndryshimet teknologjike të ndodhura gjatë dekadave të fundit janë pasqyruar në krijimin e programeve për edukimin muzikor. Në këtë kuptim, kërkimi synon të hetojë potencialin e kitarës si instrument që promovon edukimin muzikor. Ky studim përdor metodën teoriko-analitike dhe shqyrton literaturën bashkëkohore shkencore që lidhet me problematikat e pedagogjisë instrumentale, teknologjisë në arsim dhe trashëgimisë kulturore jomateriale. Qëllimi i këtij kërkimi është ndërtimi i një modeli teorik që përfshin komponentët e pedagogjisë instrumentale, teknologjisë dhe kulturës së repertorit tradicional. Nga ky këndvështrim, kitarra konsiderohet jo vetëm si instrument muzikor interpretues, por edhe si medium ndërmjetësues midis perceptimit estetik dhe ndërtimit të identitetit kulturor. Nëpërmjet teknologjive, përfshirë regjistrimet audio dhe video, arkivimin digjital dhe shpërndarjen në internet, krijohen mundësi të reja për kërkimin, promovimin dhe ruajtjen e repertorit tradicional. Sipas rezultateve të studimit, futja e kitarës në një mjedis teknologjik kontribuon në zhvillimin e praktikave interaktive pedagogjike, rrit nivelin e motivimit të studentëve dhe lehtëson procesin e ruajtjes aktive të trashëgimisë muzikore. Në të njëjtën kohë, ky qasje i përgjigjet sfidave të arsimit modern, pasi lidh aspektet praktike dhe kulturore me kompetencat digjitale të nxënësve. Së fundi, kërkimi propozon një model që mund të përdoret në sistemin arsimor shqiptar dhe në vende të tjera.

Fjalë kyçe

Edukim muzikor, pedagogji instrumentale, kitarra, trashëgimi kulturore jomateriale, teknologji digjitale në mësimdhënie, identitet kulturor, inovacion pedagogjik

Muzika e dhomës e Thoma Simakut nga vitet (1991 e këtej) (trajtesë analitike)

Ajet Çekici

a_cekici@hotmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ka për objekt të tij, hulumtimin e procesit krijues të Muzikës së Dhomës të kompozitorit Thoma Simaku pas viteve 1991 e këtej, i cili pa mëdyshje zë një vend të rëndësishëm në opusin krijues të tij, si për nga vëllimi, ashtu edhe për nga niveli artistik. Pas një depërtimi të jashtëzakonshëm në botën muzikore perëndimore në fillim të viteve '90, atij iu dha mundësia në përfshirjen e zhvillimeve dhe proceseve të reja të teknikave bashkëkohore kompozicionale, të cilat bëhen të pranishme që në veprën e tij të parë të asaj kohe, Kuarteti për harqe Nr. 1 (1991). Sikundër edhe një radhë veprash që e pasuan, kuarteti dallohet qartësisht për qasjen e re, duke iu larguar konvencioneve tradicionale të mendimit dhe të kompozimit muzikor, pas së cilës pason etapa më e rëndësishme dhe vendimtare e krijimtarisë së tij, kur ai gradualisht transformon gjuhën e shprehjes së tij muzikore. Ky qëndrim i ri shfaqet në konceptimin formal, ashtu dhe në atë të dramaturgjisë së veprës, po aq edhe në shfrytëzimin e mundësive për zgjerimin sa më shumë të spektrit koloristik, të tingëllimeve të instrumentave për të cilët është shkruar vepra. Në ndjekje të procesit sipas metodologjisë analitike, trajtohen veprat më përfaqësuese të periudhës së dytë krijuese të kompozitorit, pjesa për violonçel dhe piano, “Ed é subito sera”, (1998), Kuarteti nr. 2 i harqeve, “Radius” (2003) të cilat janë shkruar me një stil jashtëzakonisht specifik dhe të veçantë. Nga analiza e kësaj krijimtarie, rezulton se muzika e dhomës e Th. Simakut, zë një vend të rëndësishëm në muzikën e dhomës shqiptare, ashtu siç ka dhe një impakt të lartë ndërkombëtar si rezultat i veprave të tij që vërshojnë në botë.

Fjalë kyçe

Muzika e dhomës, muzika tradicionale, spektër koloristik, teknika kompozicionale bashkëkohore

Ballata muzikolog; specifikat e muzikologjisë së tij

Jetmir Zaganjori

j.zaganjori94@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon qasjen muzikologjike të Zeqirja Ballatës, duke e trajtuar atë si një sistem të strukturuar interpretimi, në të cilin analiza e brendshme e punimeve muzikore ndërthuret me një vetëdije të qartë historike dhe identitare. Në këtë artikull synojmë të argumentojmë se veprimtaria e tij muzikologjike përbën një tjetër komponent thelbësor të profilit të tij krijues e intelektual, duke sjellë një kontribut të rëndësishëm në konsolidimin e mendimit muzikologjik në hapësirën mbarëshqiptare. Punimi përqendrohet në tri shtylla kryesore: në trajtimin e personaliteteve muzikore, në interpretimin e veprave dhe në reflektimin e analizën mbi ngjarjet e rëndësishme të jetës muzikore shqiptare e evropiane. Në tërësi, Ballata në punimet e tij ndërton një model ku struktura formale, konteksti kulturor dhe funksioni historik i punimit analizohen në ndërveprim. Në trajtimet e krijuesve të muzikës, ai shmang biografinë e thatë, duke i dhënë përparësi analizës kritike të veprës muzikore. Punimi mbështetet në një qasje historiko-analitike dhe strukturore, duke u bazuar në burime primare nga arkivi personal i kompozitorit (partitura, materiale dorëshkrimore, botime muzikologjike, regjistrime audio), në dokumente arkivore dhe intervista me bashkëpunëtorë e familjarë, si dhe në literaturën teorike përkatëse mbi stilin, funksionin estetik dhe raportin midis traditës dhe modernitetit në muzikën e kultivuar të autorëve të tjerë nga Shqipëria, Kosova dhe më gjerë. Në përfundim, punimi evidenton se tërësia e veprës muzikologjike të Ballatës përfaqëson një trashëgimi muzikore, ku muzika konceptohet njëkohësisht si strukturë estetike dhe si vlerë e produkt kulturor. Ajo ofron jo vetëm një model se si mund të bëhet muzikologjia nga një krijues, por edhe të dhëna të qëndrueshme për ngjarje, fenomene dhe personalitete me ndikim në jetën muzikore shqiptare dhe më gjerë.

Fjalë kyçe

Diskurs muzikologjik, zeqirja ballata, historiografi muzikore, identitet kulturor, jetë muzikore shqiptare

Koncertet për piano dhe orkestër të Kozma Larës (1974-1990): një vështrim historik dhe analitik

Klejda Tare

klejdatare@yahoo.it

U Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ofron një shqyrtim të thelluar të pesë koncerteve për piano dhe orkestër të kompozitorit shqiptar Kozma Lara (1930-2019), të kompozuara midis viteve 1974-1990. Duke u përqendruar si në sfidat historiografike ashtu edhe në perspektivat analitike, studimi synon të rishikojë dhe të pasurojë kuptimin për disa nga veprat e rëndësishme për repertorin pianistik shqiptar. Përmes një kërkimi sistematik arkivor që krahason burime primare të ndryshme, përfshirë dorëshkrimet origjinale, fletë-volantet e koncerteve, arkivat institucionale dhe enciklopeditë, ky studim vendos disa data të sakta të kompozimeve dhe interpretimet në premierë. Ky aspekt korrigjon gabime në dokumentacionin ekzistues, duke ofruar një kronologji të re, në mënyrë të veçantë për Koncertet Nr. 1 dhe Nr. 2. Më tej, punimi analizon evolucionin stilistik të këtyre koncerteve brenda kontekstit kompleks sociopolitik të Shqipërisë komuniste, duke eksploruar marrëdhënien dinamike dhe ndonjëherë të tensionuar midis presioneve ideologjike të kohës dhe shprehjes artistike individuale. Analiza muzikore zbulon se ndërsa Koncertet Nr. 2, 3 dhe 4 pasqyrojnë kufizimet e kontrollit të shtuar politik gjatë periudhës 1975-1986, Koncerti Nr. 5 dhe i fundit (1990) shënon një çlirim dhe pjekuri krijuese, duke u shfaqur si kulmi artistik i kompozitorit. Ky koncert i fundit simbolizon jo vetëm një triumf personal, por edhe një shpresë për një epokë të re muzikore në prag të shpërbërjes së sistemit diktatorial. Në përfundim, ky studim kontribuon në dy fusha kryesore të muzikologjisë shqiptare: së pari, duke krijuar një bazë të besueshme faktike për kronologjinë e veprës së Larës dhe së dyti duke ofruar një analizë të hollësishme të zhvillimit të tij stilistik, duke e pozicionuar atë si një figurë kyçe në historinë e koncertit për piano. Kështu, punimi nxjerr në pah qëndresën krijuese të kompozitorit nën kushte të vështira, ashtu edhe kontributin e pandërprerë të tij në formimin e traditës sonë kombëtare të muzikës pianistike.

Fjalë kyçe

Muzika shqiptare, repertor për piano, metodologjia arkivore, estetika komuniste

Muzika artistike në Kosovë gjatë viteve '90: krijimtaria dhe ruajtja e identitetit në periudha të tensionuara politike

Rreze Kryeziu Breznica

rreze.kryeziubreznica@uni-pr.edu

ORCID: 0000-0001-5601-5867

Fakulteti i Arteve, Departamenti i Muzikës, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
Prishtinë, Republika e Kosovës

Abstrakt

Muzika artistike në Kosovë gjatë viteve '90 përfaqëson një reagim të rëndësishëm kulturor ndaj një dekade të karakterizuar nga shtypja politike, përjashtimi institucional dhe tensionet që kulmuan me luftën e vitit 1999. Ky studim synon të analizojë krijimtarinë e kompozitorëve kosovarë gjatë periudhës 1990–1999 dhe të shqyrtojë mënyrën se si veprat e tyre kontribuan në ruajtjen dhe artikulimin e identitetit kulturor dhe kombëtar, pëballë përpjekjeve për akulturim të imponuar nga regjimi serb. Hulumtimi fokusohet tek muzika profesionale/artistike, duke përfshirë veprat simfonike, korale, vokal-instrumentale dhe të ato kamertale (të dhomës). Metodologjia kombinon hulumtim arkivor dhe bibliografik, shqyrtim të partiturave muzikore, intervista me kompozitorët që ishin aktivë gjatë viteve '90 dhe analizë muzikologjike të veprave përfaqësuese. Vëmendje e veçantë u kushtohet përmbajtjes tematike, trajtimit të motiveve historike, si dhe përdorimit të elementeve folklorike si mjete strukturore dhe shprehëse. Rezultatet tregojnë se praktikat kompozicionale të kësaj dekade pasqyrojnë angazhim të vetëdijshëm me temat e kujtesës kolektive, rezistencës, sakrificës dhe vazhdimësisë kulturore. Për më tepër, edhe pse shqiptarëve u mohojë pjesëmarrja në institucionet zyrtare, strukturat paralele arsimore dhe artistike mundësuan vazhdimësinë e krijimtarisë muzikore profesionale. Ky studim argumenton se muzika artistike në Kosovë gjatë viteve '90 funksionoi si formë e rezistencës kulturore dhe ruajtjes së identitetit, duke kontribuar në diskutimet më të gjera mbi muzikën dhe identitetin në kontekste të krizave politike.

Fjalë kyçe

Muzika dhe identiteti, muzika artistike në Kosovë, vitet '90, krijimtaria kompozitorike, rezistenca kulturore

Hartëzimi i rrjedhës kulturore në muzikë: teoria e Fluksit si një leksikon analitik në zhvillim

Elvis Peçi

elvis.peci@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky artikull zhvillon Teorinë e Fluksit përmes prezantimit të hartëzimit të Fluksit, aksiomës dhe formulës, si një kornizë e re metodologjike që përkufizon rrjedhën kulturore si një proces të matshëm dhe të analizueshëm në muzikë. Në vend që kultura muzikore të shpjegohet si një progresion historik linear, Teoria e Fluksit e koncepton atë si një sistem dinamik të formësuar nga ndërveprimi i forcave vepruese institucionale, kolektive, individuale dhe teknologjike. Hartëzimi i Fluksit modelohet përmes parametrave proporcionalë si drejtimi, intensiteti, autonomia, elasticiteti, saturimi dhe kompresimi, duke mundësuar që rrjedha kulturore të mund të shqyrtohet si një konstrukt analitik dhe jo thjesht si një metaforë. Duke prezantuar koncepte si Flux Compression, Flux Saturation, Flux Drift, Blocked Flux, Flux Elasticity, Accelerated Flux, Fragmented Flux dhe Algorithmic Isocollectivism, kjo qasje synon të përshkruajë mënyrën se si sistemet muzikore lëkunden midis isokolektivizmit, të karakterizuar nga forca centripetale dhe homogjenizuese, dhe polikolektivizmit, të përcaktuar nga pluraliteti centrifugal dhe bashkëekzistenca e trajektoreve të shumta krijuese. Korniza demonstron përmes rasteve të përzgjedhura nga historia dhe praktika muzikore shqiptare, dhe më tej në një kontekst krahasues përmes shembujve ndërkombëtarë të kompozitorëve të lidhur me impresionizmin dhe modernizmin. Pozicionimi teorik informohet nga, por mbetet i dallueshëm prej, perspektivave në muzikologji, estetikë dhe sociologji kulturore, duke u angazhuar kritikisht me mendimtarë si Jacques Attali, Arjun Appadurai, Pierre Bourdieu dhe Theodor W. Adorno. Duke e bazuar Teorinë e Fluksit në një gjuhë analitike të transferueshme dhe duke e testuar atë përmes rasteve konkrete muzikore, Flux Mapping (Hartëzimi i Fluksit) mund të pozicionohet si një mjet i ri metodologjik për kërkimin muzikologjik, edukimin artistik dhe analizën e politikave kulturore në epokën e ndërmjetësimit teknologjik.

Fjalë kyçe

Formula e Fluksit, hartëzimi i Fluksit, rrjedhë kulturore, isokolektivizëm, polikolektivizëm

Interpretimi në piano dhe rapsodia për piano orkestër e Ferdinand Dedës

Laura Lila

laura_lila09@hotmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Gjatë zhvillimit të muzikës koncertale shqiptare për piano dhe orkestër në gjysmën e dytë të shekullit XX, një vend të veçantë zë dhe zhaneri i Rapsodive për piano orkestër. Kjo krijimtari përfaqëson një fazë të rëndësishme të konsolidimit të stilit kombëtar në muzikën pianistike. Kjo kumtesë synon të analizojë aspektet interpretative të lojës pianistike të Rapsodisë për piano dhe orkestër të Ferdinand Dedës, duke krahasuar atë me modelet e huaja, dhe se si ato kanë ndikuar, dhe kanë influencuar në interpretimin pianistik të repertorit shqiptar, duke e trajtuar veprën jo vetëm nga këndvështrimi strukturor, por sidomos nga perspektiva e realizimit interpretativ. Në bazë të studimit qëndron metoda analitike, interpretative, dhe krahasuese, duke u mbështetur në literaturën mbi teorinë e interpretimit pianistik dhe në modelet e repertorit ndërkombëtar të gjinisë koncertale. Analiza do të fokusohet në elementet kryesore pianistike të veprës, si trajtimi i figuracionit virtuoz, përdorimi i regjistrave ekstremë, dinamika dramatike dhe raporti dialogjik midis solistit dhe orkestrës. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mënyrës se si interpretimi në këtë vepër lidhet ngushtë me materialin folklorik shqiptar.

Fjalë kyçe

Pianizmi shqiptar, Ferdinand Deda, analiza interpretative, folklori muzikor shqiptar, modaliteti dhe ritmi

Veprat e para metodike për piano: Miniaturat pianistike, lindja dhe evolucioni, modernia e postmodernia, minimalizmi, Tonin Harapi

Fatma Spahiu

namartalbania@hotmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Miniaturat pianistike, pjesë shumë e rëndësishme e gjinisë në fjalë, kanë lindur dhe evoluar duke filluar nga romantizmi për t'u kristalizuar në formën aktuale përgjatë epokës moderne. Këto sytha muzikore, shpesh konsideruar si diamante, edhe pse të një dimensionit të kufizuar në formë por jo në përmbajtje, përmbajnë një fuqi ekspresiviteti të pakrahasueshëm falë impaktit të menjëhershëm emocional të tyre, duke u renditur nga kjo pikpamje, krahas kompozimeve të formateve të mëdha. Qëllimi është shqyrtimi i evolucionit të saj ndër autorë dhe epoka si dhe roli i kompozitorit Tonin Harapi në kultivimin me shumë sukses të miniatures pianistike shqiptare. Metodologjia e ndjekur, është ajo e përfshirjes me metoda analitike e krahasimore të aspekteve të shumta në rrafshin kërkimor, si dhe qasja me rigorozitet ndaj rrethanave kohore dhe historike të epokave që do të studiojmë apo flasim, duke filluar nga shekulli i 18-të e në vazhdim. Faktet dhe opinionet që do të shihen apo shtjellohen gjatë punimit janë analizuar natyrisht besnikërisht partiturave muzikore, historisë së muzikës botërore dhe asaj shqiptare si dhe studimeve adeqate e dëshmime mbi këtë fushë. Nga njëra anë, krahas këndvështrimit artistik edhe atij social e kulturor, do të shqyrtohet edhe impakti me proceset didaktike apo mësimdhenien e instrumentit, por nga ana tjetër, do të theksohet edhe roli përcaktues i kompozitorëve të epokës moderne, në evoluimin e gjinisë dhe impulseve të këtij formati, si për shëmbull ndaj stilit të minimalizmit, si dhe diferencat mes tyre. Konkludohet me vendin e merituar që zë miniatura instrumentale, si një gjini e evoluar dhe e filtruar në formë konçize, në repertorin e muzikës profesionale botërore dhe atë shqiptare me përfaqësues kompozitorin Tonin Harapi.

Fjalë kyçe

Epoka, gjini, didaktika, evolucion, kompozitor

Mes rapsodisë dhe koncertit: një këndvështrim analitik i Dubël- koncertit për violinë, violonçel e orkestër të kompozitorit Thoma Gaqi

Arjan Brahimi

brahimiarjan@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim merr në shqyrtim veprën “Rapsodi-koncert për violinë, violonçel dhe orkestër” të kompozitorit Thoma Gaqi, një nga krijimet më të veçanta të repertorit koncertal shqiptar. Objekti i studimit përqendrohet në analizën e kësaj vepre si një ndërthurje origjinale midis gjinisë së rapsodisë dhe asaj koncertale, si edhe në trajtimin e saj si dubël-koncert – një formë relativisht e rrallë në traditën kompozicionale, si në kontekstin shqiptar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Qëllimi i punimit është të evidentojë tiparet konceptuale dhe strukturoro-formale të veprës, duke shqyrtuar mënyrën se si ndërtohet raporti mes dy instrumenteve solistë (violinë dhe violonçel) dhe orkestrës, si dhe të përcaktojë pozicionin e saj në kuadrin e zhvillimit të muzikës koncertale shqiptare. Një vëmendje e veçantë i kushtohet dialogut solistik, dimensionit dramaturgjik dhe organizimit tematik, në funksion të identifikimit të elementeve rapsodike dhe atyre tipike të koncertit, ku një vend të veçantë zë kadenca solistike e të dy instrumenteve njëkohësisht, gjë që tregon një profesionalizëm të lartë kompozicional të autorit. Metodologjia e ndjekur është ajo analitike, e mbështetur në shqyrtimin e strukturës formale, trajtimit motivor, zhvillimit tonal-harmonik dhe organizimit orkestral. Përmes analizës konkrete synohet një përgjithësim konceptual mbi mënyrën se si vepra realizon sintezën ndërmjet narrativës dhe trajtimit më të lirë të rapsodisë dhe koherencës strukturore të koncertit. Në përfundim, studimi nxjerr në pah se kjo vepër përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në repertorin shqiptar, si për nga zgjedhja e formës dubël-koncertale, ashtu edhe për nga ndërtimi i një hapësire të pasur dialoguese mes dy solistëve dhe orkestrës, duke dëshmuar pjekuri kompozicionale dhe një vizion të qartë estetik.

Fjalë kyçe

Dubël-koncert, rapsodi, monotematizëm, formë njëkohëshe, sonatë

Recitali i parë i dokumentuar në Shqipëri (1926): lindja e praktikës së recitalit në kontekstin e formimit të kulturës koncertale shqiptare

Entela Demi

entelademi_27@hotmail.com

Kolegji AAB, Fakulteti i Arteve, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Recitali solistik përfaqëson një praktikë komplekse artistike që tejkalon dimensionin e një forme koncertale, duke funksionuar si hapësirë interpretative e kulturore ku ndërtohen marrëdhënie ndërmjet traditës, identitetit dhe kontekstit historik. Në Shqipëri, shfaqja e kësaj forme lidhet me procesin e formimit të institucioneve muzikore dhe të edukimit profesional, në një realitet të kushtëzuar nga rrethanat historike dhe kulturore të fillimit të shekullit XX. Në këtë kontekst, recitali i mbajtur më 3 dhjetor 1926 në Tiranë nga violinisti Ludovik Naraçi trajtohet si një nga dëshmitë e hershme të praktikës së recitalit në vend. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë këtë recital si një moment domethënës në lindjen e praktikës së recitalit në Shqipëri, duke shqyrtuar dimensionin historik dhe kulturor të tij. Pyetja kryesore hulumtuese është: Në ç' mënyrë ky recital përfaqëson një hap drejt kalimit nga praktikat muzikore amatore drejt një kulture koncertale profesionale? Hipoteza e studimit është se ky recital funksionon si një pikë referimi e hershme për përvetësimin e modelit evropian të recitalit në kontekstin shqiptar, duke krijuar një bazë për zhvillimet e mëvonshme të muzikës solistike. Duke përdorur metodologjinë historike dhe analitike, të mbështetur në burime arkivore, studimi synon të analizojë rëndësinë e këtij eventi në raport me kohën. Analiza e programit dhe e rolit të interpretuesit si ndërmjetës kulturor, në plan krahasimor, evidenton ndikimin e modeleve europiane në një mjedis muzikor ende në formim. Rezultatet tregojnë se ky recital nuk përfaqëson vetëm një ngjarje koncertale të izoluar, por një moment të rëndësishëm në ndërtimin e kulturës koncertale shqiptare dhe në afirmimin e figurës së interpretuesit solist. Përfundimet theksojnë se studimi i këtij rasti ofron një këndvështrim mbi fillimet e jetës koncertale profesionale në Shqipëri dhe mbi rolin e recitalit në historinë e muzikës shqiptare të shekullit XX.

Fjalë kyçe

Interpretim solistik, repertor, dialog ndërkulturor, identitet muzikor

Afrimi i këngëve dhe valleve popullore të folklorit, me muzikën e kultivuar e profesioniste tek baleti “Delina” i Çesk Zadejës

Lorenc Treska

treskalorenc@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij punimi është analiza e baletit “Delina” të kompozitorit Çesk Zadeja, si një nga veprat më përfaqësuese të muzikës profesioniste shqiptare dhe si një moment kyç në formësimin e identitetit kombëtar në artin muzikor skenik. Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë mënyrën se si kjo veprë realizon ndërthurjen organike të elementeve të folklorit shqiptar me teknikat e kompozimit bashkëkohor, duke krijuar një gjuhë muzikore autentike dhe të qëndrueshme. Punimi mbështetet në një analizë historike dhe muzikologjike të kontekstit në të cilin u krijua baleti, konkretisht në vitin 1964, në një periudhë të rëndësishme të konsolidimit të muzikës së kultivuar shqiptare. Formimi profesional i Zadejës në Konservatori P. I. Çajkovskij dhe përvoja e tij e pasur në përpunimin e materialit folklorik kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndërtimin e një stili të veçantë kompozicional, i cili dallon për thellësinë artistike dhe për qartësinë e shprehjes. Një pjesë e rëndësishme e studimit i kushtohet analizës së gjuhës muzikore të baletit, ku vihen në pah tipare të tilla si përdorimi krijues i motiveve popullore, shmangia e citimit të drejtpërdrejtë dhe ndërtimi i strukturave harmonike e ritmike me karakteristika kombëtare. Gjithashtu, trajtohet organizimi dramaturgjik i veprës, i ndërtuar mbi legjendën e “Gurit të Vashës”, duke reflektuar një unitet të qëndrueshëm midis muzikës dhe zhvillimit skenik. Në përfundim, punimi arrin në konkluzionin se baleti “Delina” përfaqëson një arritje madhore në historinë e muzikës shqiptare, duke shërbyer si model për zhvillimet e mëvonshme të muzikës skenike dhe duke dëshmuar potencialin e madh të ndërthurjes së traditës me risinë në krijimtarinë artistike.

Fjalë kyçe

Çesk Zadeja, Delina, muzikë shqiptare, folklor, balet

Krijimtaria shqiptare për flaut në këndvështrimin e kompozitorëve të formuar në kohërat modern

Rozana Kuka

rozanakuka@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Në prag të viteve 1990, së bashku me tejkalimin e pengesave ideologjike, lindi nevoja e integritit të botës muzikore shqiptare në skenën muzikore bashkëkohore europiane. Muzika europiane e botërore, lidhur me procesin e evolucionit muzikor dhe kompozicional pati etapa të ndryshme përjetimi e zhvillimi, kurse në Shqipëri mungesa e informacionit dhe e përjetimit bëri që krijimtaria shqiptare në vitet 90' të vinte disi e sforcuar. Qëllimi i këtij punimi është që përmes vështrimit dhe trajtimit teorik e praktik mbi karakteristikat dhe qasjet moderniste të krijimtarisë shqiptare për flaut, të evidentojë zhvillimin e saj në këndvështrimin e krijuesve të formuar në kohën moderne e dixhitale. Ky studim mer rëndësi, sepse ofron një pikë referimi me karakter njohës e edukues dhe përbën një fushë me interes në kohët e sotme duke përfaqësuar një analizë të mundësive shprehëse të instrumentit të flautit. Veprat e përzgjedhura janë materiale të krijuara nga dy kompozitorë të rinj, të formuar në vitet e lulëzimit dhe qasjeve moderniste e avangarde në Shqipëri. Veprat: “Echi d’Oriente”, për flaut e pianoforte krijuar nga Lodi Luka dhe “Trio, dy flaute dhe pianoforte”, krijuar nga Ajet Çekiçi, janë materiale të cilat i kam interpretuar përgjatë eksperiencave të mia koncertale, dhe bashkëveprimi ndërmjet analizës teorike dhe asaj praktike na japin një panoramë më të qartë rreth gjetjeve në këtë studim. Metodologjia e përdorur kryesisht është e bazuar në analizën kërkimore-shkencore të materialeve të përzgjedhura, metodën krahasuese, analizën e burimeve teorike e praktike. Duke synuar evidentimin e karakteristikave të krijimtarisë për flaut në fokusin e krijuesve shqiptarë të kohës së re, arrijmë në përfundim se, ky instrument me diapazon të gjerë, timbër brilant dhe shumë koloristik, ofron avantazhe në transmetimin e emocioneve dhe ideve, nisur kjo dhe nga eksperiencia personale në interpretimin e tyre.

Fjalë kyçe

Tingulli, linja melodike, fragmente melodike, elementët

Muzika si arkitekturë emocionale: atmosfera dramatike dhe roli i tingullit në artet performative

Mimoza Kurshumlia, Sonia Zdrakova Djeparoska

mimoza.kurshumlia@uni-gjk.org, z.djeparoska@gmail.com

Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë, Kosovë, S.s Cyril and Methodius University of Skopje, Shkup, Maqedoni

Abstrakt

Ky studim e rikoncepton muzikën në teatër si strukturë semiotike dhe mekanizëm i temporalitetit performativ, duke e trajtuar atë si arkitekturë emocionale që modelon përvojën estetike të publikut. Përtej funksionit ilustrativ apo shoqërues, muzika analizohet si forcë konstitutive e dramaturgjisë, e aftë të organizojë kohën skenike, të artikulojë tensionin dramatik dhe të ndërtojë një estetikë të afektit që ndërvepron në mënyrë dinamike me trupin aktorial dhe hapësirën performative. Në këtë kuptim, tingulli nuk funksionon si element periferik, por si sistem kuptimor aktiv që prodhon narrativë, ritëm dhe densitet emocional. Qasja metodologjike ndërthur analizën muzikore me leximin dramaturgjik dhe vëzhgimin e proceseve performative, duke përfshirë studime rastesh nga praktika të ndryshme skenike bashkëkohore. Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënies krijuese ndërmjet regjisorit dhe kompozitorit si një hapësirë negociimi estetik, ku muzika konceptohet dhe zhvillohet si pjesë integrale e vizionit regjisorial. Studimi gjithashtu analizon dimensionin perceptiv të publikut, duke shqyrtuar mënyrën se si strukturat tingullore ndikojnë në ndërtimin e pritjes, kujtesës dhe reagimit emocional gjatë performancës. Një aspekt i rëndësishëm trajton rolin e teknologjisë në transformimin e materialitetit të tingullit dhe në krijimin e hapësirave zanore imersive që zgjerojnë kufijtë e përvojës skenike. Rezultatet sugjerojnë se muzika funksionon si rregullator i energjisë dramatike dhe si medium që intensifikon përjetimin afektiv, duke krijuar një koherencë të thelluar ndërmjet strukturës narrative dhe përvojës emocionale të spektatorit. Studimi argumenton se integrimi strategjik i muzikës në dramaturgjinë bashkëkohore përfaqëson një paradigmë të re të mendimit skenik, ku tingulli, trupi dhe hapësira bashkëveprojnë në ndërtimin e një përvoje performative komplekse dhe ndërdisiplinore.

Fjalë kyçe

Muzikalitet, dramaturgji, ritmikë, regji, performancë

Gjinia operistike në epokën postmoderne – rindërtimi i traditës, fragmentarizimi i subjektit dhe skena si laborator shoqëror

Valmir Xoxa

valmirxoxa@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij artikulli është të trajtojë operën postmoderne si një hapësirë e privilegjuar ku ndërthuren proceset estetike, politikat e kujtesës dhe tensionet e shoqërisë së vonë moderne. Duke u mbështetur në studimet muzikologjike dhe kulturore mbi operën (Abbate & Parker, Hutcheon, Till, Fulcher), si edhe në teorinë më të gjerë të postmodernizmit (Lyotard, Jameson, Eco, Kramer), punimi argumenton se postmodernizmi në operë nuk përbën thjesht një ‘stil’ të ri, por një mënyrë të re të menduarit për raportin ndërmjet traditës, subjektit dhe institucioneve skenike. Gjatë rrugëtimit tim pika e nisjes është vëzhgimi se opera, e lidhur historikisht me ‘rrefimin e madh’ të kombit, heroit dhe fatit metafizik, në periudhën postmoderne përjeton një shpërbërje të vetë këtyre narrativave: fragmentarizim i strukturës dramatike, polistilizëm, citim ironik i traditës (si kundërvenie ndaj traditës, e posaçërisht stilit Wagnerian dhe atij impresionist) dhe zhvendosje e qendrës nga heroi drejt trupit vulnerabël, thënë ndryshe dhe anti-heroit (përfaqësuesit e rrymës ekzistenciale) dhe zërit të ‘thyer’. Përmes një rishikimi të literaturës dhe një metodologjie ndërdisiplinore – që kombinon analizën muzikore, studimet e performancës dhe teorinë kulturore – artikulli ndalet te disa konfigurime tipike: opera si ‘vepër e hapur’, si palimpsest intertekstual (Eco, Sciarrino), si laborator i zërit të dekompozuar (Aperghis, post-serializmi) dhe si fushë ku regjizura dhe skenografia postmoderne rishkruajnë vetë marrëdhënien mes publikut dhe skenës.

Fjalë kyçe

Opera postmoderne, polistilizëm, narrativë e fragmentarizuar, vepër e hapur, skenografi postmoderne

Muzika si praktikë rezistence dhe ndërtimi i identitetit kombëtar në Kosovë (1980-2000)

Armend Xhoni

armend.xhoni@uni-pr.edu

Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishinë, Kosovë

Abstrakt

Ky studim shqyrton rolin e muzikës në Kosovë gjatë viteve 1980-2000 si praktikë kulturore e lidhur me rezistencën dhe artikulumin e identitetit kombëtar shqiptar, si dhe mënyrën se si kjo përvojë riinterpretohet në kujtesën kolektive pas konfliktit. Studimi mbështetet në një qasje cilësore dhe analizon të dhëna të mbledhura përmes një pyetësi me pyetje të hapura, të plotësuar nga 14 pjesëmarrës të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, përfshirë muzikantë, interpretues, studiues dhe dëgjues. Qasja metodologjike synon të kapë kompleksitetin e përvojave individuale dhe kuptimeve që lidhen me muzikën në këtë periudhë historike. Të dhënat janë analizuar përmes analizës tematike induktive. Rezultatet identifikojnë katër dimensione kryesore: muzika si formë rezistence dhe mobilizimi, si bartëse e identitetit kombëtar, si medium ku përkatësia artikullohet edhe përmes strukturës muzikore, dhe si fushë tensioni ndërmjet kujtesës historike dhe komercializimit pas vitit 1999. Gjetjet tregojnë se muzika funksionon si hapësirë e rëndësishme e ndërtimit të identitetit dhe kujtesës kolektive në kushte transformimi shoqëror, duke ofruar dëshmi empirike mbi rolin e saj në kontekstin e Kosovës. Ky studim kontribuon në kuptimin e marrëdhënies ndërmjet praktikave kulturore dhe proceseve të ndërtimit të identitetit në kontekste të transformimit shoqëror. Po ashtu, ai ofron një perspektivë të bazuar në përvojën e pjesëmarrësve mbi mënyrën se si muzika ndërmjetëson kujtesën kolektive dhe interpretimin e së kaluarës në shoqëritë post-konflikt. Në këtë mënyrë, studimi nënvizon rëndësinë e analizimit të muzikës jo vetëm si formë artistike, por si praktikë shoqërore e ndërlidhur me përvojën historike. Ai gjithashtu hap rrugë për kërkime të mëtejshme që shqyrtojnë ndërthurjen ndërmjet muzikës, kujtesës dhe identitetit në kontekste post-konfliktuale.

Fjalë kyçe

Muzika; identiteti kombëtar; kujtesa kolektive; rezistenca kulturore; Kosovë

Gjinia e këngës. çështje të terminologjisë muzikore

Eriona Rushiti

rushitieriona@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Çështjet e terminologjisë muzikore mbeten kryesisht të patrajuara në mendimin teorik shqiptar, ndërkohë që edhe në diskursin teorik ndërkombëtar përdorimi i terminologjisë në gjininë e këngës vijon të jetë objekt debatesh të hapura akademike dhe krahasimi kulturor. Në këtë kuadër, terminologjia nuk përbën thjesht një çështje emërtimi, por një mekanizëm përmes të cilit strukturohen kuptimet estetike, historike dhe ideologjike të muzikës. Studimi synon të problematizojë përdorimin e terminologjisë në muzikën e lehtë shqiptare, duke evidentuar pasaktësitë dhe paqartësitë në kategorizimin e saj, si dhe duke shqyrtuar raportin e këtyre praktikave me modelet ndërkombëtare të klasifikimit muzikor. Metodologjia mbështetet në një analizë krahasuese dhe konceptuale, duke u bazuar në tri qasje teorike: kritika e industrisë kulturore e Theodor W. Adorno-s, teoria e rregullave të gjinisë muzikore e Franco Fabbri-t dhe perspektiva sociologjike e Simon Frith-it. Analiza përfshin një korpus këngësh përfaqësuese nga periudha të ndryshme të muzikës së lehtë shqiptare, duke marrë në konsideratë si prodhimin institucional, ashtu edhe praktikën muzikore jashtë tij. Rezultatet tregojnë se terminologjia e gjinisë në Shqipëri funksionon në mënyrë jo të qëndrueshme, duke reflektuar tensione midis standartizimit institucional dhe praktikave lokale. Ndikimet e muzikës popullore dhe format e saj të përpunuara kanë ndikuar ndjeshëm në formësimin e kategorive muzikore, ndërsa mungesa e një sistemi të konsoliduar terminologjik prodhon paqartësi analitike dhe interpretative. Në përfundim, punimi argumenton se terminologjia muzikore në kontekstin shqiptar duhet të rishikohet si një fushë kritike analize dhe jo thjesht si një mjet klasifikimi. Duke propozuar një lexim më të strukturuar dhe kritik të saj, punimi synon të kontribuojë në zhvillimin e një qasjeje më të qëndrueshme konceptuale për studimet muzikologjike bashkëkohore.

Fjalë kyçe

Terminologjia muzikore, muzika e lehtë, ndikime të muzikës popullore

Muzika e lehtë shqiptare dhe aplikimi i teknologjisë

Enis Mulla

prod.byenismullaj@outlook.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Në historinë e muzikës shqiptare, zhvillimi i teknologjisë nuk është trajtuar ende në aspektin shkencor. Qëllimi i punimit është të analizojë rolin e teknologjisë jo vetëm si mjet ndihmës në procesin krijues, por si faktor kyç në formësimin estetik dhe stilistik të kësaj gjinie muzikore në kontekstin shqiptar. Në analizën krahasuese të rasteve konkrete nga zhvillimi i muzikës së lehtë shqiptare në periudha të ndryshme historike, metodologjia e përdorur bazohet në rishikimin e literaturës muzikologjike dhe teknologjike. Studimi merr në shqyrtim përdorimin e teknologjive të regjistrimit analog dhe digjital, hyrjen e sintetizatorëve dhe programeve kompjuterike, si dhe ndikimin e tyre në krijimtarinë e kompozitorëve dhe producentëve shqiptarë. Rezultatet tregojnë se zhvillimet teknologjike kanë ndikuar drejtpërdrejt në transformimin e gjuhës muzikore të muzikës së lehtë shqiptare, duke mundësuar zgjerimin e mjeteve shprehëse, rritjen e individualitetit krijues dhe përhapjen më të gjerë të prodhimit muzikor. Veçanërisht, kalimi nga teknologjitë analoge në ato digjitale ka sjellë ndryshime të dukshme në strukturën tingëllore, orkestracion dhe stil. Për më tepër, hulumtimi nënvizon se demokratizimi i mjeteve të prodhimit ka mundësuar që artistët e rinj të eksplorojnë tekstura të reja sonore, duke shkruar elementet tradicionale me ato elektronike moderne. Përdorimi i stacioneve të punës digjitale (DAW) dhe inteligjencës artificiale ka rritur efikasitetin krijues, duke lejuar manipulimin e saktë të timbrit dhe strukturës harmonike. Ky transformim nuk është vetëm teknik, por ka ridefinuar edhe kufijtë e autorësisë dhe bashkëpunimit në distancë, duke e pozicionuar muzikën e lehtë shqiptare në një treg global dhe gjithnjë e më dinamik. Në përfundim, studimi evidenton se evolucioni i muzikës së lehtë shqiptare është i lidhur ngushtë me zhvillimet teknologjike, të cilat kanë ndikuar jo vetëm në aspektin teknik të prodhimit, por edhe në perceptimin estetik dhe shijen e publikut. Studimi thekson nevojën për qasje ndërdisiplinore midis muzikologjisë dhe teknologjisë së tingullit për të kuptuar më thellë këtë ndërveprim në kontekstin e muzikës shqiptare pas viteve 90.

Fjalë kyçe

Teknologjia, muzika e lehtë, muzika moderne

Transformimi i muzikës së filmit në Shqipërinë e pas viteve '90

Voltan Prodani

vprodani@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon transformimin e muzikës së filmit në Shqipërinë e pas viteve '90 në kontekstin e zhvillimeve teknologjike dhe ndryshimit të figurës së krijuesit muzikor. Qëllimi i studimit është të evidentojë mënyrën se si kalimi nga një sistem i centralizuar drejt një realiteti digjital dhe të decentralizuar ka ndikuar në funksionin estetik, narrativ dhe strukturor të muzikës në film. Studimi mbështetet në një qasje ndërdisiplinore që kombinon analizën muzikologjike me studimin e praktikave të produksionit muzikor dhe referimin në literaturën bashkëkohore mbi muzikën e filmit dhe teknologjinë muzikore. Në planin teorik, punimi mbështetet në konceptet e Claudia Gorbman mbi funksionin narrativ të muzikës filmike, Michel Chion mbi marrëdhënien midis tingullit dhe imazhit dhe Frank Lehman mbi dimensionin strukturor të muzikës në film. Në planin analitik përfshihen raste konkrete nga repertori shqiptar pas viteve '90, duke analizuar strukturën melodike, harmonike, orkestracionin dhe funksionin narrativ të tyre në raport me zhvillimin dramatik të filmit. Rezultatet tregojnë se muzika e filmit në Shqipëri ka kaluar nga një rol ilustrativ në një komponent aktiv dhe strukturor të narrativës audiovizuale, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndërtimin e kuptimit dhe të përvojës emocionale të spektatorit. Në përfundim, argumentohet se ndërveprimi midis teknologjisë muzikore dhe figurës së kantautorit ka prodhuar një model të ri krijues të integruar, i cili reflekton zhvillimet estetike dhe teknologjike të epokës digjitale dhe rrit autonominë e krijuesit në procesin e realizimit muzikor.

Fjalë kyçe

Muzika e filmit, teknologjia muzikore, narrativë audiovizuale, kompozim, Shqipëria pas viteve '90

Digjitalizimi i arkivit muzikor të Radio Tiranës

Santana Xheladini Myftaraj

santana.xheladini@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij studimi është Arkivi Muzikor i Radio Tiranës, një institucion i themeluar në vitin 1938, i cili përfaqëson një nga koleksionet më të pasura dhe të rëndësishme dokumentare për historinë e muzikës në Shqipëri. Ky arkiv përfshin regjistrime të formacioneve profesionale, koncerteve dhe festivaleve muzikore, krijimtarisë vokale dhe instrumentale, si dhe materiale të rralla të shekullit XX, duke siguruar një pasqyrë të plotë mbi zhvillimin dhe diversitetin e muzikës shqiptare. Qëllimi i studimit është të analizojë procesin e digjitalizimit të këtij arkivi, duke vlerësuar ndikimin e tij mbi ruajtjen, aksesueshmërinë dhe rivlerësimin e trashëgimisë muzikore. Rëndësia e hulumtimit lidhet me rrezikun e degradimit të mbartësve analogë, nevojën për standardizim të procedurave teknike dhe integrimin e materialeve arkivore në praktikat bashkëkohore kërkimore, edukative dhe kulturore. Metodologjia e ndjekur përfshin analizën arkivore, vëzhgimin e procesit teknik të digjitalizimit, intervista me specialistë të fushës, si dhe shqyrtimin e standardeve ndërkombëtare për ruajtjen dhe restaurimin e materialeve audio. Rezultatet identifikojnë sfidat teknike, organizative dhe institucionale të procesit, por evidentojnë gjithashtu potencialin e madh të formatit digjital për klasifikim, katalogim, restaurim zanor dhe shpërndarje në platforma të aksesueshme për studiues dhe publik. Në përfundim, digjitalizimi i Arkivit Muzikor nuk paraqitet vetëm si një proces teknik, por si një akt kulturor dhe strategji për mbrojtjen e memories kolektive, duke theksuar rolin e arkivit si burim kërkimor, studimor dhe edukativ. Studimi rekomandon hartimin e një strategjie afatgjatë institucionale, trajnimin e specialistëve dhe krijimin e një databaze të standardizuar që garanton ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të kësaj trashëgimie muzikore.

Fjalë kyçe

Digjitalizim, arkiv muzikor, trashëgimi kulturore, ruajtje audio, Radio-Tirana

Kënga popullore si shprehje e identitetit kulturor shqiptar: jeta dhe krijimtaria e kompozitorit Muharrem Gurra

Elvina Gurra

elvina.gurra@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Muzika popullore përbën një nga format më të rëndësishme të shprehjes, ruajtjes dhe transmetimit të identitetit kulturor të një populli. Në traditën shqiptare, kënga popullore ka shërbyer si mjet artistik dhe kulturor për kujtesën kolektive, vlerat shoqërore, traditat dhe përvojat historike të komuniteteve të ndryshme. Në këtë kontekst, studimi i krijimtarisë së kompozitorëve, që kanë kontribuar në pasurimin dhe zhvillimin e repertorit të muzikës popullore merr një rëndësi të veçantë në aspektin e identitetit kulturor shqiptar. Në këtë kumtesë synohet të analizohet jeta dhe aktiviteti krijues i kompozitorit Muharrem Gurra, parë në një kontekst të gjerë si kontribues në kultivimin e përkatësisë së identitetit kulturor shqiptar. Në punim merr rëndësi të veçantë arkivimi dhe dokumentimi i veprave të kompozitorit, partiturat e shkruara, por edhe regjistrimet audio që shërbejnë si burime parësore të rëndësishme për ruajtjen, analizimin dhe transmetimin origjinal të trashëgimisë muzikore shqiptare. Hulumtimi mbështetet në një metodologji me qasje historiko-dokumentare, etnomuzikologjike dhe arkivore, që ka në fokus analizimin e jetës, krijimtarisë dhe trashëgimisë muzikore të kompozitorit Muharrem Gurra duke analizuar partiturat, regjistrimet audio të materialeve të arkivuara, studimet si dhe intervista e dëshmi të artistëve, studiuesve dhe familjarëve. Si përfundim arrihet në konkluzionin se përmes kontributit dhe aktivitetit të tij artistik, regjistrimeve institucionale, repertori popullor i Shqipërisë së Mesme u ruajt dhe u konsolidua si pjesë e identitetit muzikor kombëtar, fakt ky, që dëshmon rëndësinë e arkivimit muzikor në konservimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Fjalë kyçe

Muzika popullore shqiptare, dokumentimi muzikor, trashëgimia kulturore

**Paralele historike dhe funksionale të isos në polifoninë shqiptare dhe
isos (ison-it) në muzikën bizantine
(Një lexim përmes studiuësve vendas dhe të huaj)**

Holta Sina Kilica

sinaholta@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i kësaj kumtese është shqyrtimi i fenomenit të isos në dy tradita vokale me peshë të veçantë kulturore dhe historike: polifonia shqiptare dhe muzika bizantine. Isoja trajtohet si element strukturor dhe funksional, me rol thelbësor në ndërtimin e ligjërit muzikor, si në praktikën e këndimit polifonik shqiptar, ashtu edhe në kontekstin liturgjik të muzikës bizantine. Punimi fokusohet në analizën e paraleleve historike dhe funksionale të këtij fenomeni, duke u mbështetur në kontributet teorike dhe interpretative të studiuësve vendas dhe të huaj mbi gjenezën e isos. Qëllimi i kumtesës është të evidentojë mënyrat e konceptimit dhe përdorimit të isos (burdonit) në këto dy kultura muzikore, si dhe të ndriçojë proceset historike, estetike dhe funksionale që kanë ndikuar në formësimin e saj. Në këtë kuadër, do të shqyrtohen faktet nëse isoja përfaqëson një element me origjinë të përbashkët kulturore, një zhvillim paralel të dy traditave, apo një fenomen të ndërthurur përmes kontakteve historike dhe kulturore në hapësirën ballkanike. Metodologjia e punimit është historiko-teorike dhe krahasimtare. Në këtë kontekst, ajo do të mbështetet në një fond të gjerë burimesh bibliografike, që përfshijnë studime muzikologjike, etnomuzikologjike dhe liturgjike. Përmes krahasimit të funksionit muzikor, rolit strukturor dhe kontekstit të përdorimit të isos, synohet evidentimi i pikëtakimeve të mundshme, si dhe i specifikave dalluese që karakterizojnë secilën traditë. Në përfundim, kumtesa synon të kontribuojë në një kuptim më të strukturuar dhe më të thelluar të fenomenit të isos, duke ofruar një perspektivë krahasimtare që ndihmon në interpretimin e marrëdhënieve dhe ndërveprimeve muzikore e kulturore në hapësirën ballkanike, duke nxitur diskutime të reja teorike mbi identitetin muzikor rajonal ballkanik si dhe në kahun tjetër, synon në një prurje të re edhe në kuadër të studimeve tona muzikologjike.

Fjalë kyçe

Iso - ison (burdon), polifonia shqiptare, muzika bizantine, funksion muzikor, qasje historike-krahasimtare

Gjuha muzikore në veprat origjinale për instrumentin e kitarës nga Rafet Rudi dhe Aleksandër Peçi

Dashamir Mehmeti

dashamirmehmeti03@icloud.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i kësaj kumtese është shqyrtimi i veprave muzikore të dy kompozitorëve, Rafet Rudi dhe Aleksandër Peçi, krijuar për instrumentin e kitarës në mënyrë krahasuese, sesi është përdorur tradita kompozicionale, teknika, estetika dhe trajtimi ideve muzikore për këtë instrument. Gjithashtu, ky hulumtim kërkon të nxjerrë në pah përherë të parë, duke plotësuar mungesën e studimeve të mirëfillta, të raportit të ndërsjellë të instrumentit të kitarës dhe të studimeve shqiptare. Njëkohësisht nevojën për të kuptuar zhvillimin dhe ndikimin e proceseve moderne të kompozicionit, të teknikës së orkestracionit dhe regjistrimit në formësimin e identitetit muzikor bashkëkohor. Metodologjia e përdorur në këtë punim mbështetet në analizën që i bëhet veprave muzikore si: 1- “Rrojta” vepër për kitarë dhe ansambël koral, 2- “Petite Suite” për kitarë solo të kompozitorit Rafet Rudi dhe “Album for Guitar “ Volume 1 e kompozitorit Aleksandër Peçi. Analiza bazohet në trajtimin kompleks të elementeve të gjuhës muzikore, duke u ndalur në organizimin e formës, strukturës muzikore, melodisë, harmonisë, ritmit, teknikës instrumentale dhe timbrikës. Përmes metodës krahasuese të veprave, kjo qasje nxjerr në pah karakteristikat individuale të secilit kompozitor, sesi është përfaqësuar përdorimi virtuoz në konceptet e tyre kompozicionale, duke sjellë gjetje dhe vlerësime në bashkëveprimin e teknikave bashkëkohore të kompozimit, zbulimin e ngjyrave të këtij instrumenti me bashkëtingëllimin e integritetit të instrumenteve bashkëkohor në këto vepra dhe njëkohësisht ndikimin e tyre në konceptin artistik. Bazuar në këto kërkime, si pasojë e analizave vërehet se në veprat e krijuara nga kompozitori Rafet Rudi, me përjashtë ndaj sistemit atonal, përdoret kërkimi estetik dhe eksperimenti strukturor i muzikës, ndërsa në veprat e analizuara të kompozitorit Aleksandër Peçi, funksionon kryesisht si mjet praktik dhe komunikues, duke favorizuar afrimin me publikun. Në përfundim, në të dy qasjet edhe pse të ndryshme nga njëra tjetra kjo qasje synon të kontribuojë në pasurimin e diskursit muzikor bashkëkohor shqiptar.

Fjalë kyçe

Kitarë, analizë strukturore, estetikë

Banda muzikore e shoqërisë “Afërdita” dhe marshi Albanischer Lieder i Anton Cimflit

Sokol Saraçi

saracisokol@yahoo.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

E marrë në raport me kohën dhe mungesën e traditave, mund të pohohet se situata e viteve në prag të pavarësisë mbi krijimin e bandave muzikore (1908-1912) ishte entuziaste dhe frymëzuese. Fillimet e tyre, qoftë edhe si struktura artistike të ndërmjetme apo të përziera, shënonin një risi. Përmes lëvizjes së gjerë kulturore artistike, në këtë mes edhe të krijimit të bandave muzikore si grupe orkestrale, kombi shqiptar po shkëputej nga modeli, mendësia dhe prapambetja kulturore shekullore. Ky artikull synon të hedhë dritë në një nga faqet pak të njohura të këtij procesi. Në fillim bëhet një parashtrim i shkurtër i shoqërisë “Afërdita” të Elbasanit dhe bandës së saj muzikore. Pastaj trajtimi përqendrohet rreth dirigjentit dhe kompozitorit austriak Anton Cimfl, i cili ka dhënë një kontribut të veçantë në këtë bandë. Në qendër të trajtimit do të jetë marshi i tij Albanischer Lieder, kushtuar Aqif Pashë Elbasanit. Krahas analizës muzikore, një vëmendje e veçantë i kushtohet rrethanave në të cilat u krijua vepra dhe historisë së receptimit të saj. Ndër gjetjet e punimit është se marshi Albanischer Lieder paraqet rastin ku një ndërmjetës kulturor i jashtëm nuk e imagjinon identitetin muzikor të tjetrit në terma të traditës më përfaqësuese folklorike (siç mund të nënkuptojë titulli), por në terma të asaj që i përshtatet më mirë zhanrit dhe traditës prej nga ai vetë buron. Marshi përbën kështu një shembull domethënës të ndërthurjes komplekse të individit, kontekstit historik, politik e social dhe traditës muzikore e të zhanrit specifik ku bën pjesë vepra. Konkludohet se historia e muzikës shqiptare të kësaj periudhe nuk mund të konsiderohet e plotë pa trajtuar gjerësisht edhe kontributin e muzikantëve të huaj që punuan në Shqipëri, duke sugjeruar nevojën për ta tejkaluar përqendrimin e deritanishëm vetëm në figurat vendase.

Fjalë kyçe

Muzikë, bandë, marsh, shoqëria “Afërdita”, Cimfl

Paradigma pedagogjike e Herbert L. Clarke: formimi në veglat e harqeve, metodologjia e kornetës dhe soloizmi në bandë në edukimin modern të tunxhit

Dario Savino Doronzo

dariodoronzo@gmail.com

Konservatori i Muzikës “G. Verdi”, Ravenna, Itali

Abstrakt

Ky punim shqyrton trashëgiminë pedagogjike të Herbert L. Clarke (1867–1945) brenda fushës së performancës muzikore dhe edukimit artistik, duke trajtuar dy çështje parësore kërkimore. Së pari, ai hulumton shkallën në të cilën formimi i hershëm i Clarke-it në violinë dhe violë shërbeu si matrica teknike dhe konceptuale për metodat e tij të njohura të kornetës (Studime Elementare, Teknike dhe Karakteristike). Së dyti, punimi eksploron se si karriera e tij si solist ridefinoi rolin edukativ dhe kulturor të bandës frymore në fillimin e shekullit të njëzetë. Përmes një metodologjie historiko-analitike bazuar në autobiografinë e Clarke-it, në studimin krahasimor të vëllimeve të tij pedagogjike dhe në analizën e kulturës së bandave amerikane, kërkimi identifikon një transferim sistematik të parimeve të instrumenteve e harqeve në metodologjinë e tunxhit. Gjetjet tregojnë se sfondi i tij në harqeve ndikoi drejtpërdrejt në prodhimin e tingulli, vazhdimësinë e legato-s, frazimin dhe dizajnin progresiv të ushtrimeve, duke vendosur një kornizë ndërdisiplinore që i dha formë pedagogjisë moderne të instrumenteve të tunxhit. Për më tepër, veprimtaria ndërkombëtare e Clarke-it si solist e transformoi performancën në një praktikë të orientuar drejt kërkimit, duke e pozicionuar bandën frymore si një hapësirë për eksperimentim teknik dhe ndërmjetësim kulturor.

Fjalë kyçe

Pedagogji instrumentale, kërkim i bazuar në performancë, kultura e bandës frymore, transferim metodologjik, pedagogjia e tunxhit

Tingujt e Kalabrisë: Inovacion dhe ruajtje nëpërmjet Inteligjencës Artificiale

Ilenia Ruggiero

ilenia.ruggiero@dottorandi.conservatoriocosenza.it

Konservatori i Muzikës S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Ky punim prezanton gjetjet paraprake nga projekti i doktoratës “Tingujt e Kalabrisë: Inovacion dhe Ruajtje nëpërmjet Inteligjencës Artificiale,” i realizuar pranë Konservatorit të Muzikës “Stanislao Giacomantonio” të Cosenzës. Duke bashkuar etnomuzikologjinë, ekologjinë akustike dhe deep learning, kërkimi synon të ruajë dhe valorësojë trashëgiminë sonore të Kalabrisë. Metodologjia është tripartite: regjistrimi sistematik i peizazheve sonore natyrore, urbane dhe tradicionale rajonale; analiza kompjuterike e këtyre dataseteve nëpërmjet kuadreve Python si Librosa dhe PyTorch; dhe zhvillimi i një algoritmi pronësor të aftë të gjenerojë peizazhe sonore imersive që reflektojnë identitetin akustik të rajonit. Korniza teorike mbështetet në veprat themelore të studimeve të peizazhit sonor - nga R. Murray Schafer, Barry Truax dhe Almo Farina - krahas kërkimit etnografik të Antonello Ricci. Taksonomia e tij cilësore e tingujve ritualë dhe të përditshëm kalabrezë informon ndërtimin e një dataseti etnografiko-kompjuterik të annotuar kulturalisht. Kjo qasje ndërdisiplinore mundëson mbrojtjen digjitale të trashëgimisë së paprekshme pa gërryer rëndësinë e saj të thellë simbolike dhe historike. Zhvillimi i ardhshëm parashikon një model hibrid të avancuar që integron një nderfaqe bisedore të IA. Kjo do të lejojë kontrollin semantik të përdoruesit të çiftuar me manipulimin e detajuar parametrik të tingullit, duke pozicionuar efektivisht sistemin si një instrument i vërtetë ko-krijimi njeriu-makinë. Duke lidhur ruajtjen tradicionale me gjenerimin algoritmik të avangardës, projekti hap rrugë të reja për zbatimin praktik të kërkimit të peizazheve sonore. Aplikimet e parashikuara në botën reale përfshijnë post-prodhimin kinematografik dhe dizajnin sonor imersiv - potencialisht në bashkëpunim me “Calabria Film Commission” - si dhe integrimin në mjedise terapeutike më të gjera, ndërhyrje të ekologjisë akustike dhe programe të përgjithshme të mirëqenies.

Fjalë kyçe

Peizazh sonor, inteligjencë artificiale, deep learning, audio gjenerative, trashëgimi akustike

Trashëgimia, kërkimi dhe inovacioni: biblioteka e parë e mostrave të instrumenteve muzikore tradicionale kalabrez

Marco Greco

marco.greco@dottorandi.conservatoriocosenza.it

Conservatorio S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Ky punim paraqet kuadrin paraprak të kërkimit të një projekti doktoral ndërdisiplinor të orientuar drejt krijimit të Bibliotekës së Parë të Strukturuar të Mostrave të instrumenteve muzikore tradicionale Kalabrez, i zhvilluar nën mbikëqyrjen e Profesorit Francesco Perri në Programin Doktorat të Conservatorio di Musica Stanislao Giacomantonio di Cosenza. Projekti i përgjigjet një boshllëku të rëndësishëm në fushën e organologjisë etnomuzikologjike: pavarësisht pasurimit dhe kompleksitetit të traditës muzikore Kalabrez - e cila përfshin instrumente si zampogna, chitarra battente, lira dhe ciaramella - nuk ekziston asnjë bibliotekë profesionale e instrumenteve virtuale që përfaqëson besnikërisht këtë trashëgimi brenda ambienteve bashkëkohore të prodhimit muzikor. Kërkimi integron metodologjinë etnomuzikologjike me inxhinierinë e avancuar audio, duke propozuar një formë të ruajtjes aktive dixhitale që shkon përtej dokumentimit të thjeshtë arkivor. Duke u mbështetur në një vëzhgim sistematik të literaturës themelore etnomuzikologjike dhe organologjike mbi traditën Kalabrez, projekti vendos bazat e nevojshme për t'i qasur këtyre instrumenteve jo si mbetje statike, por si bartës dinamikë të praktikës muzikore të gjallë, të ngulitur në kontekstet e tyre shoqërore dhe performative. Nga ana teknike, seancat e mostrimit do të kryhen sipas standardeve më të larta të cilësisë profesionale në një ambient akustik të kontrolluar. Materiali i mbledhur do të zhvillohet në instrumente VST në platformën Kontakt nëpërmjet skripting-ut KSP (Kontakt Script Processor), duke implementuar algoritme round-robin dhe shtresa multi-velocity për të arritur realizmin shprehës. Rezultatet paraprake përfshijnë një kuadër etiko-ligjor për mbledhjen e materialit sonik dhe një model shpërndarjeje me akses të hapur, në përputhje me angazhimin e projektit për difuzionin e lirë të trashëgimisë kulturore. Projekti synon përfundimisht t'i bëjë trashëgiminë muzikore Kalabrez të aksesueshme për përdorim krijues dhe kompozitor brenda ambienteve profesionale të stacionit dixhital të punës audio.

Fjalë kyçe

Organologjia kalabreze, trashëgimia kulturore jomateriale, kërkimi etnomuzikologjik, ruajtja dixhitale, biblioteka e instrumenteve virtuale

Formula gojore, kujtesë spektrale dhe ruajtje digjitale. qasje kompjuterike dhe psikoakustike ndaj traditës së këndimit bizantin të arbëreshëve të Siçilisë

Salvatore Gorgone

salvatore.gorgone@dottorandi.conservatoriocosenza.it

Conservatorio S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Këndimi liturgjik bizantin i komuniteteve arbëreshe të Siçilisë përfaqëson një nga arkivat e gjalla më domethënëse, nga pikëpamja analitike, të praktikës muzikore të krishterimit lindor në Europën Perëndimore. E trashëguar ekskluzivisht përmes mekanizmave oralë për mbi pesë shekuj dhe e strukturuar rreth sistemit tetë-tonësh të oktoihit (oktoichos) dhe mjetit kompozicional të njohur si forma mista (forma e përzier), kjo traditë dëshmon një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme ndërbrezore, përcaktuesit kognitivë dhe akustikë të së cilës nuk i janë nënshtruar kurrë një kërkimi sistematik kompjuterik. Ky artikull propozon një kuadër kërkimor me shumë nivele, që ndërthur muzikologjinë kompjuterike, teorinë psikoakustike dhe matjen akustike. Teorikisht, arkitektura perceptuese e forma mista – alternimi i pasazheve formulike dhe reçitative me profile spektrale kontrastuese – interpretohet përmes modelit të Albert Bregman-it mbi ndarjen e rrymës auditive (auditory stream segregation). Ky model ofron bazën konceptuale për një proces automatik segmentimi (automated segmentation pipeline). Procesi integron paraqitjen përmes Transformimit Constant-Q (CQT), i përshtatshëm për sistemet modale jo-të-temperuara, me një arkitekturë të Rrjetit Neuronal Konvolucional (CNN), që përdor filtra të zgjeruar në shumë shkallë (multi-scale dilated filters) për të kompensuar rezolucionin kohor jo-homogjen të CQT-së nëpër brezat e frekuencave. Arkitektura e propozuar CQT-CNN adreson një kufizim konkret metodologjik të analizës spektrale standarde të aplikuar mbi këndimin modal jo-të-temperuar, ndërsa kuadri psikoakustik shpjegon qëndrueshmërinë e dokumentuar ndërbrezore të rrymës formulike.

Fjalë kyçe

Këndimi bizantin, transformimi constant-q, rrjeti neuronal konvolucional, ndarja e rrymës auditive

Heterogjeniteti rajonal dhe identiteti instrumental: “Chitarra Battente” e Kalabrisë Jugore përmes veçorive spektrale

Chiara Rinciari

chiararinciari@hotmail.it

Conservatorio di Musica S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Ky punim hulumton heterogjenitetin e kulturës popullore kalabreze duke ekzaminuar karakteristikat e traditave të ndryshme të chitarra battente që gjenden në mbarë rajonin. Analiza synon të nxjerrë në pah këtë instrument nga Kalabria jugore, tradita e së cilës ka mbetur më pak e njohur se ajo e zonës së Kozencës. Duke u mbështetur në kontributet e studiuesve autoritativë dhe në një studim krahasimtar midis dy varianteve të kësaj kitare në jug, punimi kërkon të evidentojë dallimet timbrike – dhe si rrjedhojë estetike e performative – midis dy instrumenteve. Për të plotësuar diskutimin organologjik dhe etnomuzikologjik, u krye një test cilësor eksplorues duke përdorur MATLAB: ngjarjet zanore homogjene (një model i luajtur me goditje telash bazuar në akorda të hapur) u analizuan për sa i përket përgjigjes së brezit të frekuencave dhe zarfit të amplitudës.

Fjalë kyçe

Etnomuzikologjia, trashëgimia kalabreze, chitarra Battente, organologjia, përgjigjja e brezit të frekuencave

Nga analiza formulare te sonologjia kompjuterike: opusmodus dhe thin për studimin e sistemeve muzikore jo-temperuar arbëreshe

Innocenzo Cosimo De Gaudio, Luca Bimbi

innocenzo.degaudio@docenti.conservatoriocosenza.it; bimbi.luca@gmail.com

Conservatorio S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Ky artikull prezanton një kornizë llogaritëse (computational framework) të integruar për studimin e këngës polifonike arbëreshe “Fjet dhafin e llimune”, duke aplikuar dy mjete plotësuese mbi të njëjtin regjistrim në terren, në një regjim përjashtimi reciprok. Opusmodus – një sistem Analize dhe Kompozimi i Asistuar nga Kompjuteri (CAC), i bazuar në gjuhën Common Lisp – operon në nivel simbolik, duke identifikuar strukturat formulare, profilet ritmike dhe bërthamat kadenciale përmes funksioneve të tij: Recurring Analysis, Element Analysis dhe Statistic Analysis. Nga ana tjetër, THIN, një aplikacion i bazuar në Python për gjenerimin dhe analizën e sistemeve të akordimit muzikor, operon drejtpërdrejt mbi sinjalin audio. Moduli i tij diapason-analysis implementon një proces me disa faza që përfshin gjurmimin e frekuencës themelore (F0 tracking), grupimin e frekuencave (frequency clustering), vlerësimin automatik të diapazonit me intervale besueshmërie, si dhe ballafaqimin e modeleve (pattern matching) me mbi pesë mijë shkallë historike nga databaza Scala. Shkalla e identifikuar, e eksportuar si file .ascl për Ableton Live, mundëson transkriptimin brenda sistemit të vetë akordimit të traditës. Rezultatet, ndonëse të kufizuara në këtë regjistrim specifik, dëshmojnë se si THIN mundëson nxjerrjen e sistemeve të nënkuptuara të akordimit nga traditat orale dhe hapin rrugën për studime krahasuese më të gjera në të gjithë repertorin arbëresh.

Fjalë kyçe

Sistemet e akordimit jo-temperuar, kompozimi formular, sonologjia kompjuterike, muzika arbëreshe, Intonacioni i pastër me limit 5

Jehona hibride: peizazhet zanore të proksimitetit dhe identitetit në Kalabri mes VST-së dhe Inteligjencës Artificiale

Francesco Perri

direttore@amministrazione.conservatoriocosenza.it

Conservatorio S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Kalabria, një territor i karakterizuar nga një shtresëzim zanor arkaik dhe një morfologji gjeografike komplekse, paraqitet si një laborator ideal për të hetuar konceptin e identitetit zanor në epokën e riprodhueshmërisë algoritmike. Ky raport eksploron se si gjuhët e reja të Inteligjencës Artificiale Gjenerative dhe Virtual Studio Technology (VST) po rishkruajnë marrëdhënien midis “proksimitetit” (tingullit të vendit) dhe “heteronomisë” (ligjit të tingullit të diktuar nga agjentë të jashtëm/algoritmikë). E ardhmja e peizazhit zanor kalabrez luhetet mes utopisë së një konservimi digjital të shtuar dhe rrezikut të një “estetike kloni”.

Fjalë kyçe

IA gjenerative, VST, peizazhi zanor i kalabrisë, etnomuzikologjia digjitale

Muzika korale në Kosovë Konteksti historik, kulturor dhe institucional

Hysen Nimani

hysen.nimani@unhz.eu

Fakulteti i Arteve, Universiteti “Haxhi Zeka“, Pejë, Kosovë

Abstrakt

Muzika korale në Kosovë, ndonëse e vonshme, paraqet arritje të shquara. Synimi i këtij punimi është të paraqesë një shqyrtim historik, analitik dhe estetik të kësaj trashëgimie, e cila nuk ka marrë akoma trajtimin e merituar studimor. Zhvillimi i muzikës korale është i lidhur ngushtë me rrethanat historike, shoqërore dhe kulturore të saj. Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore fillojnë të konsolidohen format e para të përpunuara e të organizuara të këndimit koral si një shprehje estetike kolektive, e kultivuar dhe me ngarkesë të fortë shpirtërore. E mbështetur kryesisht në trashëgiminë muzikore popullore shqiptare, muzika korale në Kosovë u zhvillua si mjet i ruajtjes së identitetit kulturor dhe afirmimit artistik të popullit shqiptar në kuadër të rrethanave komplekse politike dhe institucionale kur kërcënohej ekzistenca jonë kombëtare në kuadrin e ish-Jugosllavisë. Qartësia semantike e këngëve korale, e shoqëruar me emocionin burimor në kahe e kontekste të shumëllojshme, ka mundësuar një shkallë të lartë të përjetimit muzikor kolektiv duke i përfutur këtij repertori një vend krejt të veçantë në tërësinë e traditës sonë muzikore. Krahas trajtimit historik dhe periodizimit të fazave kryesore të zhvillimit, një vend i veçantë do t’i kushtohet edhe personaliteteve kryesore krijuese dhe ravigjzimit të profilit të tyre artistik në këtë fushë. Ndër gjetjet e punimit është se profili i muzikës korale në Kosovë lidhet drejtpërdrejt me kontekstin specifik të vendit në kuadrin e ish-Jugosllavisë, kontekst i cili krahas pengesave ofronte edhe disa përparësi, krahasuar me zhvilimet bashkëkohëse në Shqipëri. Konkludohet se pasuria, gjallëria dhe masiviteti i lëvizjes korale në Kosovë edhe pas vitit 1999 buron nga ajo traditë e krijuar.

Fjalë kyçe

korale, muzikë popullore, identitet artistik

Modaliteti si praktikë në traditat mesdhetare të Lirës: rasti kalabrez në perspektivë krahasuese

Amedeo Fera

amedeo.fera@dottorandi.conservatoriocosenza.it

Conservatorio S. Giacomantonio, Cosenza, Itali

Abstrakt

Ky studim shqyrton organizimin modal në traditat mesdhetare të Lirës përmes një mikro-analize krahasuese dhe të orientuar drejt performancës të dy repertorëve: sonu a ballu nga Kalabria dhe zonaradikos nga Trakia Lindore. Duke tejkaluar përkufizimet skalarë të modalitetit, punimi i trajton modet si korniza gjeneruese që lindin në praktikë, të formësuara nga ndërveprimi midis modeleve melodike, konfigurimit instrumental dhe njohurisë së mishëruar. Duke u përqendruar në segmente melodike të krahasueshme, analiza shqyrton se si kushte të ngjashme organologjike - sisteme të përbashkëta akordimi, struktura droni dhe kufizime pozicionale - mund të çojnë në rezultate modale të ndryshme. Gjetjet tregojnë se, pavarësisht një baze të përbashkët strukturore, dy traditat dallojnë kryesisht në organizimin e lëvizjes melodike dhe orientimin skalar. Shembulli trakian ruan një logjikë modale koherente të strukturuar rreth një kuadri tetrakordal, ndërsa rasti kalabrez paraqet një konfigurim hibrid që kombinon veçori modale me elemente të lidhura me mendimin tonal, duke përfshirë implikime akordale dhe një funksion të dronit të ngjashëm me atë të dominantës. Studimi argumenton se modaliteti nuk përcaktohet vetëm nga materiali i lartësive, por lind përmes artikulimit të gjesteve melodike - veçanërisht përdorimit të kërcimeve intervalore, frazimit dhe lëvizjes kadenciale - brenda një konteksti të caktuar instrumental dhe kulturor. Ai propozon gjithashtu që këto sisteme kuptohen më mirë si forma të njohurisë së mishëruar, të realizuara përmes performancës. Në këtë kuptim, qasjet analitike dhe kërkimi artistik paraqiten si metodologji plotësuese për të kuptuar si dimensionet strukturore ashtu edhe ato përjetuese të praktikës muzikore.

Fjalë kyçe

trupëzim, procese formulore, morfologji instrumentale, hierarki modale, analizë e bazuar në performancë

Perspektiva narratologjike dhe muzikore në “Ajkuna kjan Omerin” – romancë për soprano dhe piano e Edmond Buharasë.

Pirro Gjikondi

pirro.gjikondi@gmail.com

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekt i këtij punimi është analiza muzikore, tekstuale dhe semantike e kësaj romancë të kompozuar nga Buharaja në vitin 2016 (botuar në vitin 2017) e cila u frymëzua nga kënga me të njëjtin titull e Eposit të Kreshnikëve, cikël këngësh epike të transmetuara gojarisht nga Shqipëria Veriore dhe Veriperëndimore, që datojnë në periudhën midis shekujve VII dhe VIII. Kjo këngë i përket një cikli këngësh epike të zhvilluara rreth temës së “luftëtarëve të kufirit” [fjala kreshnik rrjedh etimologjikisht nga serbo-kroatishtja “kraishnik” (nga krajina – krahinë kufitare), me kuptimin “luftëtar kufiri”]. Në variantin e saj tradicional (rapsodik), kënga interpretohet nga një rapsod i cili vetëshoqërohet me lahutë (instrument me hark dhe një tel të vetëm i ngjashëm me guslën), ende gjerësisht i përdorur sot si në Shqipërinë Veriore ashtu edhe në trevat sllave të jugut. Synimi i punimit është reflektimi mbi disa aspekte që e lidhin muzikën jo vetëm me tekstin, por edhe me elemente të caktuara aktanciale, morfologjike dhe semantike, të cilat mund t’i japin tekstit muzikor një formë narracioni skenografik. Zhvillimi i këtij reflektimi do të ndjekë etapat metodologjike në vijim:- Ndarja e veprës në seksione dhe përcaktimi e një skeme formale.- Identifikimi i elementeve të mundshme aktanciale (aktantëve) të pranishëm në narracion dhe roli i tyre në diskursin muzikor, sipas teorisë së Semantikës Strukturore të Greimas-it.- Përcaktimi i marrëdhënieve metrike ndërmjet muzikës dhe tekstit dhe identifikimi i elementëve ritmike dalluese.- Përcaktimi i elementëve të mundshëm agogjikë, timbrikë dhe dinamikë që kontribuojnë në karakterin dramatik të narracionit muzikor. Përfundimet e shprehura synojnë të vlerësojnë qëllimin e autorit në shprehjen e lidhjeve të rëndësishme të muzikës me tekstin dhe në pasqyrimin e karakterit semantik dhe semiotik të saj.

Fjalë kyçe

Edmond Buharaja, Ajkuna, romancë, eposi i kreshnikëve

Arkitektura e shenjës te Attila: analizë semiotike e strukturave paradigmatiche dhe sintagmatike te Verdi i ri

Fabio M. Rocchi

fabio.rocchi@unitir.edu.al

Fakulteti i Muzikës & Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Kumtesa synon të hulumtojë dramaturgjinë muzikore të operës Attila (1846) përmes perspektiveve të semiotikës strukturale, me referencë të veçantë ndaj kategorive të sintagmës dhe paradigmës të formulura nga Ferdinand de Saussure dhe më pas të transpozuar në fushën muzikologjike. Kuadri teorik nisët nga supozimi se gjuha e Verdit të ri nuk është një mjet i thjeshtë estetik, por një sistem shenjash ku kuptimi buron nga tensioni midis “përzgjedhjes” (boshti paradigmatic i zgjedhjeve timbrike dhe harmonive) dhe “kombinimit” (boshti sintagmatic i linearitetit melodik dhe korrespondencës së tij në metrikën e libretit). Analiza do të përqendrohet në dekonstrukcionin e strukturave semiotike kontrastuese që përcaktojnë operën, duke izoluar kundërshtinë themelore midis Paradigmës së Barbarisë dhe Paradigmës së Romakësisë. E para, e karakterizuar nga ritmet e pikëzuara, sonoritetet e rënda të tunxhit dhe instabiliteti harmonik (veçanërisht në skenën e “Ëndrës”), shërben si ikonë e çrregullimit dhe e kërcënimit; e dyta, e bazuar mbi një diatonizëm solid dhe mbi një rregullsi metrike pasqyruese të vargjeve të libretistit Solera, paraqitet si shenjë e stabilitetit moral dhe civil. Do të vërtetohet se si sintagma verdiane, përmes përdorimit të kapërcimeve intervalore ekstreme dhe kadencave monumentale, nuk mjaftohet vetëm me shoqërimin e tekstit, por shndërrohet në homologun e tij struktural, duke e shndërruar konfliktin politik në një përplasje të vërtetë midis kodeve semiotike, të cilat në dukje janë të vështira për t’u vendosur në marrëdhënie të drejtpërdrejtë. Në këtë perspektivë, Attila shfaqet si një arkitekturë sonore ku shenja përcakton identitetin e mitit ende pa u shpërfaqur psikologjia e personazhit.

Fjalë kyçe

Semiotika muzikore, dramaturgjia verdiane, sintagma dhe paradigma, analizë e ligjëritimit operistik, kundërshti strukturor në muzikë

LIBRI ABSTRAKTEVE